# **Mbrojtja e Fëmijëve** Manual për shkollat

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# Mbrojtja e Fëmijëve

## Manual për shkollat

Terre des hommes
www.tdh.ch

with funding from
Austrian
Development Cooperation

**KOORDINIMI I PROJEKTIT DHE PËRGATITJA PËR BOTIM I VERSIONIT NË ANGLISHT NGA:**
Aline Koller

**NË BASHKËPUNIM ME:**
Alketa Kupe, Alketa Zallemi, Anila Arapi, Blerta Mano, Entela Kaleshi, Mariela Simo, Merita Meçe, Valbona Dafa, Valbona Habili dhe me ndihmën e vyer të të gjithë pjesëtarëve të ekipit të “Terre des hommes” në Shqipëri dhe personit të burimeve në Zyrat Kryesore të Tdh në Lausanne.

**PËRKTHYER NGA:**
Erald Kanini, Ergys Bezhani, Marcela Bardho

**REDAKTOR SHKENCOR:**
Prof. Dr. Theodhori Karaj

**REDAKTORE LETRARE:**
Flutura Açka

**GRAFIKA NGA:**
Bill Schulz

**PËRGATITJA PËR BOTIMIN NË SHQIP NGA:**
© 2007 Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Terre des Hommes

Ky material është prodhuar në bashkëpunim të ngushtë midis “Terre des hommes”, një OJF zvicerane e përfshirë aktivisht në zhvillimin e rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri prej 1993 dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri.

**SHUMË FALEMINDERIT:**
Aline Koller

**AUTOR:**
Aline Koller, Konsulente për Mbrojtjen e Fëmijëve, Fondacioni Terre des hommes, Zvicër

shtypi: Tipografia g&k DOLLONJA
rr. Myrtezim Këlliçi, tel. 04 24 20 905, g&k_graphic@hotmail.com

–

# Manuali i Mbrojtjes së Fëmijëve për shkolla

Ky material për Mbrojtjen e Fëmijëve përmban:

I Manualin për Mbrojtjen e Fëmijëve për shkolla (mjet referimi)

**Lexuesit e këtij manuali:**
Anëtarët e bordit të shkollës, drejtorët e shkollave, specialistët për mbrojtjen e fëmijëve për shkollat si dhe të gjithë partnerët e tjerë të shkollave të përfshirë në rrjetin e komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve.

–

# II Udhëzuesi Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve për profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve

**Lexuesit e këtij materiali:**
Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve, personi i kontaktit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, psikologët e shkollës, drejtorë, mësues, anëtarët e komitetit të prindërve, personeli shëndetësor, punonjësit socialë, animatorët[1] e komunitetit, si dhe profesionistët dhe joprofesionistët e tjerë, të cilët punojnë drejpërdrejt me fëmijët.

**Si ta përdorim këtë Manual?**
**Manuali për Mbrojtjen e Fëmijëve për shkolla** përmban një udhëzues, që tregon se si të strukturohet hap pas hapi zbatimi i standardeve për mbrojtjen e fëmijëve në shkollën tuaj, si dhe udhëzime se si të stabilizohet dhe fuqizohet roli i shkollës në një sistem të mbrojtjes së fëmijëve i bazuar në komunitet.

Veç kësaj, **Udhëzuesi Praktik për Mbrojten e Fëmijëve** është një libër trajnimi praktik e autodidakt, që ndihmon punonjësit dhe kujdestarët e shkollës suaj të rrisin rolin e tyre profesional, duke zhvilluar aftësi dhe kompetenca që lidhen me punën me fëmijët.

1 Animatorët e komunitetit janë persona që punojnë me pjesëtarët e komunitetit me qëllim që t'i ndihmojnë ata të informohen për problemet lokale dhe të aktivizohen në zgjidhjen e tyre. (Shënim i redaktorit).

# Përmbajtja

Parathënie 11
Hyrje 12

# Mbrojtja e Fëmijëve

**SEKSIONI A**
**Pikat e referimit**

1 **Mbrojtja e Fëmijëve** 20
1.1 Përkufizimi i mbrojtjes së fëmijëve 21
1.2 Mbrojtja e fëmijëve në mjediset e shkollës 21

2 **Masat për mbrojtjen e fëmijës** 23
2.1 Parimet 23
2.2 Qëllimi përfundimtar 25
2.3 Grupet e synuara 25

3 **Teoria dhe modelet mbi zhvillimin e fëmijës** 27
3.1 Konceptet bazë të zhvillimit të fëmijës 27
3.2 Një panoramë e shkurtër e zhvillimit psiko-social nga fëmijëria deri në moshën e rritur 31
3.3 Zhvillimi i fëmijës dhe situatat jetësore stresante 34

4 **Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës** 44
4.1 Hyrje 44
4.2 Përgjegjësia për zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve 48
4.3 Nenet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) që kanë të bëjnë me ofrimin e masave mbrojtëse psikosociale për fëmijët 49
4.4 Një panoramë e përgjithshme e kuadrit ligjor të Shqipërisë mbi të Drejtat e Fëmijës 50

**SEKSIONI B**

**Mandati i shkollës në mbrojtje të fëmijëve**


| | | |
|---|---|---|
| **5** | **Mandati i mbrojtjes së fëmijëve në sistemin e arsimit publik** | 58 |
| **5.1** | Arsimimi dhe mbrojtja e femijëve në Shqipëri | 58 |
| **5.2** | Shkollat dhe mbrojtja e fëmijëve në mbarë botën | 61 |
| **6** | **Aktorët dhe përgjegjësitë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla** | 63 |
| **7** | **Zbatimi i standardeve për mbrojtjen e fëmijëve nëshkolla** | 67 |
| **7.1** | Hyrje | 67 |
| **7.2** | Standardet e mbrojtjes së fëmijëve | 68 |
| **7.3** | Udhëzim hap pas hapi si të zbatosh standardet e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla | 70 |
| **8** | **Sistemi i trajtimit të çdo rasti për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla** | 94 |
| **8.1** | Hyrje | 94 |
| **8.2** | Identifikimi i fëmijëve në rrezik | 96 |
| **8.3** | Menaxhimi  i rastit dhe sistemi i referimit | 98 |
| **8.4** | Përgjegjësitë në menaxhimin e rastit | 103 |
| **8.5** | Takimet për menaxhimin e rasteve | 105 |
| **8.6** | Monitorimi i rastit për qëllime statistikore | 107 |
| **8.7** | Vlerësimi | 107 |
| **9** | **Detyrat dhe kompetencat e Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve** | 110 |
| **9.1** | Kush janë Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve? | 110 |
| **9.2** | Çfarë bëjnë Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve? | 111 |
| **9.3** | Kompetencat dhe shprehitë profesionale të SMF-së/psikologut shkollor | 113 |

| | | |
|---|---|---|
| **10** | **Marrëdhëniet profesionale të Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijës** | 116 |
| **10.1** | Të përgjithshme | 116 |
| **10.2** | Nxënësit | 118 |
| **10.3** | Prindërit, kujdestarët ligjorë dhe kujdestarët e caktuar | 119 |
| **10.4** | Komuniteti | 120 |
| **10.5** | Profesionistë të tjerë | 120 |
| **10.6** | Praktikantët dhe personat që trajnohen | 121 |
| **11** | **Parimet dhe praktikat profesionale për Specialistët Mbrojtjes së Fëmijëve** | 123 |
| **11.1** | Avokatia | 123 |
| **11.2** | Ofrimi i shërbimeve | 124 |
| **11.3** | Vlerësimi dhe ndërhyrja | 124 |
| **11.4** | Të dhënat e raportimit | 125 |
| **11.5** | Përdorimi i materialeve dhe i teknologjisë | 126 |
| **11.6** | Kërkimi, publikimi dhe prezantimi | 126 |
| **12** | **Udhëzime për Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve** | 128 |
| **12.1** | Të përgjithshme | 128 |
| **12.2** | Udhëzime praktike për Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve | 129 |
| **12.3** | Udhëzime praktike për Inspektorët e Drejtorisë Arsimore Rajonale | 130 |

**SEKSIONI C**

## Anekse


| | | |
|---|---|---|
| **ANEKSI 1** | Një përmbledhje e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve **(KDF)** | ^136 |
| **ANEKSI 2** | KDF – Qëllimet e arsimimit | 145 |
| **ANEKSI 3** | Vetëvlerësimi i shkollës | 157 |
| **ANEKSI 4** | Lista e kontrollit për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla | 163 |
| **ANEKSI 5** | Politika dhe procedurat e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve | 172 |
| **ANEKSI 6** | Forma e raportimit mujor mbi mbrojtjen e fëmijëve për shkollat | 190 |
| **ANEKSI 7** | Udhëzues referimi | 198 |
| **ANEKSI 8** | Modeli i këshillimit me kolegët | 202 |

| | | |
|---|---|---|
| **D** | **Bibliografia** | 206 |
| **E** | **Fjalorth me përkufizimet e termave dhe koncepteve** | 208 |
| | **Falënderime** | 212 |

# Parathënie

Të gjithë modelet dhe konceptet e mbrojtjes së fëmijëve të paraqitura në këtë Manual mbi Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla janë përgatitur gjatë periudhës 2006 dhe 2009 gjatë një proçesi me pjesëmarrjen e thuajse 100 personave të fushës së mbrojtjes së fëmijëve dhe arsimit. Në bashkëpunim me ekspertë vendas dhe të huaj, janë përshtatur për kushet shqiptare mjete dhe përvoja të huaja të provuara në mbrojtjen e fëmijëve.

Varianti i parë i Manualit është testuar nga më shumë se 50 punonjës së mbrojtjes së fëmijëve (psikologë shkollash, mësues, drejtorë dhe punonjës të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve) dhe ka frymëzuar punën e tyre në më shumë se 150 shkolla në pesë rajone të Shqipërisë (Durrës, Fier, Tirana, Korça dhe Elbasan) gjatë një periudhe dy vjeçare.

Ju falënderojmë të gjithë ju, të cilët keni ndarë bashkëpunimin dhe komentet tuaja të çmueshme si edhe materialet e trajnimit e burimet që kanë ndihmuar në përmirësimin e Manualit dhe dobishmërinë e tij për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin shkollor shqiptar. Aty ku ka qenë e mundur ne kemi përmendur emrat e autorëve, i kërkojmë ndjesë ndokujt të cilit nuk i është përmendur kontributi i dhënë.

# Hyrje

Fëmijët janë një burim shprese për të gjithë komunitetet. Ndaj, siguria dhe mirëqenia e tyre, janë elementi kyç i së ardhmes. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Shqipërinë, një vend me shumë njerëz të rinj, të cilët kanë aspirata. Megjithatë, fëmijët janë të pambrojtur ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit në të gjitha shoqëritë. Ata kërkojnë të ushqehen dhe të mbështeten, që të mund të rriten e të jenë në gjendje të kontribuojnë për shoqërinë. Angazhimi i Ministrisë shqiptare së Arsimit dhe Shkencës dhe Terre des Hommes në Shqipëri në përgatitjen e këtij materiali, ofron strategji të qëndrueshme për të mbrojtur fëmijët, ndërkohë që ata kalojnë fazat e shkollimit. Ky është një investim për të gjithë brezat e ardhshëm të vendit. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i lirë nga dhuna, shfrytëzimi e të ketë qasje në arsim dhe ushqim, për të arritur potencialin e tij të plotë. Ky Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve, siguron një burim praktik për shkollat, për të qenë një lehtësues kyç në rritjen e mirëqenies së fëmijëve në shoqërinë shqiptare. Shkolla mund të ofrojë një strehë të sigurtë për ta, ku të jenë në gjendje të mësojnë e të zhvillohen. Veçmas, shkollat sigurojnë një pikë kontakti për komunitetet, që të mbështesin familjet që përpiqen të luftojnë me kërkesa të larta lidhur me mbështetjen e fëmijëve.

Ky material ofron një grup të shkëlqyer burimesh, që do të ndihmojnë në pajisjen e profesionistëve për t’i bërë shkollat një vend të sigurt, si dhe për të ndihmuar fëmijët dhe familjet e tyre.

Manuali jep një përmbledhje të gjerë të njohurive bashkëkohore mbi mbrojtjen e fëmijëve. Ai vë theks të veçantë mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në vlerësimin e të drejtave dhe nevojave të tyre. Mesazhi kryesor është se, mbrojtja e fëmijëve është një përgjegjësi e përbashkët mes të gjithë anëtarëve të komunitetit. Si një pikënisje, materiali përcakton standarde të qarta për të krijuar një mjedis të sigurt për fëmijët nëpër shkolla. Kjo kërkon njohuri mbi fazat e zhvillimit të fëmijërisë, për të kuptuar si dobësinë, ashtu dhe faktorët e elasticitetit. Punonjësit e shkollës, dhe të tjerë të përfshirë në aktivitetet e shkollës, duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre  në sigurimin  e fëmijëve të vërejtur apo të dyshuar, të cilët mund të jenë të dhunuar apo shfrytëzuar, se duhet t’i referohen një specialisti të mbrojtjes. Trajnimi dhe rritja e dërgjegjësimit mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, është një strategji e rëndësishme për të inkurajuar të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës të ndjehen të informuar siç duhet dhe të autorizuar për të vepruar, kur janë në dijeni të

çështjeve që lidhen me mirëqenien dhe sigurinë e fëmijëve. Kjo kërkon veçmas të ketë standarde, struktura, mjete, si dhe procese të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rasteve, për t'u siguruar se çdo përgjigje ndaj nevojave për mbrojtjen e fëmijëve mund të vëzhgohet me përgjegjshmëri dhe me vlerësim të vazhdueshëm.

Ndjehem shumë i nderuar ta shkruaj këtë hyrje dhe për faktin se kam qenë i përfshirë në këtë iniciativë. Gjatë punës sime në Shqipëri, kam vërejtur angazhimin e shumë punonjësve të lidhur me këtë projekt. Përgëzoj Aline Koller dhe ekipin e saj për botimin e këtij materiali të shkëlqyer. Ky Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve, është një produkt i përshtatshëm dhe i rëndësishëm i punës së tyre të madhe dhe këmbëngulëse. E rekomandoj këtë material, si burim të rëndësishëm dhe vendimtar për shkollat shqiptare dhe për të gjithë njerëzit që punojnë me fëmijët në një shumëllojshmëri kontekstesh.

**PATRICK O'LEARY PHD**
Universitet – Bath-it, Mbretëria e Bashkuar
Gusht 2009

Ju jeni një drejtor shkolle, specialist për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë, psikolog shkolle, anëtar i bordit të shkollës apo pjesëtar i personelit arsimor në shkollë ose prind dhe, për këtë arsye, keni kënaqësinë dhe përgjegjësinë e madhe të punoni për mbrojtjen e fëmijëve në shkollën tuaj.

Shpresojmë që ky Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve t'ju shërbejë si mjet referimi.

–

# Si ta përdorni këtë Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve?

Ky Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve shërben si një **mjet referimi** për të gjithë aktorët dhe partnerët e shkollës të interesuar për mbrojtjen e fëmijëve. Mund të konsultohet nga profesionistët përgjegjës për veprimtaritë në mbrojtje të fëmijëve, për shembull, psikologët dhe punonjësit socialë në shkolla, stafi personeli shëndetësor, apo të tjerë si personeli drejtues i shkollës, për shembull drejtori i shkollës dhe anëtarët e bordit të shkollës, të cilët kanë mandatin për të siguruar që shkolla e tyre të jetë një vend i sigurt dhe miqësor, ku fëmijët mund të rriten dhe të përparojnë në një mjedis të mbrojtur.

Të gjithë seksionet dhe kapitujt plotësojnë njëri-tjetrin. Në fund të çdo kapitulli do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të mesazheve dhe pikave kryesore, për t'u siguruar që mbani mend çështjet kryesore të kapitullit. Të gjithë anekset e përmendura, janë pjesë përbërëse të Manualit dhe mund të gjenden në **SEKSIONIN C**. Referencat janë renditur në **SEKSIONIN D**, ndërsa fjalorthi për përkufizimet e termave dhe koncepteve për terminologjinë e specializuar psiko-sociale dhe të mbrojtjes në **SEKSIONIN E**.

## Lexim të këndshëm!

**Shkurtime të përdorur:**

| | |
|---|---|
| **SMF** | Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| **OJF** | Organizatë Jo-Fitimprurëse |

# Mbrojtja e Fëmijëve

Struktura për mbrojtjen e fëmijëve paraqet një përmbledhje të koncepteve më të rëndësishme, që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe nënvizon rolin dhe përgjegjësitë e shkollës, si dhe të personit të kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve brenda shkollës në një sistem të mbrojtjes së fëmijëve të bazuar te komuniteti.

# Seksioni A

## Pikat e Referimit

# 1 Mbrojtja e fëmijëve

Kapitulli i parë përmban një panoramë të përgjithshme të përkufizimeve kyç dhe koncepteve teorike që kanë lidhje me mbrojtjen e fëmijëve. Një varg përkufizimesh dhe idesh në të, do të mundësojnë një njohje më të mirë të ndërhyrjeve të propozuara në këtë Manual për përmbushjen e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve në shkolla.

## 1.1 Përkufizimi i mbrojtjes së fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve ka të bëjë me masat ndërdisiplinore të ndërmarra për të garantuar mbijetesën dhe zhvillimin e pranueshëm të fëmijëve që lidhet me të drejtat e tyre. Mbrojtja e fëmijëve konsiderohet, jo vetëm si një veprim parandalues, por edhe si një veprim i fokusuar gjithashtu në ofrimin e shërbimeve, derisa fëmija të mos jetë më në rrezik.

Elementët bazë në përkufizimin e mbrojtjes së fëmijëve janë:

- **MBROJTJA SI E DREJTË:** Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), e ratifikuar dhe e nënshkruar nga pothuajse të gjitha vendet e botës, në vitin 1992 edhe nga Republika e Shqipërisë, është një deklaratë e të drejtave që gëzojnë individët nën moshën 18 vjeç. Këto të drejta ndërkombëtare, janë në harmoni të plotë me nevojat më thelbësore të fëmijëve. Qëllimi i KDF-së është të sigurojë përmbushjen e nevojave themelore të fëmijëve, si dhe të garantojë se fëmijët mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

- **MBROJTJA SI PËRGJEGJËSI SHTETËRORE:** Mbrojtja është përgjegjësia kryesore që çdo shtet ka ndaj qytetarëve të tij. Vetëm atëherë kur një shtet nuk mundet të përmbushë përgjegjësinë e tij, ai duhet të mundësojë ofrimin e këtij shërbimi nëpërmjet organizatave ndërkombëtare asnjanëse.

- × **MBROJTJA SI FUQIZIM:** Mbrojtja ka të bëjë krejtësisht me njerëzit. Është i gabuar mendimi se shtetet, autoritetet dhe agjencitë, janë aktorët e vetëm në mbrojtjen e popullatave në rrezik. Komunitetet kanë mekanizmat e tyre të mbrojtjes së fëmijëve dhe i zhvillojnë këto mekanizma gjithnjë në përshtatje të situatave të ndryshimit të jetës, megjithatë, shumë fëmijë nuk arrijnë të përfitojnë. Ndërhyrja e komunitetit duhet t'i marrë parasysh këta mekanizma mbrojtjeje, në mënyrë që t'i përforcojë ato, t'i vërë ato në dispozicion të të gjithë fëmijëve. Njerëzit janë gjithmonë aktorët kryesorë, kur vjen fjala për mbrojtjen e vetvetes.

## 1.2 Mbrojtja e fëmijëve në mjediset e shkollës

Ashtu siç edhe përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, arsimimi është një prej kritereve bazë për zhvillimin e shëndetshëm dhe të sigurtë të fëmijës. Ndërkohë që prindërit kanë rolin kryesor në rritjen e fëmijëve, shkollat luajnë një rol të madh në procesin e integrimit të fëmijëve në shoqëri. Shkolla mbetet njëri prej instrumenteve parësorë nëpërmjet së cilës fëmija kupton komunitetin dhe bëhet pjesë e tij. Për këtë arsye shkollat përbëjnë një prej mjediseve kryesore në procesin e shoqërizimit të fëmijës.

Shkolla është, gjithashtu, vendi ku përmes një mjedisi miqësor ndaj fëmijëve, nxitet zhvillimi i potencialit të plotë të tyre, si edhe përmbushen nevojat e tyre individuale. Është pikërisht mjedisi brenda komunitetit të shkollës ku një fëmijë mund të zhvillojë mekanizma mbrojtjeje, që e forcojnë mirëqenien e vetë atij apo asaj dhe, për këtë arsye, fëmija ka mundësinë të bëhet aktori kryesor në mbrojtjen e vetvetes. Brenda mjedisit të sigurt të komunitetit të shkollës, një fëmijë mundet gjithashtu të ushtrojë përgjegjësitë e tij/e saj qytetare, duke kontribuar në mirëqenien dhe mbrojtjen e të tjerëve.

Fëmijët janë qenie njerëzore me të drejta, nevoja dhe vlera, prandaj shkollat kanë detyrimin të krijojnë kushtet ku ata mund të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të zhvillohen të lumtur. Pra, për çfarë ka nevojë një fëmijë që të rritet, të zhvillohet dhe të jetojë një jetë të shëndetshme e të kënaqshme?

Një rrjet funksional i mbrojtjes së fëmijëve, është i nevojshëm për të lidhur sistemin arsimor, komunitetet në rrezik dhe shërbimet sociale (shih figura 1). Në çdo shkollë duhet të caktohet një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve (SMF) me mandatin për të siguruar funksionimin e duhur të rrjetit të mbrojtjes së fëmijës brenda shkollës dhe për të koordinuar veprimet për mbrojtjen e fëmijëve me aktorët e tjerë publikë dhe privatë. Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve, është përgjegjës për monitorimin e problemeve të mbrojtjes së fëmijëve, për organizimin e aktiviteteve parandaluese, identifikimin e fëmijëve të rrezikuar, të cilët kanë nevojë për veprime të koordinuara të mbrojtjes së fëmijëve, siç është mbështetja e procesit të integrimit dhe atij të riintegrimit të fëmijëve në shkollë. Fëmijët që braktisin shkollën, janë shumë të ekspozuar ndaj një spektri të gjerë fenomenesh sociale negative, përfshirë këtu punën e fëmijëve, abuzimin, shfrytëzimin dhe trafikimin.

**FIGURËN 1**



# 2 Masat për mbrojtjen e fëmijës

Kapitulli i dytë ilustron kuadrin e përgjithshëm për ndërhyrjet e mbrojtjes së fëmijëve. Ai fillon me parimet dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e fëmijëve dhe përcakton qëllimin përfundimtar të masave për mbrojtjen e fëmijëve, si edhe të popullatës, objekt i tij.

## 2.1 Parimet

**Përdorimi i një metodologjie me bazë sistemi**
Zhvillimi i fëmijës shihet si një fenomen kompleks, i integruar në ndërveprimet e vazhdueshme ndërmjet individit, familjes, komunitetit dhe elementëve shoqërorë brenda një konteksti të caktuar. Meqenëse këta elementë ndikojnë njëri-tjetrin në mënyrë të vazhdueshme, ndërhyrja ka për qëllim të krijojë një mjedis ku individëve u jepet mundësia të veprojnë mbi sistemin që i rrethon.

**Përdorimi i një metodologjie me bazë gjinore**
Përdorimi i një metodologjie me bazë gjinore merr parasysh situatën, dinamikat dhe nevojat e secilit anëtar të komunitetit – burrat, gratë, djemtë dhe vajzat – në mënyrë që, në fazën fillestare të arrihen sa më mirë objektivat për përzgjedhjen e grupit të synuar, si edhe të gjendet rruga më e përshtatshme për të sjellë ndryshim.

**Të konsideruarit e fëmijës si aktor**
Megjithëse nocioni i një metodologjie “që ka në qendër fëmijën” është shumë i përhapur, fëmijëve rrallëherë u merret mendimi apo dëgjohen.

Çdo fëmijë ka vlerat e tij personale dhe sociale, që ai apo ajo, i përdor në momente të caktuara të jetës së vet. Ndërhyrjet fokusohen në identifikimin e burimeve dhe nevojave të brendshme dhe të jashtme, që fëmija të mund të zhvillojë mekanizma mbrojtjeje për mirëqenien e vet.

**Puna me familjet**
Mirëqenia psiko-sociale e të rriturve, veçanërisht e prindërve dhe e kujdestarëve, ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi atë të fëmijëve, dhe për këtë arsye, duhet të trajtohet nëpërmjet ndërhyrjeve paralele, që kanë për fokus prindin dhe mësuesin.

**Sigurimi i konsultimit dhe i pjesëmarrjes**
Të gjitha masat në mbrojtje të fëmijëve, duhet të merren gjithmonë duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Fëmija duhet të gëzojë realisht të drejtën e vet për t'u shprehur. Ndërkohë që kjo mund të arrihet me nivele të ndryshme pjesëmarrjeje dhe suksesi, konsultimi me fëmijën dhe përfshirja e tij në marrjen e masave mbrojtëse për të, është një e drejtë e pamohueshme dhe provë e respektit ndaj fëmijëve.

**Sigurimi i masave mbrojtëse të koordinuara dhe të organizuara**
Në çfarëdo situate të vështirë, efektshmëria e përpjekjeve të mbrojtjes së fëmijës, varet së tepërmi nga mekanizmat e koordinimit dhe partneriteti ndërmjet të gjithë aktorëve. Një mjedis pune multi-disiplinor, do të përfshinte përfaqësues nga institucionet e qeverisë (shërbimet arsimore, gjyqësore, policore, shëndetësore dhe ato sociale), institucionet e OKB-së, OJF-të, shoqëria civile dhe institucionet fetare. Objektivi kryesor është të sigurohemi se nuk do të ketë kapërcime kompetencash dhe se do të identifikohen e do të plotësohen të gjitha boshllëqet.

**Metodologjia e integruar**
Lidhur me masat që duhen marrë në mbrojtje të fëmijëve, në punën psiko-sociale rekomandohet një metodologji e integruar, ku janë të përfshira dhe të koordinuara shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale, mbështetja ligjore dhe shërbime të tjera ndihme.

**Parandalimi dhe mjedisi mbrojtës**
Masat mbrojtëse duhet të zbatohen asisoj, që ato t'i kontribuojnë mbrojtjes së fëmijës në të ardhmen nga çdo rrezik. Kjo përfshin krijimin e një

mjedisi mbrojtës, për shembull, nëpërmjet edukimit të publikut për dhunën ndaj fëmijëve dhe trajnimit të kujdestarëve dhe prindërve, për t'i njohur ata me ndikimet që dhuna ka tek fëmijët.

## 2.2 Qëllimi përfundimtar

Qëllimi përfundimtar i mbrojtjes së fëmijëve është përfitimi që fëmijët kanë prej masave konkrete të mbrojtjes, që synojnë zhvillimin e plotë të potencialit të tyre. Bazuar në këtë qëllim përfundimtar, për çdo rast që do të paraqitet në mbrojte të fëmijës, do të ketë objektiva të përcaktuar, rezultate dhe strategji në përputhje me parimet e parashtruara në **KAPITULLIN 2.1**.

## 2.3 Grupet e synuara

Duke marrë parasysh fushën e gjerë të ndërhyrjeve në mbrojtje të fëmijëve, palët përfituese fillojnë nga fëmijët dhe familjet e deri tek udhëheqësit e komunitetit dhe autoritetet qeveritare.

**Fëmijët**
Sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), fëmijë quhet çdo individ nën moshën 18 vjeç. Në përfituesit e drejtpërdrejtë përfshihen të miturit (0-5 vjeç), fëmijët (6-12 vjeç), adoleshentët (13-18 vjeç) dhe/ose të rinjtë e moshës (19-25 vjeç). Ndërkohë që një numër i madh fëmijësh mund të jenë në rrezik, duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë dhe t'u vihen në dispozicion burime kategorive të mëposhtme të fëmijëve:

- Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë
- Fëmijët e zhvendosur
- Fëmijët me aftësi të kufizuara (mendore ose fizike)
- Fëmijët që jetojnë me prindër tepër të rrezikuar
- Fëmijët e sëmurë ose të plagosur
- Fëmijët që jetojnë në rrugë
- Fëmijët që mbajnë një familje
- Fëmijët viktima ose dëshmitarë të abuzimeve dhe të dhunës
- Fëmijët e prekur rëndë nga ana psikologjike
- Adoleshentët

**Familjet/prindërit ose kujdestarët**

Prindërit mund të jenë deri në njëfarë mase përfitues të planeve të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve, pasi ndihma ndaj fëmijës kërkon të ndihmohen edhe prindërit ose familja e tij. Vështirësitë e mëdha që hasen nga prindërit (njëri, apo të dy) shkaktojnë probleme brenda strukturës së familjes. Mbështetja ndaj tyre duhet të jetë komplekse. Si aktorë kryesorë të mirëqenies së fëmijës, prindërit ose kujdestarët, kanë nevojë për mbështetje specifike, në mënyrë që ata të bëjnë kujdes dhe të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj fëmijës së tyre. Veprimet e ndërmarra ndaj të rriturve dhe në bashkëpunim me ta, mund të jenë në formën e mbështetjes individuale, mbështetjes së familjes, ose në formën e aktiviteteve masive me grupe prindërish (për shembull, duke rritur shkallën e ndërgjegjësimit, arsimimit, të kujdesit shëndetësor, higjienës, etj.). Në përputhje me kushtet dhe nevojat e ndryshme, grupet e synuara do të përfshijnë nënat, baballarët dhe/ose të dyja palët së bashku.

**Komunitetet/aktorët kryesorë shtetërorë ose organizatat jofitimprurëse kryesore**

Të punuarit nëpërmjet komunitetit, është një parim thelbësor përsa i përket masave të mbrojtjes së fëmijëve. Në shumicën e rasteve, përfshirja dhe mbështetja e anëtarëve kryesorë të komunitetit (për shembull, udhëheqësit e komunitetit ose udhëheqësit fetarë, mësuesit, punonjësit socialë, punonjësit e shëndetësisë, etj.), është një faktor thelbësor në marrjen dhe zbatimin e masave në mbrojtje të fëmijës. Për më tepër, komuniteti mund të ndihmohet drejtpërdrejti përmes një programi parandalimi. Fuqizimi i strukturave ekzistuese, mund të bëhet për shembull nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, mbështetjes materiale, trajnimit dhe përhapjes së informacionit.

# 3 Teoria dhe modelet mbi zhvillimin e fëmijës

Kapitulli i tretë paraqet një panoramë të përgjithshme mbi fazat e zhvillimit të fëmijës, si edhe jep informacion mbi konceptet e cënueshmërisë dhe të ripërtëritjes, si edhe mbi rreziqet afatshkurtër dhe afatgjatë të situatave të dhimbshme të jetës dhe efektet që ata kanë në mirëqenien e fëmijës.

## 3.1 Konceptet bazë të zhvillimit të fëmijës

Modeli ekologjik[1] (figura 2) paraqet zhvillimin e fëmijës si një fenomen kompleks, të mbrujtur gjatë ndërveprimeve mes individit, familjes, komunitetit dhe elementëve socialë në një kontekst të caktuar. Meqenëse këta elementë ndjekin vazhdueshëm njëri-tjetrin, reagimet për mbrojtjen

**FIGURA 2**




**1** Modeli ekologjik është një kuadër për të analizuar ndikimet e shumëfishta dhe ndëvartësinë që kanë elementët socialë në një mjedis (Shënim i redaktorit).

e fëmijës me bazë sistemi synojnë të krijojnë një mjedis ku individëve u jepet autoriteti për të vepruar mbi sistemin që i rrethon.

Së pari, faktorët personalë që mund të shpjegojnë çrregullimet e një fëmije, përfshijnë: dëmtimet fizike, mungesën e përkujdesjes dhe të ushqimit bazë, pasigurinë fizike, temperamentin, etj. Niveli i dytë eksploron faktin se si lidhjet sociale mund të rrisin ose të pakësojnë rrezikun e problemeve komplekse të sjelljes dhe ato emocionale. Faktorë të tillë mund të jenë ndarja nga kujdestari, humbja e një anëtari të familjes, të qenurit viktimë e dhunës në familje dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët. Së treti, përsa i përket strukturave të komunitetit, është vënë re se shkatërrimi i shkollave, i vendeve të punës, i lagjeve si edhe zhvendosja me forcë nga familjet dhe komunitetet, ndikojnë fuqishëm në cënueshmërinë e fëmijës. Si përfundim, niveli i katërt shqyrton faktorët socialë të një shkalle më të gjerë që ndikojnë mbi sjelljen e fëmijës, normat kulturore, normat gjinore, qëndrimet në lidhje me mbrojtjen e fëmijës dhe politikat që kanë lidhje me arsimimin, shëndetin, anën ekonomike dhe mirëqenien sociale, mbi çka mund të mos tregohet i njëjti kujdes.

Bazuar në kërkimin e bërë nga John Boëlby dhe Marie Ainsëorth, lidhja mes prindërve dhe fëmijës është një prej faktorëve më të rëndësishëm që përcakton ecurinë e zhvillimit përgjatë fëmijërisë. Lloji i përkujdesjes që të miturit dhe fëmijët marrin nga kujdestari i tyre parësor, përcakton, në një shkallë të konsiderueshme, llojin e atashimit[2] që ata formojnë. Të miturit, të cilët kanë marrë përkujdesje të mirë, apo siç njihen ndryshe, të miturit me atashim të sigurt, janë të prirur të zhvillojnë një imazh pozitiv ndaj vetes dhe vetëbesim, aftësinë për t'u socializuar, vullnetin për të eksploruar dhe aftësinë për t'i përballuar problemet sipas rastit. Të miturit me atashim të sigurt, e eksplorojnë mjedisin me vetëbesim, pasi ata nisen nga një "bazë e sigurt".

Ndërkohë që, krijimi i një baze sigurie është thelbësore për një zhvillim normal, fëmijët kanë po aq nevoja të tjera që duhen patur parasysh vazhdimisht.

**2** Atashimi është një lidhje e fuqishme pozitive emocionale mes fëmijës dhe prindit ose kujdestarëve të tjerë të fëmijës, që ka rëndësi të madhe në zhvillimin e fëmijës (Shënim i redaktorit).

**Këto nevoja mund të kategorizohen në tre grupe:**

- **nevojat materiale** (për shembull: ushqimi, streha, veshja, kujdesi mjekësor, siguria, paratë)
- **nevojat sociale** (për shembull: familja, miqtë, shkolla, feja, kultura, komuniteti, aktivitetet)
- **nevojat psikologjike** (për shembull: dashuria, kujdesi, vlerat, besimi shpirtëror, ndjenja e përkatësisë, njohja, pavarësia).

**FIGURA 3**




Shpesh ne përqendrohemi te nevojat materiale dhe harrojmë nevojat sociale e psikologjike. Dashuria dhe përkujdesja janë po aq të rëndësishme për zhvillimin shëndetshëm të fëmijës, sa ç'është edhe ushqimi i duhur. Mes këtyre tre komponentëve nuk ka ndonjë rregull hierarkik, por ndërveprim të vazhdueshëm dhe ndërvarësi (shih figurën 3).

Të gjithë të rriturit që punojnë me fëmijët duhet të zhvillojnë aftësitë bazë që, më së pari të kuptojnë nevojat e tyre personale, e të jenë kështu të përgatitur për të përmbushur sa më mirë nevojat psikologjike dhe sociale të fëmijëve. Është e rëndësishme të mendoni për përvojat tuaja dhe historinë e jetës personale, në mënyrë që të njihni dhe të dalloni filtrat që ndikojnë perceptimin dhe ndërveprimin tuaj me fëmijët (për më tepër informacion dhe ushtrime praktike, lexoni Manualin e Mbrojtjes së Fëmijës).

**Zhvillimi psiko-social i fëmijës**
Fjala 'psiko-sociale' shpreh marrëdhënien dinamike ndërmjet ndikimeve psikologjike dhe atyre sociale. Kjo shpjegon se çdo njeri ndikohet nga integrimi i:

- komponentit psikologjik: mendja, të menduarit, emocionet, aftësitë njohëse, ndjenjat dhe sjellja
- bota sociale për shembull, mjedisi, kultura, traditat, bota shpirtërore, marrëdhëniet ndër-personale me familjen, komunitetin dhe miqtë, si edhe detyrat jetike, si shkolla apo puna.

Mirëqenia psikologjike (burimet e brendshme) dhe mirëqenia sociale (burimet e jashtme) të një njeriu, janë të ndërlidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Për shembull, një fëmijë që është zhvendosur apo i ndarë nga familja dhe miqtë, ka gjasa të përjetojë ndjenja të forta humbjeje dhe frike, ndërkohë që përpjekjet e komunitetit për të reaguar dhe mbrojtur të tjerët, mund të rrisin ndjenjat e solidaritetit dhe të optimizmit.

**Zhvillimi psikologjik** te fëmijët përfshin kapacitetin për t'u rritur në dy nivele:

**EMOCIONAL**
eksperiencat dhe shprehja e emocioneve

+

**MENDOR**
- perceptimi
- analizimi
- të mësuarit

**Zhvillimi social** te fëmijët përfshin aftësinë për të:

- formuar atashime me kujdestarët dhe bashkëmoshatarët;
- krijuar dhe mbajtur lidhje sociale;
- mësuar kodet sociale të sjelljes në kulturën ku ai jeton.

**Çfarë nënkuptojmë me termin "mirëqenie psiko-sociale"[3]?**
Kur mendojmë për punën psiko-sociale në mbrojtjen e fëmijëve, ne fokusohemi tek aktivitetet që nxisin mirëqenien e fëmijëve dhe të familjeve të tyre. Një mirëqenie e tillë mund të mendohet e ndarë në tri fusha kryesore, çka ndikojnë në aftësinë e fëmijës për t'u përshtatuar:

- Kapaciteti individual i personit. Kjo ka të bëjë me shëndetin fizik dhe mendor të personit, pozicionimi i tij në shoqëri, aftësia e tij për të përfituar nga burime, si ushqimi dhe uji, shërbimet sociale, arsimimi

3 Mirëqenia është përkufizuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale, dhe jo thjesht si mungesa e sëmundjes apo e dëmtimeve.

dhe shërbimet mjekësore. Te fëmijët, kjo përfshin nivelin e tyre të cënueshmërisë, të ripërtëritjes, si edhe fazën e tyre të zhvillimit.
- Funksionimi i familjes dhe i komunitetit. Kjo është shkalla ku një person mund të kryejë aktivitetet e jetës së përditshme, si frekuentimi i shkollës, apo të shkuarit në punë, si edhe disponueshmëria e shërbimeve thelbësore. Ai përfshin, gjithashtu, rrjetin e mbështetjes nga familja dhe miqtë apo nga grupet më të gjera brenda komunitetit, për shembull, grupet fetare, kolegët dhe bashkëmoshatarët. Përsa i përket fëmijëve, kjo përfshin ekzistencën e kujdestarëve që i mbështesin ata si edhe burime të tjera sociale, si anëtarë të tjerë të familjes së zgjeruar, shokët e shkollës dhe mësuesit.
- Kultura dhe vlerat shoqërore. Këta janë elementët e jetës që i japin asaj kuptim, bashkojnë komunitetet dhe kontribuojnë në formimin e identitetit të gjithsecilit, siç atë etnik, fetar, etj.

## 3.2 Një panoramë e shkurtër e zhvillimit psiko-social nga fëmijëria deri në moshën e rritur.

Përpara moshës 6 vjeçare, ajo për çka një fëmijë ka më tepër nevojë, është:
- **siguri dhe rutinë;**
- **dashuri** dhe **përkujdesje** prej kujdestarëve kryesorë;
- **kënaqje të nevojave** në mënyrë kompetente dhe të efektshme prej kujdestarëve kryesorë;
- një **mjedis** nxitës dhe **miqësor për fëmijët.**

Gjatë fëmijërisë nga 6 deri në 12 vjeç
Një fëmijë ka nevojë për:
- dashuri prindërore
- përkujdesje prindërore
- shkollim
- lojëra
- udhëheqje

Në fëmijëri nga 6 deri në 12 vjeç:
- fëmija bëhet më **i ndërgjegjshëm për veten** dhe **për ata që e**

**rrethojnë** (ndryshimi i perspektivës);

- fëmija fillon të krijojë **lidhje** kuptimplota **jashtë familjes;**
- fëmija ndërvepron me familjen, miqtë, mësuesit dhe të tjerët, për të zhvilluar më tepër **burime brenda vetes** dhe shprehitë sociale.

**Gjatë adoleshencës nga 12 deri më 18 vjeç**

Fëmija ka nevojë për:

- vlerësim dhe ndjenjë përkatësie
- të zhvilluar vetëdijen për veten dhe vetëbesim
- të marrë më tepër përgjegjësi
- të shprehur seksualitetin
- marrëdhënie me bashkëmoshatarët dhe për aftësi shoqërore
- arsimim zyrtar dhe jozyrtar
- zbulime dhe aventura
- liri dhe pavarësi
- modele sjelljesh për të ndjekur
- ndërkombëtarizim të rregullave kulturore/morale
- shpresë për të ardhmen

**Një adoleshent mëson dhe zhvillohet nëpërmjet:**

- gjetjes së identitetit të vet në shoqëri
- kritikave/rebelimit
- sjelljes së rrezikshme
- diskutimeve për jetën dhe vdekjen
- gjetjes së modeleve të sjelljes për të ndjekur
- ideve dhe mendimeve të reja
- zhvillimit të ndjenjës vetjake të moralitetit, besimit, vlerave
- ndarjes nga familja

**Gjatë moshës së rritur një njeri ka nevojë për:**

- familje, partner, fëmijë
- marrëdhënie shoqërore
- aktivitete që sjellin të ardhura
- aktivitete të kohës së lirë
- rolin e tij në shoqëri
- përgjegjësi

**Si mundet një Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve të ndihmojë në zhvillimin psiko-social të fëmijës?**
Ndërhyrjet psiko-sociale kanë për qëllim të nxisin 1**2** **kompetencat ose kapacitetet njerëzore,** si në vijim:

1. Atashimi i sigurt me kujdestarët
2. Atashimet kuptimplote me bashkëmoshatarët dhe aftësitë shoqërore
3. Besimi te vetja dhe te të tjerët
4. Ndjenja e përkatësisë
5. Vetëvlerësimi dhe vetëbesimi
6. Aftësia për të shfrytëzuar mundësitë
7. Optimizmi për të ardhmen
8. Të qenurit i efektshëm
9. Aftësia për të përjetuar ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve, ndryshimi i perspektivës
10. Të menduarit e orientuar drejt zgjidhjes së problemeve dhe gjetjes së zgjidhjeve
11. Aftësia për t'u përshtatur, mekanizmat e përshtatjes
12. Regullimi dhe shprehja e emocioneve

**Agimi** …
është 8 vjeç. Ai shkon çdo ditë në shkollë dhe ka filluar të mësojë shkrim e lexim. Shpeshherë kur vjen në shtëpi ia tregon detyrat e shkollës me krenari mamasë. Sado të vogla të jenë arritjet e tij, ai do që ato t'i njihen. Agimi luan me miqtë dhe të afërmit e tij, duke luajtur rolin e babait ose të nënës apo të mësuesit me nxënësit e tij. Atij gjithashtu i pëlqen të shoqërohet me të atin, duke i bërë pyetje pa fund rreth Zotit dhe botës.

**Alketa**…
është 16 vjeç. Ajo ka përjetuar shumë ndryshime gjatë viteve të fundit. Trupi i saj është zhvilluar dhe ajo tani ngjason më shumë me një grua, sesa me një fëmijë. Ajo, gjithashtu, dëshiron të trajtohet si një zonjë dhe të marrë vetë vendime për veten e saj. Gjithsesi, ndonjëherë ajo duket e shqetësuar për trupin e saj dhe vepron sërish si fëmijë. Kur prindërit i vendosin rregulla të caktuara, ajo i thyen ato qëllimisht. Alketës nuk i pëlqen të rrijë në shtëpi; asaj gjithmonë i pëlqen të rrijë me shoqet e saj. Ato mund të bisedojnë për orë të tëra pas shkolle apo në telefon.

Mos harroni përherë se çdo fëmijë është unik dhe se ai/ajo zhvillohet sipas ritmit të vet!

# 3.3 Zhvillimi i fëmijës dhe situatat jetësore stresante[4]

Studimet kanë treguar se disa fëmijë janë të aftë t'i përballojnë ngjarjet e stresueshme të jetës apo detyra sfiduese të zhvillimit më me lehtësi se të tjerët. **Ripërtëritja** mund të përcaktohet si aftësia për të reaguar ndaj një ngjarjeje traumatizuese ose stresuese të jetës, duke përdorur burime të brendshme dhe të jashtme. Që të mund të kuptohet ripërtëritja, është thelbësore të identifikohen faktorët mbrojtës të brendshëm dhe të jashtëm, që zbusin efektet e situatave jetësore stresante.

**Cilët faktorë e rrisin ripërtëritjen e fëmijës ndaj problemeve psiko-sociale?**
**Ripërtëritja** është aftësia e një personi për të përballuar vështirësitë dhe për t'u përshtatur me ndryshimin. Për fëmijët, prania e prindërve apo kujdestarëve, të cilët janë në gjendje të ofrojnë përkrahje dhe mbrojtje, është një faktor kyç që e rrit ripërtëritjen e tyre nga ndikimet negative të një ngjarjeje jetësore traumatike apo i detyrave sfiduese për zhvillimin e tij. Fëmijët shikojnë te prindërit dhe kujdestarët mënyrën se si ata duhet të reagojnë ndaj një krize dhe ndryshimi. Kjo është arsyeja pse shpeshherë shohim se fëmijët reagojnë ashtu si edhe prindërit e tyre. Kur një prind sheh se brengosja apo të nervozuarit funksionon dhe nuk përbën ndonjë problem, atëherë fëmija ka shumë gjasa të reagojë në po të njëjtën mënyrë. (Vini re se kultura e një shoqërie dhe rolet gjinore, ndikojnë në mënyrën se si nënat dhe baballarët e shfaqin hidhërimin dhe mekanizmat e përballimit të tij). Kur fëmijët humbasin mbrojtjen e familjes së tyre apo kur familja dobësohet në mënyrë serioze, fëmijët janë shumë më të cënueshëm ndaj stresit dytësor.

**Aftësia ripërtëritëse përcaktohet nga dy faktorë kryesorë:**
- Karakteristikat e fëmijës
- Faktorët mjedisorë

Faktorët që mund të sjellin rritjen e aftësisë ripërtëritëse dhe që nxisin rigjenerimin (apo siç njihen ndryshe si **faktorët mbrojtës**), përfshijnë:

**4** Child Protection Manual for intervention in humanitarian crisis, Terre des hommes, Lausanne (2007).

| KARAKTERISTIKAT MBROJTËSE TË NJË FËMIJE | FAKTORËT MBROJTËS MJEDISORË |
| --- | --- |
| × Ndërmerr hapa pozitive për zgjidhjen e problemeve, për shembull, u flet të tjerëve rreth ndjenjave<br>× Mban përgjegjësi për veprimet e veta<br>× Është optimist për të ardhmen<br>× Respekton veten dhe të tjerët<br>× Ka aftësinë të luajë/të ndërveprojë me të tjerët dhe vetëm<br>× Përfiton nga kushtet e mira të shëndetit fizik dhe mendor, duke përfshirë një koncept pozitiv mbi veten, vetëvlerësim të lartë, mekanizma të përballimit të situatave stresante, rregullim emocional, shprehi motorike në përputhje me nivelin e moshës, shprehi mendore dhe sociale, etj. | × Ekzistenca e një atashimi të sigurt apo lidhjeje me kujdestarët/prindërit<br>× Prindër të cilët janë modele të përshtatjes së suksesshme dhe modele të sjelljes së përshtatshme<br>× Kujdestarë, të cilëve fëmijët mund t'u besojnë dhe të cilët ofrojnë ngrohtësi dhe përkrahje<br>× Njerëz të cilët vendosin kufij për t'i ruajtur fëmijët nga rreziku<br>× Njerëz të cilët i inkurajojnë fëmijët të mësojnë se si t'i bëjnë gjërat vetë në mënyrë të pavarur dhe që i ndihmojnë ata kur bien në telashe<br>× Prania e një familjeje përkrahëse, miqve dhe e një rrjeti komuniteti mbështetës<br>× Vendosja e një rutine, si frekuentimi i shkollës<br>× Mundësia për strehim, higjienë dhe kujdes shëndetësor<br>× Mundësia për arsimim dhe/ose shanse ekonomike<br>× Mjedis miqësor për fëmijët me mundësi stimuluese për të mësuar dhe për t'u zhvilluar |

Masat e mbrojtjes së fëmijës duhet të përpiqen të nxisin faktorët mbrojtës te mjedisi dhe te fëmija, për të rritur aftësinë ripërtëritëse. Studimet kanë treguar se fëmijët që janë të ripërtëritshëm, kanë karakteristika si inteligjencë të zhvilluar, aftësi për të qenë të efektshëm, vetëvlerësim të lartë, kapacitete të zhvilluara sociale, aftësi për të parashikuar dhe planifikuar paraprakisht dhe identifikohen si fëmijë me një sens të mirë humori dhe me optimizëm[5].

**Cilat janë reagimet më të zakonshme psikologjike të fëmijëve ndaj situatave jetësore stresante?**

Ndërkohë që ekzistojnë ndryshime ndërmjet kulturave, çrregullimi psikologjik në përgjithësi ndikon te fëmijët, duke kufizuar aftësinë e tyre për t'u përfshirë në botën përreth tyre dhe për të marrë pjesë në

**5** Oerter R., Mondada L., Entwicklungspsychologie, 2002, Belz Verlag.

aktivitete rutinë, si shkolla dhe lojërat. **Një nga shenjat e para të zakonshme të çrregullimit psikologjik, është atëherë kur fëmija nuk ndërvepron me të tjerët apo nuk shfaq kuriozitet ndaj gjërave që e rrethojnë.**

**Cilat janë reagimet e fëmijëve ndaj ndodhive stresante dhe ndikimet parësore dhe dytësore të tyre mbi fëmijët?**
Është e rëndësishme të mos përgjithësohen më shumë se sa duhet reagimet ndaj rrethanave stresuese të jetës, përderisa karakteristikat individuale të një ngjarjeje do të kenë ndikimin e tyre psikologjik dhe social. Për shembull, paaftësia për të lokalizuar, identifikuar dhe varrosur njerëzit e dashur, mund të ndikojë negativisht aftësinë e familjes për të pranuar fillimisht vdekjen. Të gjykuarit e humbjes së babait si një vepër e Zotit, mund të rrisë aftësinë e familjeve për të rindërtuar jetët e tyre.

Në një situatë të dhimbshme jetësore, çdo fëmijë dhe i rritur reagon në mënyrë të ndryshme; në varësi të moshës, të kaluarës personale, të natyrës së ngjarjes dhe gjendjes aktuale të familjes. Çdo njeri mund t'i përjetojë efektet e radhitura në Tabelën 1. Këto ndikime (parësore) afatshkurtër, janë reagime normale ndaj situatave jonormale.

| KARAKTERISTIKAT MBROJTËSE TË NJË FËMIJE | FËMIJËT E MOSHËS SHKOLLORE | ADOLESHENTËT |
|---|---|---|
| × Përkeqësim në sjellje | × Manifestime të dukshme frike dhe ankthi | × Ulje e interesit për aktivitete shoqërore me shokët, pasionet dhe për shkollën |
| × Rënie oreksi | × Rritje e armiqësisë ndaj vëllezërve dhe motrave | × Paaftësia për të ndjerë kënaqësi |
| × Memecëri | × Çrregullime të gjumit | × Rebelim, probleme të sjelljes |
| × Varësi emocionale | × Probleme në shkollë | × Ankesa trupore |
| × Irritueshmëria | × Rënie e interesit për shokët dhe aktivitetet dëfryese | × Çrregullime të të ngrënit |
| × Reagime të befasishme dhe të ekzagjeruara | × Mbyllje në vetvete | × Ndryshim në shkallën e përfshirjes në aktivitetet fizike (shtim/pakësim) |

| KARAKTERISTIKAT MBROJTËSE TË NJË FËMIJE | FËMIJËT E MOSHËS SHKOLLORE | ADOLESHENTËT |
|---|---|---|
| - | × Apati | × Paqartësi |
| - | × Rijetim situatash nëpërmjet lojës | × Mungesë përqendrimi |
| - | × Çrregullime të stresit post-traumatik | × Sjellje të rrezikshme |
| - | - | × Çrregullime të stresit post-traumatik |

**Reagimet dhe efektet parësore psiko-sociale mund të kategorizohen gjithashtu si vijon:**

- **REAGIME FIZIKE:** rrahje të shpejta zemre dhe frymëmarrje e shpejtë, muskuj të tensionuar dhe/ose që dhembin, marrje mendsh, tepricë apo mungesë e theksuar energjie, probleme psiko-somatike (dhimbje pa ndonjë shkak fizik);
- **NDRYSHIME NË TË MENDUAR:** mendon vetëm për situatën stresante që ka kaluar, paqartësi, vështirësi në përqendrim, ndryshime besimesh, kthim në të shkuarën, paaftësi për të besuar të tjerët, mendon vetëm për të tjerët në dëm të vetvetes. Fëmijët, gjithashtu, mund të pasqyrojnë një ndjenjë të fortë qëllimi;
- **NDRYSHIME EMOCIONALE:** ndjenjë zemërimi, trishtim ose humbje shprese. Fajësi, pandjeshmëri ndaj çdo gjëje (mpirje), ndryshime të befta humori apo mungesë të aftësisë për të kuptuar ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve. Fëmijët, gjithashtu, mund të ngjiten shumë pas të tjerëve;
- **NDRYSHIME NË SJELLJE:** Fëmijët mund të duken nervozë, agresivë, të shmangen nga të tjerët dhe nga aktivitetet, mund të kenë probleme me gjumin dhe të manifestojnë sjellje antisociale ose “sjellje të çuditshme” (për shembull, duke mbledhur sende rreth vetes). Fëmijët e stresuar mund të kenë përkeqësim të sjelljes, veçanërisht në moshë të re. Për shembull, një i mitur që ka fjetur rregullisht gjatë natës, tani nuk e zë më gjumi; një vogëlush që sapo ka mësuar të shkojë vetë në banjë, tani fillon dhe laget sërish për një periudhë kohe. Fëmijët më të rritur mund t’u kthehen lojërave të një moshe më të re, të rifillojnë një zakon të vjetër, si futja e gishtit në gojë, një fëmijë 3 vjeçar, i cili

më parë dinte të kujdesej për veten (për shembull, të përdorte tualetin), tani fillon të dalë jashtë vend e pa vend e të bëhet pis. Po ashtu fëmijët bëhen më të varur dhe më të frikësuar kur ndahen nga prindi apo kudestari. Adoleshentët mund të jenë veçanërisht të cënueshëm kur të fituarit gradual i pavarësisë nga familja, ndërpritet.

**SHKALLA E NDIKIMIT NË SITUATAT E JETËS SË PËRDITSHME:** Është e rëndësishme të vihet re se shkalla e ndikimit në situatat e përditshme të jetës së fëmijës dhe çregullimi social që ai mund të përjetojë, janë pjesë të elementëve të tjerë më shqetësues të një situate jetësore stresante (si, varfëri e theksuar, zhvendosje, tensione në familje). Për shembull, vajzat e abuzuara seksualisht dhe të mbetura shtatzëna, shpeshherë thonë se stigmatizimi dhe mungesa e parave për të ushqyer foshnjat e tyre, përbën stresin më të madh për to.

**KOHËZGJATJA E SITUATËS JETËSORE STRESANTE:** Sa më shumë të zgjasë situata, aq më të mëdha janë rreziqet që i kanosen mirëqenies psikosociale të fëmijës. Ndikimet afatgjatë, mund të përfshijnë mosbesim të mëtejshëm dhe ftohje ndërmjet aktorëve të ndryshëm, si edhe sforcim të tejskajshëm për përballimin e jetës në familje.

**PËRMASA E EFEKTEVE DYTËSORE TË SITUATAVE STRESANTE:** Ndikimet e menjëhershme të një situate jetike traumatike apo të stresueshme, mund të krijojnë një çarje të sistemit tradicional që mbështet fëmijën. Ngjarja jetësore stresuese mund të ketë gjithashtu ndikime psiko-sociale dytësore, që mund të jenë më të dëmshme për mirëqenien afatgjatë të fëmijës, familjeve dhe komuniteteve (shih tabelën 2). Për shembull, vdekja e një prindi, mungesa e arsimimit ose problemet e rënda shëndetësore, ka më tepër gjasa të shkaktojnë ndikime negative afatgjatë, nëse ndihma nuk është e disponueshme.

**Një histori ripërtëritjeje:**
"Më quajnë Ermir. Unë do të mbush 11 vjeç tetorin që vjen. Jetoj në Elbasan me mamanë dhe dy motrat e mia. Pas dy viteve të shkollës fillore, vajta në Greqi me dy fëmijë të tjerë. Njeriu që na mori quhej Dritan. Filluam të lypnim buzë detit në Paralia. Ndonjëherë natën na zinte i ftohti dhe mblidheshim kutullaç së bashku poshtë urës. Dritani na digjte me cigare, pasi nuk i sillja para sa duhej. Një ditë, kur po lypja, pësova një aksident. Më përplasi një makinë. Ndenja në spital për disa muaj. Më pas më dërguan në një qendër ku kishte shumë fëmijë të tjerë shqiptarë. Atje mbarova klasën e tretë të shkollës fillore në greqisht dhe isha më i miri i klasës. Luaja edhe futboll. Më merrte malli për familjen. Pastaj mora autobusin për të vajtur në kufi, ku më prisnin nëna dhe xhaxhai. Vitin e kaluar fillova klasën e katërt të shkollës fillore me shokët e mi këtu në Elbasan. Pas shkolle luajmë edhe futboll. Kur të rritem, do të më pëlqente të bëhesha punonjës social, që të ndihmoja fëmijët që punojnë rrugëve dhe t'i ktheja ata sërish në shkollë."

**Tabela e mëposhtme paraqet mekanizmat që mund të kufizojnë zhvillimin e regullt psiko-social afatgjatë të fëmijës (efektet dytësore):**

| MOSHA DHE CËNUESHMËRIA | REZULTATI AFATGJATË |
| --- | --- |
| **Fëmijëria e hershme (0-5 vjeç)**<br>Zhvillimi i aftësive bazë mendore dhe sociale ndodh gjatë viteve të para të jetës. Faktorë të ndryshëm — dietat e varfëra, infeksionet, sëmundjet, mungesa e stimulimit kognitiv — mund të shkaktojnë rritje të vonuar fizike dhe intelektuale. | × Efekte të pakthyeshme mbi rritjen fizike dhe kognitive dhe zhvillimin në përgjithësi.<br>× Më shumë mundësi që fëmijët të vuajnë nga paaftësitë për të mësuar, për të hyrë më vonë në shkollë, për rezultate të dobëta në mësime, apo për të braktisur shkollën. |
| **Fëmijët e moshës shkollore (6-4 vjeç)**<br>Mundësitë (të ardhurat) e kufizuara në familje, paragjykimet gjinore, infrastruktura dhe shërbimet e papërshtatshme publike, pengojnë vajtjen në shkollë dhe të ofruarit e shërbimit shëndetësor. | × Humbje e zhvillimit të kapitalit dhe kapaciteteve njerëzore.<br>× Vazhdimësi e pabarazisë gjinore.<br>× Përjashtimi nga shoqëria. |
| **Adoleshenca dhe rinia (15 deri 24 vjeç)**<br>Mungesa e mundësisë për të vazhduar shkollën dhe për të kryer shkollën fillore dhe/ose të mesme; për arsim profesional jozyrtar, përfshirë këtu zhvillimin e aftësive jetike që kërkon tregu; e deri te pamundësia për të marrë shërbimet përkatëse mjekësore apo informacion mbi shëndetin riprodhues.<br>Mundësi të pakta të tregut të punës, që bëhen akoma më të vështira nga barrierat e caktuara, të vendosura nga punëdhënësit për marrjen në punë të atyre që kërkojnë punë për herë të parë.<br>Mungesa e pjesëmarrjes në vendimet dhe politikat që kanë ndikim mbi jetët e adoleshentëve dhe të rinjve. | × Papunësi afatgjatë dhe punësim me pagesa të ulëta.<br>× Produktivitet i ulur.<br>× Transmetimi në breza i dhunës në familje dhe në komunitet.<br>× Kosto të larta ekonomike të sjelljeve të rrezikshme dhe mundësive të humbura për zhvillim.<br>× Mundësi të humbura për përfshirjen e të rinjve si agjentë të një qeverisjeje të mirë, përgjegjshmërisë dhe zhvillimit të demokracisë. |

Fëmijët që kanë qenë vazhdimisht të ekspozuar ndaj dhunës, shpesh shfaqin një ndryshim të konsiderueshëm të besimeve dhe të qëndrimeve të tyre, duke përfshirë humbje thelbësore të besimit te të tjerët.

**Shembull se si reagimet e fëmijëve ndryshojnë nga njëri fëmijë te tjetri:** "Fëmijët tanë përjetojnë eksperienca të ngjashme, por reagojnë në mënyrë të ndryshme. Disa prej fëmijëve shfaqin ankth dhe frikë dhe nuk na shqiten, të tjerët mbyllen në vetvete dhe bien në melankoli. Fëmijët e tjerë reagojnë sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe vazhdojnë të luajnë si zakonisht. Kam gjashtë fëmijë … dy nuk dalin fare nga shtëpia, dy e shpenzojnë kohën duke parë televizor dhe duke vëzhguar çfarë ndodh përreth tyre, dhe dy të tjerët lozin jashtë dhe duken të kënaqur." (Raport i prindërve)

---

**Cilët faktorë mund të identifikohen se mund të ngadalësojnë riaftësimin e mirëqenies psiko-sociale?**

Faktorët që mund të ngadalësojnë apo pengojnë riaftësimin psiko-social, njihen si "faktorët e riskut".

- × Dëmtim fizik, aftësi të kufizuara, paaftësi fizike
- × Vdekja e një anëtari të familjes
- × Ndarja nga kujdestarët
- × Persekutimi dhe/ose ekspozimi ndaj dhunës
- × Mungesa e ushqimit, strehës dhe kujdesit të përshtatshëm mjekësor
- × Zëvendësimi i papërshtatshëm i kujdestarëve të fëmijës
- × Zhvendosje me forcë prej shtëpisë apo komunitetit
- × Ndarja nga miqtë dhe komuniteti
- × Pasiguria fizike
- × Shfrytëzimi dhe/ose abuzimi seksual
- × Mohimi i mundësive për arsim, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera.

**Cilat mund të jenë disa nga rezultatet pozitive të ngjarjeve traumatike për fëmijët dhe familjet e tyre?**

Njerëzit shpeshherë manifestojnë një aftësi shumë të mirë ripërtëritëse, duke demonstruar forcë dhe shkathtësi personale si edhe aktivitetet në komunitet ku krijojnë mundësi për solidaritet në rritje, mbështetje sociale dhe bujari. Për më tepër:

- × Fëmijët mund të zhvillojnë mekanizma për përballimin e jetës
- × Fëmijët mund të mësojnë se si të shfrytëzojnë burimet e ndryshme dhe të përjetojnë të qenurit të vlefshëm
- × Fëmijët dhe komunitetet mund të ndërgjegjësohen më tepër mbi të drejtat e tyre

- Fëmijët dhe komunitetet mund të bëhen më tepër aktivë
- Fëmijëve mund t'u krijohet akses për lloje të reja shërbimesh
- Mund të ekzistojnë mundësi për ndryshime sociale (për shembull, përfshirja e grupeve që më parë ishin të përjashtuara).

Si ndikon kultura dhe gjinia në reagimin e fëmijës ndaj një situate jetësore stresante?

**Kultura**
Mënyra se si fëmijët, të rriturit dhe komunitetet reagojnë dhe përballojnë situata të vështira, varet së tepërmi nga faktorët kulturorë. Ajo çka konsiderohet normale, ajo çka ju bën juve të ndiheni mirë, rutinat tuaja të përditshme dhe ata të cilët i shikoni si instruktorët tuaj, do të ndikohen të gjitha nga traditat dhe normat brenda një shoqërie apo nën-shoqërie.

- **NDIKIMI TE TË QENIT PRIND:** Fakti se kush kujdeset për fëmijët dhe se si duhen rritur ata, ndikohet nga traditat, ligjet dhe vlerat e vendit.
- **NDIKIMI MBI STATUSIN, ROLET TRADICIONALE DHE PËRKATËSIA ETNIKE.** Kultura ndikon në pozicionin tonë në shoqëri, gjuhën që flasim dhe rolet tanë.
- **ROLI I BESIMIT, SI I PËRKUFIZOJNË NJERËZIT KRIZAT, SI ATA SHPREHIN DHIMBJEN DHE SE SI ATA E PRANOJNË PËRKRAHJEN, NDRYSHON SË TEPËRMI NGA NJË RAJON NË TJETRIN.** Në një situatë jetësore stresante, problemet e shëndetit mendor mund të stigmatizohen së tepërmi ose të diskutohen në mënyrë të hapur, përkrahja e punonjësve socialë mund të shihet me dyshim apo të mirëpritet, ose ritualet tradicionale të shërimit mund të inkurajohen apo të jenë subjekt talljesh, në varësi të prejardhjes së fëmijës.

**Gjinia**
Situatat traumatike të jetës kanë ndikim mbi burrat, gratë, djemtë dhe vajzat, në mënyra të ndryshme, pasi ata kanë role të ndryshëm në shoqëri. Në disa kontekste të qenit djalë apo vajzë, mund të ketë shumë më tepër rëndësi, se fakti i të qenit fëmijë. Nën-shoqëri të ndryshme kanë ide tepër të ndryshme rreth dobësive dhe kapaciteteve të fëmijëve.

- **FEMRAT:** Vajzat mund ta kenë më të vështirë të ndjekin shkollën apo të marrin pjesë në aktivitete të tjera, që mund t'i ndihmojnë ato të zhvillojnë miqësi dhe aftësi. Ato mund të hasin probleme të

diskriminimit gjinor gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, rreziqe të veçanta dhe presione për t'u përshtatur me rolet që kufizojnë mundësitë e tyre dhe që i vështirësojnë zgjedhjet në jetë, të atillë që nuk haset prej djemve. Për shembull, një vajzë e përdhunuar mund të refuzohet nga familja e saj dhe të mos jetë më në gjendje të martohet, gjë që çon në varfëri dhe në përjashtim nga shoqëria.
Nënat, të cilat kanë përgjegjësinë e përkujdesjes për fëmijët dhe në të njëjtën kohë mbajnë familjen, mund të kenë shumë pak kohë për të qenë në gjendje të trishtohen. Atyre mund t'u lindë nevoja të përdorin mekanizma negativë përballues. për të mbajtur familjen, si për shembull, shkëmbimi i të bërit seks për para.

× **MESHKUJT:** Djemtë janë nën presion të vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët e tyre, nga familjet dhe nga komuniteti për t'u sjellë sipas modeleve gjinore të të qenit mashkull. Mund të jetë më e vështirë për djemtë të shfaqin frikën, dhimbjen apo ankthin. Baballarët që kanë qenë tradicionalisht burimi i të ardhurave në familje, mund të përjetojnë një humbje të identitetit dhe rolit të tyre kur mbeten pa punë.

## Përmbledhje

Metodologjia e mbrojtjes së fëmijëve me bazë sistemi, nënkupton përfshirjen e fëmijës si aktor për mbrojtjen e vetvetes, e integruar kjo në ndërveprimet me familjen, komunitetin dhe elementët shoqërorë.

Gjatë fazave të fëmijërisë, fëmijët kanë nevoja të ndryshme psikologjike, sociale dhe fizike. Atashimi i sigurt me kujdestarët parësorë, është njëra prej nevojave më të rëndësishme psikologjike për zhvillimin e shëndetshëm psiko-social të fëmijës. Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve në sistemin shkollor, duhet të krijojë një lidhje me fëmijën dhe familjen. Pa një raport të mirë, asnjë punë afatshkurtër nuk mund të realizohet. Në planin afatgjatë, shpeshherë është prania e një lidhjeje me një të rritur të ndërgjegjshëm dhe të përkujdesur, çka sjell ndryshimin e madh mbi mirëqënien psikosociale të fëmijës. Në rastet ideale, përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me familjen e tij/e saj dhe komunitetin, një fëmijë mund të mësojë, zhvillohet dhe të ripërtërihet sipas një rruge që çon në mirëqenie.

Dobësitë personale mund të zgjidhen nëpërmjet ndërhyrjeve, çka promovojnë strategji dhe aftësi njerëzore që ndihmojnë në përballimin e

situatave të stresueshme të jetës. Ripërtëritja e një fëmije, mund të zhvillohet nga ndërhyrje që forcojnë faktorët **e brendshëm** dhe **të jashtëm** mbrojtës, që zbutin **tensionet** negative të brendshme dhe të jashtme.

**Ripërtëritja është:**

- Kapaciteti për të menaxhuar vetveten (rregullimi i emocioneve dhe i sjelljes) gjatë përballjes me situata të vështira;
- Kapaciteti për t'i parë vështirësitë si sfida dhe mundësi për t'u rritur;
- Kapaciteti për t'u riaftësuar dhe për të reaguar.

## Pikë kontrolli

Përpiquni t'u jepni përgjigje pesë pyetjeve që vijojnë. Për të kontrolluar nëse përgjigjet tuaja janë korrekte, referojuni kapitujve përkatës.

1. Cili është ndryshimi ndërmjet një metodologjie për mbrojtjen e fëmijëve bazuar te të drejtat dhe asaj bazuar te nevojat e fëmijës? Si ndërlidhen këto dy metodologji me përgjegjësinë e individit, për të qenë një aktor kyç në mbrojtjen e vetvetes?
2. Ç'kuptojmë me reagim të mbrojtjes së fëmijës të integruar dhe të koordinuar?
3. Cilat janë popullatat kryesore të synuara për masat e mbrojtjes së fëmijëve?
4. Përkufizoni mirëqenien psiko-sociale.
5. Cilat janë reagimet dhe ndikimet parësore dhe dytësore psiko-sociale të situatave dhe ngjarjeve të dhimbshme?

# 4 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

Kapitulli i katërt paraqet një përmbledhje të instrumenteve kryesorë ligjorë, që kanë lidhje me përkrahjen psikosociale në mbrojtjen e fëmijëve. Kjo pjesë jep një informacion të përgjithshëm mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijës si edhe për zbatimin e saj në Shqipëri. Të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve të paraqitura në këtë Udhëzues, janë në përputhje me KDF-në dhe vlerat e saj.

## 4.1 Hyrje

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është përdorur në të gjithë botën për të nxitur dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Gjatë viteve që kanë pasuar përshtatjen e saj, bota ka parë arritje të mëdha në përmbushjen e të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, kujdes shëndetësor dhe arsimim, nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve bazë dhe një rritje të njohjes së nevojës për krijimin e një mjedisi miqësor, që i mbron fëmijët nga shfrytëzimi, abuzimi dhe dhuna. Megjithatë, ka shumë për të bërë në krijimin e një bote miqësore ndaj fëmijëve. Ritmi i progresit nuk ka qenë i njëjtë. Disa vende kanë mbetur shumë prapa vendeve të tjera, në dhënien e rëndësisë së duhur dhe përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në programet kombëtare. Ndërsa në disa rajone dhe shtete, një pjesë e përfitimeve të arritura, rrezikohen të humbasin për shkak të kërcënimeve si varfëria, konfliktet e armatosura dhe nga HIV/AIDS.

E hartuar duke u mbështetur mbi sisteme të ndryshme ligjore dhe tradita kulturore, Konventa përbën një paketë standardesh dhe detyrimesh të panegociueshme, të pranuar botërisht. Këto standarde bazë — që quhen, gjithashtu, të drejta të njeriut — përcaktojnë të drejtat dhe liritë

minimale që duhen respektuar nga qeveritë. Ato janë themeluar mbi respektin për dinjitetin dhe vlerat e çdo individi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimet, prejardhja, pasuria, statusi në lindje apo aftësia, dhe për këtë arsye, ato janë të përdorshme për çdo qenie njerëzore kudo në botë. Bashkë me këto të drejta, lindin edhe detyrimet, si nga ana e qeverive, ashtu dhe e individëve që të mos dhunojnë të drejtat paralele të të tjerëve. Këto standarde janë të ndërvarura dhe të pandashme; ne nuk mund të sigurojmë disa të drejta, pa arritur më parë disa të drejta të tjera.

**Çfarë është Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës?**
Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është një traktat ndërkombëtar që njeh të drejtat njerëzore të fëmijëve, të cilët përkufizohen si persona deri në moshën 18 vjeç. Konventa përcakton në ligjin ndërkombëtar se Shtetet Palë duhet të sigurojnë se të gjithë fëmijët — pa diskriminim të asnjë forme — përfitojnë nga masat e mbrojtjes së veçantë dhe nga përkrahja; kanë të drejtë të përfitojnë shërbime si, arsimim dhe kujdes shëndetësor; të zhvillojnë personalitetet e tyre, potencialin e plotë të aftësive dhe talenteve të tyre; të rriten në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi; si edhe të informohen dhe të marrin pjesë në procesin e arritjeve të të drejtave të tyre, në mënyrë të të hapur, pa pengesa dhe aktive.

**Cili është vizioni i ri i fëmijës në Konventë?**
Konventa ofron një paketë universale standardesh që duhen përmbushur nga të gjitha shtetet. Ajo pasqyron një vizion të ri të fëmijës. Fëmijët nuk janë as pronë e prindërve të tyre, as objekte të pavlera për t'u mëshiruar. **Ata janë qenie njerëzore dhe janë subjekti i të drejtave të tyre**. Konventa ofron një vizion të fëmijës si një individ **dhe** anëtar i familjes dhe i komunitetit, me të drejta dhe përgjegjësi të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tij/e saj. Duke i parë kështu të drejtat e fëmijës, Konventa vendos, në mënyrë të prerë, theksin te fëmija si një i tërë. Të konsideruara më parë si të negociueshme, nevojat e fëmijës janë kthyer tashmë në të drejta të detyrueshme ligjore. Fëmija nuk është më një marrës pasiv i përfitimeve, por, përkundrazi, tani ai/ajo është një subjekt apo zotërues të drejtash.

**Si e përkufizon fëmijën Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës?**
Konventa e përkufizon "fëmijën" si një person nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur ligjet përkatëse kanë përcaktuar një kufi më të ulët për moshën e rritur ku individi i ka të gjitha të drejtat.

**Si u vendos se çfarë duhej përfshirë në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve?**
Standardet në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, janë negociuar nga qeveritë, organizatat jofitimprurëse, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, avokatët, specialistët e shëndetit, punonjësit socialë, arsimtarët, ekspertë të zhvillimit të fëmijëve dhe nga udhëheqës fetarë nga e gjithë bota, gjatë një periudhe 10-vjeçare. Rezultati është një dokument konsensual, që merr parasysh rëndësinë e traditës dhe vlerave kulturore për mbrojtjen dhe zhvillimin harmonik të fëmijës. Ajo pasqyron sistemet ligjore kryesore të botës, si edhe merr parasysh nevojat specifike të vendeve në zhvillim.

**Si i mbron të drejtat e fëmijëve Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve?**
Ajo përbën një referencë të përbashkët mbi çka mund të vlerësohen progresi i arritur në përmbushjen e standardeve të të drejtave të njeriut si edhe krahasimi i rezultateve. Pasi kanë rënë dakord të përmbushin standardet në Konventë, qeveritë janë të detyruara të përshtasin legjislacionin, politikën dhe praktikat e tyre në përputhje me standardet e Konventës; për t'i transformuar standardet në një realitet për të gjithë fëmijët; për të hequr dorë nga çdo veprim që mund të pengojë gëzimin e këtyre të drejtave apo t'i dhunojë ato. Qeverive u kërkohet t'i raportojnë në mënyrë të vazhdueshme një komiteti ekspertësh të pavarur mbi progresin e tyre në arritjen e këtyre të drejtave.

**Si e monitoron dhe si e mbështet komuniteti ndërkombëtar progresin e arritur në zbatimin e Konventës?**
Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve, një trup ndërkombëtar ekspertësh të pavarur me qendër në Gjenevë, me detyrën e monitorimit të zbatimit të Konventës, u kërkon qeverive që kanë ratifikuar Konventën, të paraqesin rregullisht raporte mbi statusin e të drejtave të fëmijëve në vendet e tyre. Komiteti i shqyrton dhe bën komentet përkatëse mbi këto raporte dhe inkurajon shtetet të marrin masa të veçanta dhe të zhvillojnë institucione të veçanta për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Aty ku është e nevojshme,

Komiteti kërkon asistencë ndërkombëtare nga qeveritë e tjera dhe asistencë teknike nga organizata, siç është UNICEF-i.

**Sa shtete e kanë ratifikuar Konventën e të Drejtave të Fëmijëve?**
Konventa është ratifikuar prej më shumë shteteve se çdo traktat tjetër i të drejtave të njeriut në histori — 192 vende të botës janë bërë Shtete Palë të Konventës që prej Nëntorit 2005.

**A përbën Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës një instrument të detyrueshëm ligjor?**
Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është i pari instrument ndërkombëtar i detyrueshëm ligjërisht, që përfshin sferën e plotë të të drejtave të njeriut — civile, kulturore, ekonomike, politike dhe të drejtat shoqërore. Në vitin 1989, udhëheqës nga e gjithë bota vendosën se fëmijëve u nevojitej një konventë e veçantë vetëm për ta, pasi njerëzit nën moshën 18 vjeç, ndryshe nga të rriturit, kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje të veçantë. Por udhëheqësit donin të siguroheshin se edhe bota duhet ta njihte faktin që fëmijët kanë të drejta njerëzore.

Konventa i parashtron këto të drejta në 54 nene (për më tepër detaje, shih përmbledhjen e Konventës në Aneksin 1) dhe dy Protokollet Fakultativë. Ajo shpreh qartë të drejtat njerëzore bazë që kanë fëmijët në mbarë botën: të drejtën për të mbijetuar; për t'u zhvilluar plotësisht; për t'u mbrojtur nga ndikimet e dëmshme, abuzimi dhe shfrytëzimi; dhe për të marrë pjesë plotësisht në familje dhe jetën social-kulturore. Katër **parimet thelbësore** të Konventës janë: **mosdiskriminimi; përkushtimi ndaj interesit më të mirë të fëmijës; e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit; dhe respekti për pikëpamjen e fëmijës.** Çdo e drejtë e shkruar në Konventë, është në harmoni me dinjitetin njerëzor dhe zhvillimin harmonik të çdo fëmije. Konventa mbron të drejtat e fëmijëve duke vendosur standarde për kujdesin shëndetësor, arsimin dhe shërbimet ligjore, civile e sociale.

Duke miratuar përmbushjen e detyrimeve të Konventës (duke e ratifikuar apo duke iu përmbajtur asaj), qeveritë kombëtare janë angazhuar se do të mbrojnë dhe sigurojnë të drejtat e fëmijëve dhe se ato kanë rënë dakord të mbajnë përgjegjësi për këtë angazhim përpara komunitetit ndërkombëtar. Shtetet Palë në Konventë janë të detyruar të zhvillojnë dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe politikat në kuadër të interesave më të mira të fëmijëve.

# 4.2 Përgjegjësia për zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve

Zbatimi i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, kërkon përpjekje të vazhdueshme në nivel individual, komunitar, kombëtar dhe ndërkombëtar për zbatimin e standardeve dhe vlerave të parashtruara në traktat (shih Figurën 5).

**FIGURA 5**




Çdonjëri prej nesh mund të luajë një rol për të siguruar se çdo fëmijë e gëzon fëmijërinë. Në planin individual, nëse ju jeni një prind, mësues, specialist i mbrojtjes së fëmijëve apo ndonjë profesionist tjetër që punon me fëmijët, mund të kontribuoni në zbatimin e saj, duke rritur ndërgjegjësimin për Konventën e të Drejtave të Fëmijës te fëmijët, duke i përfshirë fëmijët në vendimmarrjet përkatëse dhe duke vepruar sipas vlerave të KDF-së. Në nivelin e komunitetit, duhet të verifikohet nëse veprimet dhe politikat e ndërmarra nga qeveria, janë në përputhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, nëse komunitetet janë të përfshirë në prezantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe nëse ekziston një forum për pjesëmarrjen e fëmijëve në shoqëri. Në planin kombëtar, parlamentarët mund të sigurojnë se i gjithë legjislacioni ekzistues dhe praktikat

gjyqësore, janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të vendit, nismat e qeverisë, politikat dhe buxhetet, duhet të monitorohen. Komuniteti ndërkombëtar duhet të përkrahë dhe të integrojë interesin më të mirë të fëmijëve në të gjitha vendimet e marra.

## 4.3 Nenet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) që kanë të bëjnë me ofrimin e masave mbrojtëse psiko-sociale për fëmijët

Të gjithë fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit, sipas instrumenteve të caktuar kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Dhunimi i qëllimshëm i të drejtave në rastet komplekse të mbrojtjes së fëmijëve, është një karakteristikë e shpeshtë dhe një faktor i rëndësishëm që ka ndikim në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës. Ngritja e zërit për mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi, dhe aksesi i shërbimeve bazë si uji i pastër, strehimi dhe arsimimi, është njëra nga mënyrat më të efektshme për të promovuar mirëqenien psiko-sociale.

**Cilat nene të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) mund të përdor për të siguruar mbështetje psiko-sociale?**

**Mbrojtja nga abuzimi dhe nga mospërfillja. – NENI 19** përcakton detyrën e qeverive për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e keqtrajtimit prej prindërve apo të tjerëve, që janë përgjegjës për fëmijën dhe ndërtimin e programe sociale për të parandaluar abuzimin dhe për të mbështetur riaftësimin psiko-social të fëmijës.
**Kujdesi rehabilitues – NENI 39** përcakton detyrën e qeverive për të siguruar se çdo fëmijë i prekur nga një konflikt i armatosur, tortura, moskujdesja, keqtrajtimi apo shfrytëzimi, mund të marrë mbështetje psiko-sociale për të rifituar mirëqenien.

# 4.4 Një panoramë e përgjithshme e kuadrit ligjor të Shqipërisë mbi të Drejtat e Fëmijëve

**Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve**
Shqipëria ka firmosur Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve në mars të vitit 1992. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, konventa e ratifikuar nga Parlamenti është bërë pjesë e sistemit ligjor shqiptar dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për më tepër, ajo ka përparësi mbi ligjet e vendit që nuk janë në përputhje me të. Autoritetet shqiptare kanë për detyrë ta zbatojnë atë dhe ta përafrojnë legjislacionin shqiptar në përputhje me standardet e KDF-së.

**Legjislacioni shqiptar**
Kushtetuta shqiptare, që përbën ligjin më të lartë të vendit, ofron një fushë të gjerë mbrojtjeje për fëmijët në kuadrin e dispozitave të përgjithshme dhe lirive thelbësore, dhe në veçanti nëpërmjet nenit 54, që garanton se të drejtat e tyre janë të mbrojtura nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe puna e fëmijëve, veçanërisht nën minimumin e moshës për punë, gjë që mund të dëmtojë shëndetin dhe moralin e tyre apo të vërë në rrezik zhvillimin e tyre normal.

Përveç kësaj Kushtetuta njeh dhe garanton në një dispozitë të veçantë të drejtën e arsimimit, duke përfshirë arsimin e detyrueshëm shkollor (që përcaktohet me ligj), arsimim publik falas dhe të drejtën e arsimimit në shkollat publike dhe private në të gjitha nivelet.

Përsa i përket legjislacionit, nuk ekziston ndonjë ligj i veçantë që të trajtojë vetëm të drejtat e fëmijëve. Çështjet që kanë të bëjnë me mbrojt-

**NENI 19.1:** Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

**NENI 19.2:** Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

jen e fëmijëve, janë të përfshira në aktet e ndryshme ligjore, duke përfshirë ligjet, legjislacionin dytësor si edhe strategjitë kombëtare, që përmbajnë dispozita të veçanta mbi të drejtat e fëmijëve.

**Aktet kryesore ligjore në këtë fushë, janë:**

1. Kodi i Familjes, që mbron të drejtat e fëmijëve në lidhje me familjen e tyre;
2. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, që përmbajnë paragrafë të veçantë për krimet e kryera ndaj fëmijëve dhe procedura të veçanta për minorenët që kanë kryer shkelje ligjore;
3. Kodi i Punës, që përcakton moshën minimale të punës dhe ndalon punën e detyruar;
4. Legjislacioni mbi shërbimet sociale që përcakton kriteret dhe mënyrat e ndërhyrjes së shtetit për fëmijët në nevojë;
5. Legjislacioni mbi arsimin, i cili përfshin disa ligje dhe nën-ligje që rregullojnë sistemin arsimor në Shqipëri;
6. Legjislacioni mbi kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen e minorenëve nga konsumi i pijeve alkoolike;
7. Strategjia Kombëtare për Fëmijët, e adoptuar në vitin 2005 nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e cila parashtron katër nisma që duhen ndërmarrë për përmirësimin e situatës së fëmijëve në fusha të ndryshme në përputhje me detyrimet e KDF-së.

Megjithëse legjislacioni ekzistues shqiptar siguron në një shkallë të lartë mbrojtjen e fëmijëve, ai duhet zhvilluar më tej, që të mund të jetë në gjendje të integrojë në mënyrë të plotë të drejtat e tyre. Një element i rëndësishëm mbetet shtimi i aktivitetit të institucioneve të shtetit, që kanë për detyrë zbatimin e legjislacionit.

**NENI 39:** Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim, duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

# Të gjithë mund të marrin pjesë në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve!

**Problemet me të cilat përballen sot fëmijët në Shqipëri[1]:**
Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005, ishin zgjedhjet e para në Shqipëri kur u krye tranferimi paqësor i pushtetit qysh prej vitit 1992. Por ndërkohë që demokracia në vend maturohet, Shqipëria mbetet një prej kombeve më të varfra në Evropë. Të kequshqyerit është fenomen i përqendruar veçanërisht në zonat rurale dhe në rajonet veriore.

- × Pak nëna shtatzënë marrin kujdesin e duhur përpara lindjes. Vdekjet e fëmijëve të sapolindur, mbajnë numrin më të madh të vdekjeve foshnjore dhe të fëmijëve.
- × Mbijetesa e fëmijëve është përmirësuar dukshëm qysh prej vitit 1990. Por disa rajone, veçanërisht në verilindje dhe në periferitë e Tiranës dhe të Durrësit, vazhdojnë të mbeten prapa.
- × Pavarësisht regjistrimit të lartë në shkolla, vetëm rreth 52 për qind e fëmijëve e frekuentojnë arsimin fillor.
- × Shtatëdhjetë për qind e fëmijëve romë nuk kanë çertifikata lindjeje, që u nevojiten për të frekuentuar shkollën apo për të përfituar nga shërbimet shëndetësore në klinikat publike.
- × Faktorë të ndryshëm rreziku – duke përfshirë migrimin, hezitim për përdorimin e kondomëve dhe një rritje të përdorimit të drogave intravenoze – rrezikojnë shtimin e rasteve me HIV/AIDS te të rinjtë.
- × Trafikimi i fëmijëve mbetet akoma një shqetësim. Disa familje të varfra i dërgojnë fëmijët e tyre për të punuar jashtë vendit apo varen nga fëmijët që lypin nëpër rrugë.
- × Nuk ekziston asnjë strukturë e qeverisë që të mbajë përgjegjësi direkte për zgjidhjen e problemit të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve, qoftë në familje apo në institucionet që kujdesen për ta.

**Aktivitetet dhe rezultatet për fëmijët**

- × Qeveria ka marrë përgjegjësinë e plotë për financimin e imunizimeve rutinë. Mbulimi në shkallë vendi tani e kalon 97 për qind

1 Informacion i publikuar në faqen e internetit të UNICEF-it: www.unicef.org në prill të vitit 2007

- Në komunitetin urban, si edhe në atë rural, tani regjistrohen 99 për qind e lindjeve.
- Në rrethet e Veriut të Shqipërisë, qindra punonjës të kujdesit shëndetësor janë trajnuar për kujdesin para lindjes dhe atë obstetrik dhe menaxhim më të mirë të rasteve të sëmundjeve te fëmijët.
- Konsultoret dhe grupet e mbështetjes me bazë komuniteti i inkurajojnë nënat të ushqejnë fëmijët e tyre me gji.
- Një Program i ri Bashkëpunimi Kombëtar nënshkruar në vitin 2006 nga qeveria e Shqipërisë dhe UNICEF-i, është fokusuar në ofrimin e shërbimeve bazë për popullatat në rrezik, veçanërisht fëmijët dhe gratë nga minoritetet etnike dhe zonat rurale.
- UNICEF-i vazhdon të promovojë kudo jodizimin e kripës, gjë që do të eliminonte çrregullimet e mungesës së jodit.
- Në bashkëpunim me UNICEF-in, qeveria e Shqipërisë financon blerjen e ilaçeve antiretrovirale për të prekurit nga HIV/AIDS. Iniciativa të tjera përfshijnë bërjen e analizave te të rinjtë për HIV/AIDS, të cilat ruajnë konfidencialitetin, si edhe mësime në shkollë për të rritur ndërgjegjësimin mbi parandalimin e HIV/AIDS-it.
- Është hartuar një Plan Kombëtar Veprimi për të luftuar trafikimin e fëmijëve. Greqia dhe Shqipëria po bashkëpunojnë së bashku përgjatë kufirit për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.
- Ka filluar gjithashtu një projekt për të reformuar sistemin shqiptar të drejtësisë për të rinjtë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës po bashkëpunon me UNICEF-in për të hartuar programe dhe standarde të reja shkollore.

## Përmbledhje

Parimet dhe vlerat e parashtruara në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, duhet të drejtojnë të gjitha reflektimet dhe veprimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Në veçanti katër parimet thelbësore të Konventës: **mosdiskriminimi; përkushtimi ndaj interesit më të mirë të fëmijëve; e drejta për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin; si edhe respekti për pikëpamjet e fëmijës, duhet të merren parasysh gjithmonë.** Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve përballen vazhdimisht me balancimin e këtyre katër parimeve; për shembull respekti për pikëpamjet e fëmijës ndaj asaj çka është në interesin më të mirë të fëmijës.

Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të përshtaten me rrethanat lokale dhe të mbështesin reagimin e tyre për mbrojtjen e fëmijëve te burimet ekzistuese për të garantuar shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipërinë e sotme.

## Pikë kontrolli

Përpiquni t'i jepni përgjigje pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet tuaja janë korrekte, referojuni kapitujve përkatës.

1. Kur është krijuar Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës?
2. Çfarë të reje sjell Konventa në lidhje me vizionin për fëmijët dhe fëmijërinë?
3. Kush përgjigjet për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Shqipëri?
4. Kur e ka firmosur Shqipëria Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës?
5. Cilat janë sfidat më të mëdha që kanë lidhje me zbatimin e Konventës mbi Drejtat e Fëmijës në Shqipëri sot?

**Anekset e Pjesës A:**

**ANEKSI 1** Përmbledhje e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës

# Seksioni B

# Mandati i shkollës në mbrojtje të fëmijëve

# 5 Mandati i mbrojtjes së fëmijëve në sistemin e arsimit publik

Kapitulli i pestë përshkruan kuadrin e përgjitshmëm dhe si të kuptohet roli i shkollës dhe aktorëve të saj në mbrojtje të fëmijëve.

## 5.1 Arsimimi dhe mbrojtja e fëmijëve në Shqipëri

Aktualisht, fëmijët janë një nga grupet më të ekspozuara dhe të pambrojtura ndaj rrezikut dhe fenomeneve negative sociale në Shqipëri. Gjatë dhjetë viteve të fundit, me mijëra fëmijë shqiptarë kanë qenë viktima të trafikimit, jashtë dhe brenda vendit, dhe kanë vuajtur forma të ndryshme shfrytëzimi, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe punën. Fenomeni u bë më i dukshëm në vitin 1999, kur një numër i madh fëmijësh filluan të mungonin për një kohë të gjatë ose përgjithmonë nga shkolla. Ende në ditët e sotme, fëmijët që e braktisin apo mendojnë ta braktisin shkollën, përballen me rrezikun e madh të trafikimit të tyre, ndërsa një numër i konsiderueshëm fëmijësh shqiptarë, viktima të trafikimit, nuk kanë pasur mundësi të shkojnë ndonjëherë në shkollë.

Braktisja e shkollës vjen nga faktorë të ndryshëm, shpesh jashtë kontekstit shkollor. Shumë shpesh, familja e fëmijës nuk e di rëndësinë e pjesëmarrjes në shkollë për shkak të kushteve ekonomike dhe sociale, ose të botëkuptimit të tyre mbi rolin e fëmijës në familje. Megjithatë, braktisja e shkollës mund të jetë një vendim i marrë dhe nga vetë fëmija prej faktorëve të ndryshëm të brendshëm, si diskriminimi ose lënia pas dore në mjedisin e shkollës. Zakonisht, fenomeni shkaktohet nga një ndërveprim faktorësh të ndryshëm dhe ndaj duhet trajtuar në mënyrë komplekse.

Siç parashtrohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Fëmijës, arsimimi është një nga kriteret bazë për zhvillimin e shëndetshëm dhe të sigurt të fëmijës (shiko shtojcën 1; – KDF – Objektivat e edukimit). Ndërsa prindërit luajnë rolin kryesor për rritjen e fëmijëve, shkollat luajnë një rol të rëndësishëm për integrimin e tyre në shoqëri. Shkolla mbetet një nga instrumentet e para përmes së cilës, fëmija kupton dhe bëhet pjesë e komunitetit. Gjithashtu, ajo luan një rol të domosdoshëm për zhvillimin e personalitetit, aftësive dhe talentit të fëmijës. Për më tepër, fëmijët që braktisin shkollën janë të ekspozuar ndaj shumë fenomeneve negative sociale, përfshi punën, abuzimin, shfrytëzimin dhe trafikimin.

Autoritetet shqiptare i njohin tashmë rreziqet dhe faktorët e riskut për shfrytëzimin dhe trafikimin e fëmijës dhe kanë filluar ta referojnë problemin nëpërmjet krijimit të njësive antitrafik, si dhe me anë të adoptimit të strategjive kombëtare për të mbrojtur fëmijët nga trafikimi. Megjithatë, ende nuk është krijuar një rrjet operativ sigurie për mbrojtjen e fëmijëve, që të krijojë një urë lidhëse me sistemin arsimor, komunitetet në rrezik dhe shërbimet sociale. Sistemi arsimor po përparon, duke i përfshirë problemet e fëmijëve në rrjedhën e programeve mësimore. Megjithatë, duhen përforcuar përpjekjet në këtë drejtim. Në disa raste këto përpjekje pengohen nga kapacitetet ekzistuese të personelit, kufizimet financiare dhe mungesa e koordinimit me ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale publike dhe private.

Pavarësisht kësaj, mjedisi shkollor është struktura qendrore për mbrojtjen e fëmijëve. Sistemi arsimor luan një rol thelbësor për zbulimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve në nevojë.

Ky Manual do të ndihmojë në ngritjen dhe përforcimin e rolit të shkollave për mbrojtjen e fëmijëve.

Prandaj, vetë shkolla është një nga institucionet kryesore për mbrojtjen e fëmijëve në nevojë apo për riintegrimin e tyre. Siç përmendet edhe

më sipër, shkolla luan një rol thelbësor në mbrojtjen e fëmijëve nga fenomenet negative dhe ndihmon drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre të sigurt dhe të shëndetshëm. Për të vijuar këtë ide, aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të përqendrohen në bashkëpunimin e personelit arsimor, familjeve/komuniteteve si dhe të partnerëve të interesuar zyrtarë ose privatë, për të siguruar zbulimin e fëmijëve në rrezik dhe riintegrimin e viktimave me probleme trafikimi.

Ministria e Arsimit, Terre des Hommes, Unicef-i dhe OJF të tjera partnere, e pranojnë nevojën aktuale për të zhvilluar një praktikë të koordinuar me bazë komuniteti për të ndihmuar fëmijët në nevojë, nëpërmjet krijimit të një rrjeti shumëdisiplinor në mbrojtje të fëmijëve. Të gjitha organizatat e dinë rolin e rëndësishëm të shkollës në këtë proces. Gjithashtu, të gjithë aktorët kanë besim në angazhimin gjithnjë e në rritje të shkollës për këtë, siç edhe u vërtetua nga përfshirja dhe zhvillimi i rolit të psikologut në shkolla. Nisma e fundit e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të ofruar shërbimin psikologjik në shkolla, synon të përkrahë zhvillimin e plotë të fëmijëve në shkolla dhe të mbështesë rritjen e procesit arsimor. Psikologët kanë një pozicion strategjik lidhur me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla. Detyra e tyre është të jenë pika referimi, si për personelin arsimor, ashtu edhe për prindërit dhe nxënësit. Informacioni që marrin psikologët është i rëndësishëm për përmirësimin e marrëdhënieve mësues-nxënës, veç kësaj për të ndihmuar fëmijët që përballen me probleme të ndryshme në shkollë. Psikologu ka për detyrë të ndihmojë fëmijët që ndjehen të diskriminuar, të lënë pas dore dhe që përballen me probleme psiko-sociale në familje, përfshirë presionin për të braktisur shkollën për shkak të lëndimeve ose streseve psikologjike të lidhura me mjedisin shkollor. Dhe më tej, sipas përgjegjësive që kanë, ata vendosin lidhjet mes komunitetit, ofruesve të shërbimeve publike dhe private dhe shkollës mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Pikërisht për

**Shembulli i Trafikimit të Fëmijëve**
Që prej vitit 2003, 155 fëmijë në rrezik dhe viktima të trafikimit, rreth 10 për qind të gjithë fëmijëve nën mbrojtjen e TACT (Aksioni Transnacional kundër Trafikimit të Fëmijëve), janë identifikuar prej fushatave sensibilizuese në shkolla dhe në disa rrethana, rastet i janë referuar Terre des Hommes nga mësuesit dhe drejtorët. Për më tepër, numri i zbulimeve dhe parandalimeve prej bashkëmoshatarëve, është rritur, si rezultat i drejtpërdrejtë i fushatave sensibilizuese në sistemin arsimor shqiptar. Ndihmuar nga informacioni i dhënë prej fëmijëve të tjerë, Terre des Hommes në bashkëpunim me autoritetet shtetërore, ka arritur të parandalojë me sukses rastet e trafikimit të fëmijëve.

këtë arsye, psikologu i shkollës ka pozicionin më të përshtatshëm për të koordinuar problemet për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla dhe për të përmbushur detyrat e specialistit të fëmijëve në shkolla. Në ato zona ku nuk është hapur vendi i psikologut, mund të caktohet si specialist për mbrojtjen e fëmijëve një anëtar tjetër i personelit pedagogjik, si për shembull, nëndrejtori apo një përgjegjës lënde.

Ky Manual për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzuesi i tij praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve, duhet të ndihmojnë për të mbushur boshllëqet ekzistuese në kapacitete dhe burime për Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve në shkolla, duke pasur si objektiv ecurinë e mëtejshme të mandatit për mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e arsimit publik. Nëpërmjet këtij procesi, roli i shkollës në mbrojtjen e fëmijëve, do të formalizohet dhe institucionalizohet me caktimin, trajnimin dhe veprimin e një Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili koordinon dhe referon raste në rrjetin për mbrojtjen e fëmijëve të aktorëve të komunitetit dhe partnerëve të interesuar publikë, si dhe zbaton standardet për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë.

## 5.2 Shkollat dhe mbrojtja e fëmijëve në mbarë botën

Të gjitha mjetet e mbrojtjes së fëmijëve dhe procedurat e paraqitura në këtë Manual, janë rezultat i një procesi bashkëpunimi, ku ekspertët ndërkombëtarë dhe kombëtarë nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve dhe arsimit përshtatën koncepte, standarde dhe procedura të provuara ndërkombëtare me kontekstin shqiptar. Bazuar në përvojën e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla në SHBA, Britani të Madhe, Australi dhe Zvicër, janë hartuar praktikat më të mira dhe udhëzimet për Shqipërinë.

Çdo vend në Evropë ka një strukturë të ndryshme për mbrojtjen e fëmijëve, në varësi të rrethanave lokale. Njëkohësisht, të gjitha vendet e Evropës përpiqen të arrijnë të njëjtin rezultat dhe i bazojnë procedurat e tyre për sigurinë e fëmijëve mbi të njëjtat vlera dhe parime. Ky Manual ka për qëllim të ofrojë mjete dhe procedura të përshtatura me realitetin e sotëm në Shqipëri, por që mund të zhvillohen më tej për të përballuar edhe vështirësitë e së ardhmes.

Organizimi i një rrjeti të qartë bashkëpunues brenda shkollës dhe sigururimi i lidhjeve me partnerët e interesuar, duhet t'ju ndihmojë për të mbajtur parasysh vizionin përfundimtar. Ndërsa realiteti i sotëm nganjëherë duket i ndryshëm dhe kërkon fleksibilitet dhe përshtatje në zbatimin e procedurave, akoma dhe më tepër rritet rëndësia e asaj që strukturat të jenë të qarta dhe që të ndërmerren hapa për të punuar drejt objektivit të përbashkët. Për ta ankoruar anijen në port, duhet të kihet parasysh një destinacion i qartë dhe një busull e mirë.

Ndërkohë që një rrjet i mbrojtjes së fëmijëve është gati për t'u ngritur dhe për t'u rizbatuar, të gjithë punonjësit e mbrojtjes, aktualisht po ballafaqohen me sfidën e përballjes së shumë situatave të vështira, ndërsa kanë pak burime dhe struktura të mundshme për t'iu referuar. Gjatë viteve të ardhshme do të bëhet përpjekje për t'u fuqizuar strukturat ekzistuese dhe për t'u krijuar më shumë shërbime të specializuara për fëmijët dhe ndërkohë, më shumë se kurrë, duhet të gjenden zgjidhje krijuese lidhur me menaxhimin

e rasteve dhe menaxherët e rasteve, duhet të kenë një vizion të qartë në mendje që të qëndrojnë në udhën e duhur dhe të motivuar. Me përvojën e shtuar të të gjitha strukturave të përfshira në mbrojtjen e fëmijëve (të komunitetit, shërbimet sociale dhe të shkollës), masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe përgjigjet do të bëhen përherë e më ndikuese.

**Anekset e Kapitullit 5:**

**ANEKSI 2** KDF – qëllimet e edukimit

# 6 Aktorët dhe përgjegjësitë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla

Kapitulli i gjashtë bën një përmbledhje të aktorëve të përfshirë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, duke vënë në dukje rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

**Rolet dhe përgjegjësitë profesionale**

Për koordinimin e rrjetit shumëdisiplinor për mbrojtjen e fëmijëve, është shumë e rëndësishme të përcaktohen si duhet detyrat dhe përgjegjësitë e çdo aktori. Qartësimi i roleve dhe mandateve ndihmon për t'u siguruar se aktivitetet dhe ndërhyrjet, janë kryer në interes të fëmijës dhe për të përforcuar angazhimin profesional të çdo personi të përfshirë.

Siç theksohet edhe në këtë pjesë, prania e aktorëve mund të lëvizë ndjeshëm nga një rajon në tjetrin, prandaj është e rëndësishme të mbështetemi në burimet njerëzore ekzistuese të kushteve të caktuara të një rajoni, duke patur në mendje vizionin ideal të një rrjeti shumëdisiplinor të mbrojtjes së fëmijëve.

**Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve (SMF) në shkollë**

Si Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkollë, psikologu i shkollës, ose në mungesë të tij, nëndrejtori i shkollës apo një person tjetër i ngarkuar (për shembull, mësues, përgjegjës lënde), do të koordinojë aktivitetet parandaluese, zbulimet dhe referimet e rasteve si dhe riintegrimin e fëmijëve në kushtet e shkollës, si një detyrë e tij/saj shtesë e natyrshme për të:

- siguruar shërbime të drejtpërdrejta për fëmijët dhe nxënësit në nevojë;
- siguruar shërbime këshilluese dhe trajnime për personelin pedagogjik të shkollës dhe prindërit;
- konceptuar dhe realizuar shërbimin psikologjik në përputhje me zhvillimin e politikave arsimore dhe të institucioneve të arsimit;
- siguruar koordinimin me ofruesit e shërbimit publik për një përgjigje shumëdisiplinore për mbrojtjen e fëmijëve;
- organizuar aktivitete parandaluese me nxënësit
- zbatuar një procedurë të përbashkët për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla për të koordinuar ndjekjen e rasteve dhe monitorimin e tyre për qëllime statistikore.

Bazuar në përkufizimin e OBSH-së (Organizatës Botërore të Shëndetit) mbi zhvillimin e shëndetshëm dhe mirëqenien e fëmijës, Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla, duhet të jetë në gjendje të mbështetet në një ekip shumëdisiplinor për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, përfshirë drejtorin e shkollës/zëvendës drejtorin, punonjësin social të shkollës dhe infermieren ose/dhe mjekun, nëse është e nevojshme. Nëse rastet nuk janë në natyrën e shkollës, SMF-ja ka kompetenca për t'ia referuar rastet punonjësit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe ai/ajo do të kryejnë kontrollet e nevojshme dhe vlerësimet e rastit (për më shumë mbi detyrat e SMF shihni gjithashtu **KAPITUJT 9** deri **12**).

**Drejtori i shkollës**

Drejtori i shkollës është përgjegjës për sigurinë e fëmijëve në shkollën e tij. Ai/ajo siguron kushtet e nevojshme të punës për Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve në shkollë, garanton që të vendosen standardet e mbrojtjes së fëmijëve në procesin e rekrutimit të personelit arsimor dhe ndihmon në planifikimin e aktiviteteve parandaluese në shkollë apo aktiviteteve të tjera që lidhen me standardet dhe vlerat e mbrojtjes së fëmijëve.

**Punonjësi social i shkollës (PSS)**
Punonjësi social në shkollë është përgjegjës për aktivitetet parandaluese në mbrojtje të fëmijëve me nxënësit dhe bashkëpunon nga afër me Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve në organizimin e aktiviteteve psikosociale për grupet specifike. Kjo detyrë mund të kryhet nga një mësues i caktuar ose vullnetar tjetër, në rast se në shkollën tuaj nuk është parashikuar ende një detyrë e tillë.

**Mësuesit**
Mësuesit kanë për detyrë të identifikojnë fëmijët në nevojë, fëmijët në rrezik dhe viktimat e abuzimit, t'i referojnë ata te SMF-ja dhe të ndihmojnë SMF-në për riintegrimin e fëmijëve në mjedisin e shkollës. Mësuesit janë përgjegjës për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të tyre profesionale për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, duke marrë pjesë në aktivitetet sensibilizuese dhe trajnimet e propozuara nga SMF-ja ose partnerët e tjerë.

**Komiteti i prindërve dhe prindërit**
Komiteti i prindërve luan një rol thelbësor në lidhjen midis shkollës dhe komunitetit kur ofrohet mbrojtja e fëmijës. Komiteti i prindërve mund të jenë një burimi i rëndësishëm informacioni për zbulimin e rasteve si dhe partner kryesor në riintegrimin e fëmijëve. Pos kësaj, prindërit që kanë nevojë për ndihmë duhet të përfshihen në aktivitete sensibilizuese dhe gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të veprimit, gjithmonë në interes fëmijës së tyre.

**Nxënësit**
Nxënësit janë aktorë të rëndësishëm për krijimin e rrjetit të mbrojtjes në shkollën e tyre. Mbështetja mes bashkëmoshatarëve dhe masat e sigurisë, janë një pjesë thelbësore e rrjetit të sigurisë në shkollë. Nxënësit duhet të dëgjohen gjithmonë dhe idetë e opinionet e tyre duhet të përfshihen në procesin e vendimmarrjes.

**Senati i nxënësve**
Senati i nxënësve luan një rol të rëndësishëm për zbulimin e fëmijëve në nevojë, me anë të ndihmës shok me shok, riintegrimin e asistuar të fëmijëve në mjedisin shkollor, si dhe për organizimin e aktiviteteve parandaluese.

**Grupi i vëzhgimit i shkollës për mbrojtjen e fëmijëve**
Ky grup përbëhet nga nxënës të moshave të ndryshme dhe vepron si katalizator për të realizuar mekanizma mbështetjeje për njeri-tjetrin në gjirin e shkollës. Ky grup i vogël nxënësish të motivuar, punon ngushtë me SMF-ne për të planifikuar aktivitete parandalimi dhe për të mbështetur fëmijët në nevojë për t'u mbrojtur (për shembull, sistem shokësh). Grupi i vëzhgimit në mbrojtje të fëmijëve, i planifikon aktivitetet me mbështetjen dhe udhëzimet e SMF-së.

**Mjeku i shkollës dhe personeli tjetër mjekësor**
Çdo shkollë duhet të ketë një infermier ose ndihmësmjeke për kryerjen e kontrolleve mjekësore sa herë të jetë e nevojshme.

**Grupi Task Force për mbrojtjen e fëmijëve**
Ky grup ngarkohet me detyrën qe të përparojë zbatimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe të vlerave në shkollë (për më shumë detaje, referohuni **KAPITULLIT 7.3**)

**Punonjësi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)**
Punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, është partneri kryesor i SMF-së brenda strukturës së shërbimit social për të gjitha rastet që tejkalojnë mandatin e SMF-së dhe që lipset t'i referohen një autoriteti tjetër përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. SMF-ja duhet të mbështesë aktivitetet parandaluese të PMF-së në gjirin e komunitetit. Nga ana tjetër, PMF-ja mund të ofrojë informacion mbi partnerët e disponueshëm lokalë për reagimin në mbrojtje të fëmijëve, trajnime për personelin pedagogjik etj.

**Inspektori i Policisë**
Inspektori i policisë, qe mbulon një zonë të caktuar ku ndodhet shkolla, duhet të jetë në dispozicion për të marrë pjesë në aktivitete parandaluese (si, për shembull, për rendin publik, për sigurinë në rrugë, etj) dhe/ose për të marrë masa mbrojtëse për fëmijët në rastet e kriminalitetit, të sjelljeve tejet agresive dhe kur raportohen raste të abuzimit ndaj fëmijëve.

# 7 Zbatimi i standardeve për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla

Kapitulli i shtatë përmban një udhësues ku tregohen hap pas hapi standardet dhe vlerat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe mënyrat se si të përmbushen ato në shkolla. Aj ofron një mundësi të mirë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë dhe profesionalizmit për ata që punojnë me fëmijët në shkolla, por çka është më me rëndësi, do të ndihmojë për të arritur me fëmijët rezultate më të mira në dobi të tyre.

## 7.1 Hyrje

Më shumë se pesëmbëdhjetë vjet pas ratifikimit pothuajse të përbotshëm të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, ka ende shumë për të bërë që të sigurohet respektimi dhe mbrojtja e plotë e të drejtave të fëmijëve. Shpesh, në mënyrë të padukshme, fëmijët vazhdojnë të jenë ende sot të ekspozuar ndaj dhunës në kontekste të ndryshme në çdo rajon të botës, si dhe në Shqipëri. Përcaktimi i normave të qarta kombëtare në përputhje me standardet ndërkombëtare, është një arritje e rëndësishme, por gjithmonë duhet pasuar nga veprimet.

Natyrisht, ata që punojnë me fëmijët dhe kujdesen për ta, luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces, pasi ata përballen hapur me sfidat për të kthyer parimet dhe idetë e normave kombëtare dhe ndërkombëtare, në pjesë të realitetit të përditshëm.

Këto përpjekje kërkojnë një njohje shumë të mirë të roleve dhe përgjegjësive për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës. Për të arritur rezultate të suksesshme, ekipi dhe përfaqësuesit e tjerë, duhet të jenë të qartë për rolet që kanë dhe përgjegjësitë që marrin kur bashkëveprojnë në mënyrë direkte ose indirekte me fëmijët.

## 7.2 Standardet e mbrojtjes së fëmijëve[1]

**Pse standardet?**

Standardet përdoren në fusha të ndryshme të jetës. Ato përshkruajnë nivelin bazë të realizimit ose cilësisë së kërkuar që një produkt apo shërbim të jetë sa më i efektshëm dhe puna të bëhet ashtu siç duhet. Në këtë rast, jemi duke përcaktuar se çfarë duhet bërë që shkollat t'i mbrojnë fëmijët. Por te standardet futen edhe treguesit e **kritereve,** që do t'ju ndihmojnë të vendosni nëse është përmbushur një standard. Kriteri jep detajet e hapave që një shkollë duhet të ndërmarrë që të mundë të përmbushë standardet në çdo fushë.

**Zbatimi i standardeve duke ju përshtatur kushteve lokale.**

Standardet janë shkruar asisoj, që i bën ata të përshtatshëm dhe të prekshëm. Në të njëjtën kohë, duhet pranuar se ata mund të jenë më të vështirë apo më sfidues për t'u zbatuar në disa rrethe dhe kushte lokale, sesa në disa të tjera. Ka shumë variacione në praktikat dhe rrethanat lokale, prandaj është e rëndësishme që shkollat të përshtasin ato stan-

**NENI 19 – Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF)**
Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha llojet e dhunës fizike apo mendore, dëmtimet ose abuzimet, neglizhimin ose lënien pas dore, keqtrajtimin ose shfrytëzimin, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa është nën kujdesin e prindit (prindërve), të kujdestarëve ligjorë, apo të çdo personi tjetër që kujdeset për fëmijën.

**1** Përshtatur nga www.keepingchildrensafe.org.uk

darde dhe udhëzime që lidhen me kushtet lokale ku do të zbatohen. Megjithatë, parimet që mbështesin këto standarde (poshtë) duhet të jenë gjithmonë në përputhje me to dhe standardet nuk duhet të ndryshohen aq shumë, sa fëmijët të mbeten pa mbrojtje.

## Avantazhet e zbatimit të standardeve të mbrojtjes së fëmijëve

1 **Fëmijët janë të mbrojtur**
Asnjë standard nuk mund të ofrojë mbrojtje të plotë për fëmijët, por zbatimi i këtyre standardeve zvogëlon rrezikun e abuzimit dhe të shfrytëzimit të fëmijëve.

2 **Përfaqësuesit e shkollave janë të mbrojtur**
Duke i zbatuar këto standarde, për të gjithë përfaqësuesit do të jetë e qartë se si duhet të sillen ata me fëmijët dhe se çfarë duhet të bëjnë kur siguria e një fëmije përbën shqetësim.

3 **Shkolla është e mbrojtur**
Duke i zbatuar këto standardeve, shkollat shprehin qartë angazhimin e tyre për të mbrojtur fëmijët. Standardet do t'i ndihmojnë shkollat të zgjedhin praktikat më të mira në këtë fushë dhe të frenojnë abuzuesit e mundshëm.

# 7.3 Udhëzim hap pas hapi si të zbatosh standardet e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla

**HAPI 1** **Krijimi i një grupi task forcë**
Krijoni një **grup task forcë** për mbrojtjen e fëmijëve në shkollën tuaj. Ky grup duhet të përbëhet nga gjashtë anëtarët e mëposhtëm; përfaqësuesi i bordit të shkollës, drejtori apo zëvendës drejtori i shkollës, specialisti i mbrojtjes së fëmijëve në shkollë dhe/ose psikologu i shkollës, mësuesi kujdestar, përfaqësues nga komiteti i prindërve dhe përfaqësues nga qeveria e nxënësve.

**HAPI 2** **Përpunimi i planit të veprimit**
Grupi i task forcës shqyrton vetëvlerësimin e bërë nga shkolla ➥ **ANEKSIN 1** dhe merr vendime në bazë të përparësive. Duke patur parasysh listën e plotë të kërkesave për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, përgatitet dhe monitorohet një plan veprimi për të arritur standardet ➥ **ANEKSIN 4**.

**HAPI 3** **Përmbushja e standardeve**
Ndërmerren veprime konkrete për të fuqizuar rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkollë dhe për të përmbushur dhjetë standardet për mbrojtjen e fëmijëve.

**HAPI 4** **Vlerësimi i ndikimit**
Grupi task forcë në shkollën tuaj përcakton tregues të qartë për të matur efektin e veprimeve të ndërmarra dhe për të parë nëse standardet janë arritur ➥ **ANEKSIN 4** dhe vlerëson rregullisht nivelin e arritjes së këtyre standardeve. Vetëvlerësimi i shkollës duhet të shqyrtohet çdo dy vjet ➥ **ANEKSIN 3**, politikat dhe procedurat duhet të rishikohen çdo 3 vjet, udhëzuesi referues duhet të shihet çdo 6 deri në 12 muaj. Për të siguruar cilësinë e veprimeve për mbrojtjen e fëmijës, duhet të bëhen vlerësime të rregullta të brendshme dhe të jashtme (për më shumë informacion referojuni ➥ **KAPITULLIT 8**).

# Një përmbledhje e standardeve

1. Një politikë dhe deklaratë e shkruar për mbrojtjen e fëmijëve
2. Zbatimi i politikës në praktikë
3. Parandalimi i dëmtimeve të fëmijëve
4. Udhëzime të shkruara për sjelljen me fëmijët
5. Plotësimi i standardeve në shkollën tuaj
6. E drejta e barabartë e të gjithë fëmijëve për t'u mbrojtur
7. Transmetimi i plotë i mesazhit
8. Edukim dhe trajnim në mbrojtje të fëmijëve
9. E drejta për këshillim dhe mbështetje
10. Zbatimi dhe monitorimi i standardeve

## 1 Një politikë dhe deklaratë e shkruar për mbrojtjen e fëmijëve

**Cili është standardi?**
Të gjitha shkollat duhet të kenë një politikë të shkruar për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo përgjithësisht njihet si politika për mbrojtjen e fëmijëve.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Politika thekson se shkolla është e angazhuar për t'i mbrojtur fëmijët. Ajo bën të qartë për të gjithë se fëmijët duhen mbrojtur, ndihmon për të krijuar një mjedis të sigurt dhe pozitiv për fëmijët dhe tregon se shkolla e ka marrë seriozisht detyrën e përkujdesjes. I gjithë personeli i shkollës nënshkruan një deklaratë mbi mbrojtjen e fëmijëve ku ata shprehin angazhimin e tyre.

**Kriteret**

1. Shkolla ka një politikë për mbrojtjen e fëmijëve.
2. Politika është shkruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
3. Politika është publikuar, prezantuar dhe shpërndarë gjerësisht.
4. Politika është miratuar dhe nënshkruar nga struktura përkatëse e menaxhimit (për shembull, anëtarët e Bordit të Shkollës, Drejtori i Shkollës, Nëndrejtori, personeli pedagogjik, Komiteti i Prindërve, qeveria e nxënësve).

5 Të gjithë personeleve dhe përfaqësuesve të tjerë, iu kërkohet pa përjashtim t'i përmbahen politikës.
6 Politika rishikohet të paktën çdo tre vjet dhe përshtatet sa herë ka ndryshime të rëndësishme në shkollë apo ndryshime ligjore.
7 Politika përshkruan qartë kuptimin dhe përkufizimet e shkollës për shqetësimet që ajo ka lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

**Mënyra se si sigurohen prova**
Për të dëshmuar se standardet janë përmbushur, mund të përdoren dokumentet e mëposhtme:

- një kopje e dokumentit të shkruar të politikës për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurave ➥ **ANEKSIN 5**
- një listë me emra që tregon se kujt i është dërguar dokumenti i shkruar i politikës për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë
- shembuj me mënyrat se si është promovuar politika me mësuesit, komunitetet, prindërit dhe fëmijët.
- një kopje e dokumentit të politikës së firmosur nga bordi drejtues i shkollës
- deklarata për mbrojtjen e fëmijëve e firmosur nga të gjithë anëtarët e personelit, ku deklarojnë se ata e kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar politikën dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve të shkollës.
- dokumenta dhe statistika të shkruara se si trajtohen në shkollë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, dhe një program me afate për rishikimin (shiko edhe ➥ **KAPITULLIN 8** për më shumë informacion mbi sistemin e shkollës për menaxhimin e rasteve në mbrojtje të fëmijëve).

**E rëndësishme!**
Në ➥ **ANEKSIN 5** do të gjeni një shembull të standardizuar **të procedurave dhe politikës së shkollës** për mbrojtjen e fëmijëve. Rekomandohet që të gjithë shkollat të zbatojnë po këtë politikë dhe procedurë. Nëse për kushtet lokale del e nevojshme të bëhen modifikime dhe përshtatje, ato duhet të miratohen nga grupi i task forcës së shkollës për mbrojtjen e fëmijëve dhe një kopje e politikave dhe procedurave të modifikuara, duhet t'i jepet Drejtorisë Rajonale të Arsimit. Në faqen 73 do të gjeni një shembull **të deklaratës për mbrojtjen e fëmijëve,** e cila duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët e personelit arsimor dhe aktorët e tjerë që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# Deklaratë personale pjesë e kontratës / mandatit (vullnetar ose me pagesë) me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

**UNË I NËNSHKRUARI** ...........................................................................

**DEKLAROJ SI MË POSHTË:**

1 Se në të kaluarën nuk kam qenë i dënuar për qëndrime të papajtueshme apo neglizhim në detyrë, që kujdesi ndaj fëmijëve apo të miturve kërkon, se nuk jam ndëshkuar ndonjëherë me masë administrative të ndjekjes për vepra penale apo shkelje të normave të sjelljes, që vënë në rrezik integritetin fizik apo psikologjik të fëmijëve.

2 Se kam marrë në dorëzim dhe kam lexuar me vëmendje dokumentin mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve (procedurat dhe materialet plotësuese) dhe se marr përsipër ta respektoj këtë politikë, këtë dokument, që do të jetë në rifreskim të vazhdueshëm, e në përdorim do të jetë gjithnjë versioni i fundit, dhe të gjithë anëtarët e personelit do të azhornohen me zhvillimet e reja.

3 Se jam vënë në dijeni se, në rast dyshimi për sjellje të papajtueshme me përgjegjësinë që ka mbrojtja e fëmijëve dhe në kundërshtim me politikën e parandalimit të përcaktuar nga Terre des hommes, institucioni rezervon të drejtën të ndërmarrë masa mbrojtëse, duke përfshirë dhe pezullimin e përkohshëm, se jam vënë në dijeni se mbi bazën e provave të vazhdueshme dhe incidenteve të njohura në kundërshtim me mbrojtjen e fëmijëve që unë do të kem në kujdestari, institucioni do të marrë masat e duhura administrative dhe ligjore, pa kufizim në kohë e në hapësirë, si brenda vendit, ku incidenti mendohet të ketë ndodhur, ashtu dhe në vendin tim të origjinës dhe/ose vendqëndrimin tim.

4 Se jam vënë në dijeni se, në rast të përfundimit të kontratës për shkak të shkeljes të integritetit fizik dhe psikologjik të fëmijëve, instituti rezervon të drejtën të informojë institucione të tjera, që mund të kërkojnë referenca profesionale, mbi përfundimin e kontratës për shkelje të rënda të parimeve të mbrojtjes së fëmijëve, brenda kuadrit legjislativ që zbatohet për ruajtjen e fshehtësisë së informacionit.

**DATË** ............................ **VENDI** ...........................................

**NËNSHKRIMI** ..............................................

2

# Zbatimi i politikës në praktikë

**Cili është standardi?**
Duhet të ketë udhëzime të qarta se si duhet vepruar kur ndodh ndonjë incident për mbrojtjen e fëmijëve, ose kur lind ndonjë shqetësim brenda shkollës.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Procedurat dhe udhëzimet e qarta do t'ju ndihmojnë të siguroheni se për shqetësimet rreth sigurisë dhe mirëqenies së fëmijës, do të keni reagime të menjëhershme. Gjithashtu, ato ndihmojnë shkollën të përmbushë çdo kërkesë ligjore apo udhëzim praktik.

**Kritere**

1. Për mbrojtjen e fëmijëve ka procedura të qarta në fuqi, që ofrojnë udhëzime hap pas hapi mbi veprimet që duhen ndërmarrë, nëse ka probleme për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.
2. Procedurat për mbrojtjen e fëmijëve janë të disponueshme për këdo (përfshi fëmijët, prindërit/kujdestarët dhe mësuesit) si dhe promovohen në mënyrë aktive. Rëndësi i duhet dhënë edhe gjuhës, mënyrave të ndryshme të komunikimit dhe duhet të sigurohemi se kushdo mund ta gjejë me lehtësi informacionin.
3. Procedurat për mbrojtjen e fëmijëve janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe janë një praktikë e mirë për mbrojtjen e fëmijëve. Ato duhet të marrin gjithashtu parasysh problemet që lindin si rezultat i konteksteve të ndryshme rajonale.
4. Në çdo nivel të sistemit shkollor, ka një person ose persona me përgjegjësi të përcaktuar qartë për mbrojtjen e fëmijëve në çdo nivel të sistemit të shkollës.
5. Ekziston një proces për regjistrimin e incidenteve, shqetësimeve, referimeve dhe grumbullimin e tyre në mënyrë të sigurt, kështu që informacioni konfidencial vihet në vend të mbrojtur.
6. Ekziston një procedurë për të trajtuar ankimet e prindërve/kujdestarëve dhe të rinjve rreth sjelljeve të papranueshme dhe/ose abuzive kundrejt fëmijëve, me afate kohorë të qartë për zgjidhjen e ankesave.
7. Ekziston një udhëzim mbi konfidencialitetin dhe shpërndarjen e informacionit, që qartëson se mbrojtja e fëmijëve është çështja më e rëndësishme.

**Duhet të siguroheni se keni informacionin e mëposhtëm:**

- si t'i përgjigjeni një fëmije që thotë se ai, ose një fëmijë tjetër, po përjeton abuzime.
- si t'u përgjigjeni dyshimeve kundër një pjesëtari të stafit apo një personi tjetër
- si t'u përgjigjeni çështjeve që kanë të bëjnë me mirëqenien e fëmijës, kur ka dyshime, por nuk është dhënë asnjë deklaratë specifike
- detajet e kontaktit për shërbimet lokale për mbrojtjen e fëmijëve, nëse ekzistojnë.
- informacion mbi njerëzit e përfshirë, për shembull, cilët fëmijë dhe familje dhe cilët përfaqësues
- përkufizimet e abuzimit dhe shqetësimet e fëmijëve
- si disa grupe fëmijësh janë veçanërisht të prekshëm, përfshi fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Mënyra për sigurimin e provave**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për të mbledhur prova, nëse janë përmbushur standardet;

- një kopje e procedurave dhe udhëzimeve të shkruara ➥ **ANEKSIN 6**
- një diagramë, që përshkruan hapat në procesin e mbrojtjes së fëmijëve ➥ **ANEKSIN 8**
- emrat dhe detyrat e personave me përgjegjësi të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla
- shembuj formularësh për regjistrimin e detajeve të incidenteve në mbrojtjen e fëmijëve (për më shumë informacion, shiko Udhëzuesin Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve)
- statistika mbi raportimet dhe veprimet në mbrojtje të fëmijëve ➥ **ANEKSIN 6**

# 3 Parandalimi i dëmtimeve të fëmijëve

**Cili është standardi?**

Ekzistojnë procedura që ndihmojnë në pakësimin e mundësive të abuzimit të fëmijëve prej njerëzve që u ndodhen afër dhe te të cilët fëmijët besojnë.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Disa njerëz që punojnë ose kërkojnë të punojnë në shkolla, mund të përbëjnë një rrezik për fëmijët. Rreziku mund të reduktohet dhe të parandalohet abuzimi, duke marrë disa masa specifike.

**Kritere**

1. Ekzistojnë mënyra të miratuara për rekrutimin e personelit arsimor dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre për të punuar me fëmijët.
2. Të gjithë ata persona që kanë mundësinë për kontakte të rregullta me fëmijët ose që fëmijët u besojnë, plotësojnë një formular ku deklarojnë nëse kanë precedent penal dhe u kërkohet ta paraqesin, ku është e mundur, për verifikime të tjera.
3. Ekzistojnë procedura të qarta, si jashtë dhe brenda shkollës, për anëtarët e personelit mësimor, për të ngritur shqetësimet e tyre rreth sjelljeve të papranueshme ndaj fëmijëve nga anëtarët e tjerë të personelit, në mënyrë konfidenciale, nëse është e nevojshme.
4. Ekzistojnë udhëzime mbi vlerësimin e të gjithë rreziqeve të mundshme kur punohet me fëmijët, sidomos në aktivitetet që zhvillohen larg shtëpisë.
5. Projektet dhe programet sigurojnë se fëmijët po mbikëqyren siç duhet dhe po mbrohen në çdo çast.
6. Ekzistojnë udhëzime për përdorimin siç duhet të teknologjisë informative (si, email, aparatet dixhitale, faqet e internetit, interneti), për t'u siguruar se fëmijët nuk janë në rrezik apo të ekspozuar ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit.

**Duhet të siguroheni që keni informacionin e mëposhtëm:**

- × të gjithë pjesëtarëve të personelit që kanë kontakte të rregullta me fëmijët, u duhen marrë të paktën dy referenca të përshtatshme, dëshmia e identitetit, si dhe kualifikimet përkatëse.
- × një politikë për rekrutimin që të zbatohet për këdo që ka kontakt me fëmijët, edhe nëse kontakti nuk është i drejtpërdrejtë apo pjesë e punës së tyre.
- × strategji parandalimi që pasqyron faktin se abuzimi nuk është planifikuar domosdoshmërisht që më përpara.
- × udhëzime bazë për krijimin e faqeve të internetit, përdorimin e videove dhe fotografive të fëmijëve.

**Mënyra për të siguruar prova**
Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për të siguruar prova nëse është përmbushur standardi:

- një kopje e metodave të miratuara mbi rekrutimin ➥ **ANEKSIN 5**.
- shembuj aplikimesh, referencash dhe formularësh deklarimi.
- një kopje të dokumentit që shpjegon se si përfaqësuesit mund të diskutojnë në mënyrë konfidenciale shqetësimet e tyre për fëmijët me personelin drejtues, si dhe informacioni për këtë procedurë.
- përdorimi i instrumenteve që ndihmojnë në përcaktimin e rreziqeve të fëmijëve gjatë planifikimit të aktiviteteve për fëmijët, si dhe hartimin e udhëzimeve në mbrojtje të fëmijëve.
- shembull planifikimi për transportimin e fëmijëve ose organizimin e udhëtimeve me to.
- evidenca të provave të shkruara të kontaktit me/ose identifikimin e agjencive që mund të sigurojnë të dhëna për sjelljen në të kaluarën të një aplikuesi, si për shembull, informacioni për precedentë penalë, etj.

## 4 Udhëzime të shkruara për sjelljen me fëmijët

**Cili është standardi?**
Ekzistojnë udhëzime të shkruara që përshkruajnë se çfarë është një sjellje e përshtatshme, si për shembull kodet e sjelljes ose kodet e praktikës me fëmijët.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Fëmijët duhet të jetojnë në një mjedis të sigurt, pozitiv dhe që inkurajon një atmosferë të mësuari. Standardet e shkruara të sjelljes, duhet të përcaktojnë për të gjithë se çfarë është sjellje e pranueshme dhe e papranueshme ndaj fëmijëve. Këto udhëzime mund të ndihmojnë në minimizimin e mundësive të abuzimit dhe ndihmojnë në parandalimin e deklarimeve të rreme kundër personelit të shkollave dhe përfaqësuesve të tjerë.

**Kritere**

1 Ekzistojnë udhëzime të shkruara për sjelljen.
2 Shkolla siguron udhëzime për standardet e përshtatshme/të pritshme të sjelljes së të rriturve ndaj fëmijëve.
3 Ekziston një udhëzim mbi normat e pranueshme të sjelljes së fëmijëve ndaj fëmijëve të tjerë.
4 Ekzistojnë alternativa, mënyra pozitive për edukimin e fëmijëve me normat e sjelljes, që nuk përfshijnë ndëshkime fizike apo ndonjë formë tjetër trajtimi poshtërues ose denigrues.
5 Drejtoria e shkollës dhe mësuesit kujdestarë, promovojnë atë kulturë që siguron se fëmijët dëgjohen dhe respektohen si individë.
6 Pasojat e thyerjes së rregullave janë të qarta dhe të lidhura me procedurat disiplinore të shkollës.

**Duhet të siguroheni që keni informacionin e mëposhtëm:**

× udhëzime të shkruara që përshkruajnë se çfarë është sjellje e përshtatshme e të rriturve me fëmijët, si në punë dhe në komunitet.
× informacionin që bën të qartë se diskriminimi, paragjykimi, sjellja despotike ose gjuha, nuk janë të pranueshme për: racën, kulturën, moshën, gjininë, paaftësitë, besimet fetare, këndvështrimet seksuale ose politike.

**Mënyra për të siguruar prova**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për të siguruar prova, nëse është përmbushur standardi:

× udhëzime për sjelljet i rritur-fëmijë (shiko kodin e sjelljes në ➥ **ANEKSIN 5**) dhe sjellje fëmijë-fëmijë (shih shembujt më poshtë)

**Kodi i sjelljes për nxënësit**[2]

× Nxënësi tregohet i vëmendshëm gjatë mësimit në shkollë;
× Nxënësi është i kujdesshëm me fjalorin që përdor me mësuesit dhe me shokët e shkollës;
× Nxënësi është një shembull i mirë për shokët dhe shoqet e tij/saj të shkollës;
× Nxënësi mëson të komunikojë në mënyrë korrekte, të tregojë respekt dhe të kërkojë shpjegime;
× Nxënësi i njeh të drejtat dhe përgjegjësitë e tij/saj;

**2** Kodi i sjelljes për nxënësit duhet të përgatitet gjithnjë në bashkëpunim me ta

- Nxënësi e di se ku të ankohet, nëse të drejtat e tij/saj nuk respektohen;
- Nxënësi merr pjesë aktivisht në përcaktimin e politikave dhe në mbrojtjen e shkollës së tij/saj.

Ky kod është shkruar nga Grupi Task Forcë i shkollës së mesme "Perikli Jkonomi" në Fier.

## 5 Përmbushja e standardeve në shkollën tuaj

**Cili është standardi?**
Ekzistojnë udhëzime të qarta për mënyrën se si do të përshtaten udhëzimet e shkollës në përputhje me kushtet lokale.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Personeli mësimor shqiptar punon në kontekste të larmishme me variacione të mëdha në të kuptuarit dhe realizmin e mbrojtjes së fëmijëve. Ndonjëherë, ka përkufizime të ndryshme se çfarë do të thotë abuzim i fëmijës. Shkolla duhet t'i japë udhëzime të qarta personelit, prindërve dhe partnerëve të tjerë lokalë për mënyrën se si do të përshtatet dhe do të zbatohet praktikisht në këto kushte të ndryshme politika për mbrojtjen e fëmijëve. Udhëzimet duhet të zbatohen të atilla që të reflektojnë mjediset e ndryshme lokale, por pa përdorur praktika që janë të dëmshme për fëmijën.

**Kritere**

1. Shkolla kryen një inspektim lokal për të analizuar masat ligjore të marra, ato për mirëqenien sociale dhe për mbrojtjen e fëmijëve në kushtet ku punon.
2. Udhëzimet përfshijnë dallimin midis fëmijëve, që në përgjithësi, kanë nevojë për mbrojtje dhe fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje ndaj veprimeve specifike keqtrajtuese.
3. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve ose ekuivalenti rajonal, përcaktohet qartë si dokumenti bazë për mbrojtjen e fëmijëve.

4 Zhvillohet një dialog dhe diskutim gjithëpërfshirës nga mund të zgjidhen mospajtimet mes sjelljes të pranuar nga komuniteti dhe sjelljes të pranueshme sipas politikës së mbrojtjes së fëmijëve.
5 Ekziston një procedurë e përshtatshme për të raportuar dhe për t'ju përgjigjur incidenteve dhe problemeve të mbrojtjes së fëmijëve, që përshtatet me sistemet vendore për trajtimin e incidenteve të abuzimit të fëmijës.
6 Ka një udhëzim mbi krijimin e një procedure raportimi, të bazuar në sistemin dhe burimet lokale për mbrojtjen e fëmijëve.

**Duhet të siguroheni që keni informacionin e mëposhtëm:**
× këshilla se si të arrini të njihni komunitetin dhe përkufizime për abuzimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.
× një dokument që bën të qartë se fëmijë është një person nën moshën 18 vjeç.

**Mënyra për të siguruar prova**
Dokumenti i mëposhtëm mund të përdoret për të siguruar prova, nëse është përmbushur standardi:
× një dokument që përshkruan praktikat e përdorura.
× një dokument me listën e kontakteve të referimit për këshillime me specialistin ➥ **ANEKSIN 7**

## 6 Të drejta të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u mbrojtur

**Cili është standardi?**
Janë ndërmarrë hapa për të plotësuar nevojat e të gjithë fëmijëve për t'u mbrojtur nga abuzimi.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Abuzimi ndodh si ndaj djemve ashtu edhe vajzave të të gjitha moshave, racave, gjinive, besimeve fetare ose me aftësi të kufizuara, ndaj prirjeve seksuale, në mjedise shoqërore ose kulturore të ndryshme. Disa fëmijë, si ata me aftësi të kufizuara, janë më të prekshëm. Paragjykimi dhe diskriminimi, mund t'i pengojnë disa fëmijë të marrin ndihmën për të cilën kanë

nevojë dhe shkollat duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar se të gjithë fëmijët janë të mbrojtur dhe marrin mbështetjen që kërkojnë.

**Kritere**

1 Politika për mbrojtjen e fëmijëve e bën të qartë se të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për t'u mbrojtur.
2 Procedurat për mbrojtjen e fëmijëve, udhëzimet dhe trajnimet i ndihmojnë personat përgjegjës të njohin rreziqet e veçanta, me të cilat përballen disa fëmijë dhe vështirësitë e tjera me të cilat përballen kur kërkojnë ndihmë, për shkak të racës, gjinisë, moshës, besimit fetar ose aftësive të kufizuara, prirjeve seksuale, mjedisit shoqëror ose kulturës.
3 Kodet e sjelljes përfshijnë deklarata rreth përgjegjësisë së të rriturve dhe fëmijëve për të trajtuar njeri-tjetrin me dinjitet, respekt, ndjeshmëri dhe korrektesë.
4 Kodet e sjelljes e bëjnë të qartë se të gjitha qëndrimet që diskriminojnë, fyejnë apo janë të dhunshme, janë të papranueshme dhe se ndaj tyre do të bëhen ankimimet përkatëse.
5 Proceset për shqyrtimin e ankesave janë të drejta dhe transparente si dhe përfshijnë të drejtën për apelim.

**Të siguroheni që keni informacionin e mëposhtëm:**

× një deklaratë të shkruar, ku thuhet se shkolla është angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve.

**Mënyra për të siguruar prova**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për të siguruar prova, nëse është përmbushur standardi:

× kopje të paragrafëve nga udhëzimet e miratuara përkatëse.
× shembuj se si programet trajnuese përfshijnë çështjet e barazisë dhe mbrojtjes së fëmijëve.
× një kopje të formës së ankesave dhe dokumentin që shpjegon procedurën e marrjes në pyetje.

# 7 Transmetimi i mesazhit në kontekst të gjerë

**Cili është standardi?**
Ndërtohen metoda dhe procedura për të siguruar që çdo person në shkollë të dijë si t'u japë përgjigje shqetësimeve që dalin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, se si të merret opinioni i tyre për mbrojtjen e fëmijëve, dhe se si t'iu dëgjohet mendimi.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Politikat dhe procedurat e përpunuara nga shkollat në mbrojtje të fëmijëve, janë të dobishme vetëm kur njerëzit janë të vetëdijshëm për to, kur ata mund të ndihmojnë për zhvillimin e tyre dhe kanë mundësi të shprehin idetë e tyre për mënyrën se si ato funksionojnë.

**Kritere**

1. Informacioni rreth angazhimit të shkollave në mbrojtje të fëmijëve, duhet të jetë i hapur dhe i disponueshëm për të gjithë.
2. Fëmijët duhet të informohen për të drejtën e tyre për të qenë mbrojtur nga abuzimi.
3. Informacioni për fëmijët, mësuesit dhe prindërit/kujdestarët vihet në dispozicion për t'i udhëzuar se ku të kërkojnë ndihmë në raste abuzimi me fëmijët dhe për probleme të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.
4. Informacioni është në format dhe gjuhë të thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë, duke përfshirë edhe fëmijët.
5. Të gjithë në shkollë duhet ta dinë kush janë personat përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe si mund t'i kontaktojnë ata.
6. Bëhen të disponueshme detajet e kontaktit për shërbimet lokale për mbrojtjen e fëmijëve, si qendrat për fëmijë, shërbimet e avokatisë, institucionet shtetërore, urgjencat mjekësore dhe linjat lokale telefonike për ndihmë.
7. Ndërmerren hapa për të mësuar mendimin e fëmijëve mbi politikat dhe procedurat dhe se si funksionojnë ato.

**Duhet të siguroheni që keni informacionin e mëposhtëm:**

- një proces për t'u siguruar se fëmijët dëgjohen dhe u merret mendimi, për t'u siguruar se zëri i tyre dëgjohet dhe se idetë e tyre informojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e masave mbrojtëse në shkollë.

**Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për të siguruar prova, nëse është përmbushur standardi:**

- shembuj të burimeve dhe materialeve, që nxisin dëgjimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve, duke përfshirë edhe ato me metoda të ndryshme komunikimi.
- aktivizohen në shkollë grupet e kontrolli të mbrojtjes së fëmijëve.
- informacion se kush është dhe ku ndodhet Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, tek i cili mund të drejtohen fëmijët dhe të rriturit kur kanë një problem ose shqetësim dhe si ta kontaktojnë atë (shiko shembullin e komunikimit në faqen 49).
- programe edukative që përfshijnë udhëzime për të mbrojtur fëmijët dhe informacionin mbi të drejtat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi.

**SHEMBULL I MJETIT TË KOMUNIKIMIT PËR TË GJITHË PRINDËRIT DHE MËSUESIT**

# Mbrojtja e fëmijëve është shqetësim për të gjithëve ne!

Ju lutem, plotësoni pyetësorin[3] dhe përgjigjjuni çdo pyetjeje me **PO** ose **JO**. Për të gjitha pyetjet e përgjigjura me **PO**, ju lutem caktoni numrin e fëmijëve në mjedisin tuaj që e kanë këtë problem.

**Cilat janë rrethanat e shqetësimit tënd?**

- E **pe** vetë abuzimin me fëmijën? **PO** ◌ **JO** ◌
- A **dyshon** se dikush ka abuzuar me fëmijët? **PO** ◌ **JO** ◌
- A të ka **pohuar** ndokush për abuzim me fëmijë? **PO** ◌ **JO** ◌
- A të është **hapur** ndokush për abuzim me fëmijë? **PO** ◌ **JO** ◌

**3** I gjithë informacioni trajtohet në fshehtësi!

**A i përshtatet shqetësimi yt ndonjërës prej kategorive të mëposhtme të abuzimit?**

- Mendon se fëmija është **neglizhuar**? PO ◌ JO ◌
- Mendon se fëmija mund të jetë abuzuar **fizikisht**? PO ◌ JO ◌
- Mendon se fëmija mund të jetë abuzuar **emocionalisht**? PO ◌ JO ◌
- Mendon se fëmija mund të jetë abuzuar **seksualisht**? PO ◌ JO ◌
- A njeh ndonjë fëmijë që n**uk ndjek shkollën rregullisht**? PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që **nuk shkon fare** në shkollë? PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që shfaq probleme të vazhdueshme me **shëndetin**? PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që nuk merr pjesë në **aktivitete (lojëra)**? PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që ka **dëmtime të dyshimta fizike** PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që është **agresiv**, shumë i **ndjeshëm**, pasiv apo **i ngjitur**? PO ◌ JO ◌
- Njeh ndonjë fëmijë që shfaq **sjellje seksuale** anormale për grupmoshën e tij/saj apo kontekstin shoqëror? PO ◌ JO ◌

**Nëse i jeni përgjigjur me Po ndonjërës prej pyetjeve të mësipërme, detyra juaj është të raportoni shqetësimin tuaj te njëri nga personat e mëposhtëm, mos vononi, fëmija mund të jetë në rrezik të ndonjë dëmtimi të rëndë!**

**Personit të kontaktit në shkollë:**

| | |
|---|---|
| **EMRI** | ............................................................ |
| **TITULLI** | Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| **VENDNDODHJA** | ............................................................ |
| **TELEFONI** | ............................................................ |
| **E-MAIL** | ............................................................ |

Nëse keni shqetësime rreth informimit të këtij personi, ju lutem, këshillohuni me personin në tabelën tjetër.

**Personi i kontaktit në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve**

| | |
|---|---|
| **EMRI** | ........................................................ |
| **TITULLI** | Punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| **VENDNDODHJA** | ........................................................ |
| **TELEFONI** | ........................................................ |
| **E-MAIL** | ........................................................ |

Ky person do të shikojë informacionin dhe, nëse është e nevojshme, do të aprovojë hapa emergjence dhe një plan veprimi me afatet kohorë dhe përgjegjësitë.

# 8 Edukimi dhe trajnimi në mbrojtjen e fëmijëve. Cili është standardi?

Ekzistojnë mundësi trajnimi për personelin, me qëllim që të zhvillojë dhe ruajë qëndrimet, dijet dhe shprehitë e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Gjithsecili që është në kontakt me fëmijët, ka rolin e tij në mbrojtjen e tyre. Ata mund ta kryejnë këtë rol në mënyrë konfidenciale dhe efikase, vetëm nëse mbajnë qëndrimin e duhur ndaj fëmijëve, janë të informuar siç duhet për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve si dhe nëse kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura për t'i mbrojtur ata. Shkollat kanë përgjegjësinë për të ofruar trajnime dhe mundësi zhvillimi për personelin e tyre si dhe të sigurojnë që fëmijët përfshihen në programe për të mësuar më shumë për mbrojtjen e tyre. Duhet të krijohen mundësi trajnimi për personelin që të zhvillojë dhe konsolidojë shprehitë e nevojshme që shërbejnë për të mbrojtur fëmijët.

**Kritere**

8 Të gjithë anëtarët e personelit, prindërit, vullnetarë dhe kolegë të tjerë, duhet të trajnohen rreth mbrojtjes së fëmijëve kur ata kanë lidhje me shkollën. Në këto trajnime përfshihet dhe një prezantim i politikave dhe procedurave të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve.

9 Të gjithë anëtarët e personelit, prindërit dhe vullnetarët, duhet të kenë mundësinë të mësojnë si të njohin dhe t'u përgjigjen problemeve për mbrojtjen e fëmijës.

10 Fëmijët duhet të këshillohen dhe mbështeten për të mbrojtur veten.

11 Anëtarët e personelit mësimor dhe vullnetarët me përgjegjësi të veçanta për sigurinë e fëmijës, kanë mundësi për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme shprehitë dhe njohuritë e tyre.

12 Ju ofrohet trajnim edhe atyre personave që merren me ankesat dhe procedurat disiplinore në lidhje me abuzimin e fëmijëve dhe sjelljen e papërshtatshme me ta.

13 Personave përgjegjës për rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit, iu ofrohet trajnim dhe u jepen udhëzime të shkruara mbi praktikën e rekrutimit.

14 Ekzistojnë mundësitë për të mësuar nga eksperienca e rasteve praktike gjatë trajnimit në shkollë dhe programit të zhvillimit profesional.

**Duhet të siguroheni që keni në dispozicion kushtet, si më poshtë:**

- një mënyrë për të identifikuar nevojat e personelit për trajnim.
- buxhet për ekipin e trajnimit mbi mbrojtjen e fëmijëve.
- njerëz me eksperiencë në mbrojtjen e fëmijëve dhe që mund të ofrojnë trajnim.

**Mënyra për të siguruar prova**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për t'u siguruar nëse është përmbushur standardi:

- një kopje të planeve dhe ose/programeve trajnuese
- regjistrime për pjesëmarrje në kurs
- dokumentim/udhëzime hyrëse
- vlerësime të kursit
- program javor për këshillim kolegësh për SMF-të
- programi i trajnimit për anëtarët e grupit të vëzhgimit në mbrojtje të fëmijëve për identifikimin dhe ndihmën mes kolegëve

# 9 E drejta për këshillim dhe mbështetje

**Cili është standardi?**
Merren masa për të siguruar informacionin thelbësor dhe për të mbështetur personat përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. Fëmijët që kanë nevojë për t'u ndihmuar, ndihmohen.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**
Abuzimi i fëmijëve është shqetësues dhe mund të jetë i vështirë për t'u trajtuar. Shkollat e kanë për detyrë të japin këshilla dhe të mbështesin njerëzit që kanë rolin e tyre në mbrojtjen e fëmijëve. Fëmijët kanë nevojë për dikë ku të mbështeten, kur dikush abuzon me ta. Ndodh shpesh që ata nuk dinë se kujt t'i drejtohen për ndihmë.

**Kritere**

1. Fëmijëve do t'iu ofrohet informacioni se ku të drejtohen për ndihmë dhe këshilla në lidhje me abuzimin, ngacmimet dhe dëmtimet, si dhe shqetësime që lidhen me mbrojtjen e tyre.
2. Pjesëtarët e personelit me përgjegjësi të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve, gëzojnë të drejtën për këshilla, mbështetje dhe informacion të veçantë mbi mbrojtjen e fëmijëve.
3. Vendosen kontakte në nivel kombëtar dhe/ose në nivel lokal me agjencitë kompetente për mbrojtjen/mirëqenien e fëmijëve, që mund të ofrojnë informacion, mbështetje dhe ndihmë për fëmijët dhe personelin mësimor.
4. Merren masa për t'i ofruar mbështetje individëve, pjesëtarëve të personelit dhe familjeve, gjatë dhe pas një incidenti, raportimit të një abuzimi apo paraqitjes së ankesës.

**Duhet të siguroheni që keni në dispozicion kushtet, si më poshtë:**

× ekipin e caktuar që mund të ofrojë këshillime dhe udhëzime **(SMF)**.
× marrëdhënie pune efektive me personelin lokal dhe organizata të tjera, që mund t'i ofrojnë mbështetje fëmijëve.

**Mënyra për të siguruar prova**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për t'u siguruar nëse është përmbushur standardi:

- kopje të informacionit për fëmijët rreth burimeve të mbështetjes.
- informacione (fletëpalosje, fletë informacioni) rreth trajnimeve, këshillave dhe mbështetjeve për stafin, prindërit dhe fëmijët.
- listën e kontakteve për këshillimi me specialistë dhe informacion të veçantë ➥ **ANEKSIN 7**.

# 9 Zbatimi dhe monitorimi i standardeve

**Cili është standardi?**

Shkolla zhvillon një plan veprimi për të monitoruar frytshmërinë e hapave që po ndërmerr për të mbrojtur fëmijët.

**Pse duhet ta përmbushin shkollat këtë standard?**

Për të mbrojtur fëmijët, politikat, procedurat dhe planet duhet të zbatohen në të gjithë mjedisin shkollor. Kontrollet janë të nevojshme për t'u siguruar se ato po zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Idetë e personave të përfshirë, si brenda ashtu dhe jashtë shkollës, mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të çdo mase të ndërmarrë.

**Kritere**

1. Ekziston një plan i shkruar veprimi, që tregon se çfarë hapash duhen marrë për të mbrojtur fëmijët, kush është përgjegjës për zbatimin e këtyre masave dhe kur do të përfundohen ato.
2. Janë në dispozicion burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e planit.
3. Politikat dhe praktikat analizohen në intervale të rregullta, teorikisht të paktën një herë në tre vjet dhe rishikohen në bazë të ndryshimeve në nevoja, legjislacion, udhëzime, ndryshime praktike eksperiencash në shkollë, e kështu me radhë.
4. Ekzistojnë procedura për të kërkuar mendimin e fëmijëve, prindërve/kujdestarëve dhe personelit mësimor mbi politikat dhe praktikat për mbrojtjen e fëmijëve.
5. Regjistrohen dhe monitorohen të gjitha incidentet, deklaratat për abuzim dhe ankesat.

6 Janë marrë masa për të monitoruar përputhjen e politikave dhe procedurave për mbrojtjen e fëmijëve.
7 Është ngritur një grup vëzhgimi për mbrojtjen e fëmijëve për të përforcuar identifikimin e problemeve lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga vetë fëmijët.

**Duhet të siguroheni që të organizoni:**

× takime të rregullta menaxhimi, si mbikëqyrje, sesione vlerësimi si dhe takime të grupit për të siguruar mundësinë e monitorimeve të vazhdueshme për zbatimin e politikave.
× mënyra për t'u konsultuar me fëmijët se sa të sigurt ndjehen në shkollë dhe se çfarë do të bënin nëse do të kishin ndonjë ankesë.

**Mënyra për të siguruar prova**

Dokumentet e mëposhtme mund të përdoren për t'u siguruar nëse është përmbushur standardi:

× një kopje me shkrim e politikës për mbrojtjen e fëmijëve.
× caktimi i një date të planifikuar për analizë dhe kush është përgjegjës.
× një përmbledhje e numrit të incidenteve të abuzimit dhe të ankesave ➥ **ANEKSIN 4**
× emrat e anëtarëve të grupit të vëzhgimit në mbrojtje të fëmijëve, lista e aktiviteteve dhe e identifikimit të problemit.
× lista e masave të marra për të ngjallur dashurinë për shkollën te fëmijët.
× shembull formulari vlerësimi të ndikimit, me qëllim që të analizohen ndryshimet në përputhje me treguesit e përcaktuar në mënyrë të qartë.

SHEMBUJ FORMULARËSH PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT

## Pyetësor i shkurtër për mësuesit

**GJINIA** .............................. **MOSHA** ...........

- A ka shkolla juaj politikë dhe procedura për mbrojtjen e fëmijëve? **PO** ◌ **JO** ◌
- E dini se kujt duhet t'i raportoni, nëse keni shqetësim për ndonjë fëmijë?
- Nëse Po, jepni emrin e personit: ..................
- A keni raportuar ndonjëherë ndonjë shqetësim? **PO** ◌ **JO** ◌
- A keni marrë pjesë në trajnime për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve? **PO** ◌ **JO** ◌
- Sa herë?
- Cilat ishin temat e diskutuara në seminarin trajnues?
- Çfarë do të bënit po të merrnit vesh se me një fëmijë është abuzuar? Shpjegoni hapat që do ndërmerrnit.

I gjithë informacioni do të trajtohet me konfidencialitet.

## Pyetësor i shkurtër për prindërit [5]

**GJINIA** .............................. **MOSHA** ...........

- A ka shkolla ku shkon fëmija juaj një politikë dhe procedura për mbrojtjen e fëmijëve?
- Ku do të drejtoheshit, nëse ju do të kishit shqetësime për fëmijën tuaj?
- A keni kërkuar ndonjëherë ndonjë këshillë edukative nga ndonjë profesionist në shkollën e fëmijës suaj?
- Nëse Po, sa herë? Kë keni kontaktuar?
- A jeni anëtar i komitetit të prindërve? **PO** ◌ **JO** ◌
- A keni marrë pjesë në ndonjë mbledhje me prindërit, ku janë trajtuar tema për mbrojtjen e fëmijëve?

5 Për prindërit me nivel të ulët arsimor, këto seanca pyetjesh mund të kryhen gjatë intervistave individuale.

- Nëse Po, sa: ................................
- Çfarë temash u trajtuan?
- Çfarë do të bënit nëse do të merrnit vesh se është abuzuar me ndonjë fëmijë? Shpjegoni hapat që do të ndërmerrnit.

I gjithë informacioni do të trajtohet me konfidencialitet.

### Pyetësor i shkurtër për nxënësit [6]

**GJINIA** .............................. **MOSHA** ..........

- A ka shkolla juaj ndonjë politikë ose procedurë për mbrojtjen e fëmijëve? **PO** ◌ **JO** ◌
- Ku do të drejtoheshit nëse do të kishit ndonjë shqetësim për mbarëvajtjen e shokut tuaj?
- Emri i personit: ................................
- Ku do të drejtoheshit nëse do të kishit ndonjë pyetje që ka të bëjë me ju, ndjenjat tuaja, sjelljen tuaj, mbarëvajtjen në shkollë, situatën në familje?
- Emri i personit:
- A keni kërkuar ndonjëherë ndihmë nga ndonjë mësues apo psikolog në shkollën tuaj?
- Nëse Po, pse?
- Çfarë mendoni se do të ndodhë nëse do të raportonit për një shok që nuk shkon mirë? Ju lutem, shpjegoni.

I gjithë informacioni do të trajtohet me konfidencialitet.

**6** Për nxënësit ky lloj kontrolli mund të kryhet nga një anketues i jashtëm gjatë diskutimit në grup.

# Përmbledhje e kapitujve 5, 6 dhe 7

Shkollat duhet të zbatojnë masa efikase për të parandaluar dhe për t'ju përgjigjur shqetësimeve në mbrojtje të fëmijëve, për të garantuar një mjedis miqësor në shkollë ku fëmijët të nxiten për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.

Çdo aktor në shkollë ka përgjegjësi të caktuara në rrjetin e shkollës në mbrojtje të fëmijëve. Çdo aktor në shkollë është përgjegjës për të garantuar që:

- × Po, shkolla ime ka vënë në zbatim një politikë dhe procedura në mbrojtje të fëmijëve;
- × Po, të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të personelit mësimor, kanë firmosur deklaratën në mbrojtje të fëmijëve;
- × Po, shkolla ime ka një sistem për trajtimin e çdo problemi që del në mbrojtje të fëmijëve dhe fshehtësia e dosjeve ruhet;
- × Po, shkolla ime ka të caktuar një person kontakti për shqetësimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ky person njihet nga prindërit, fëmijët dhe personeli mësimor;
- × Po, shkolla ime ndjek masat e mbrojtjes kur rekruton personel mësimor;
- × Po, shkolla ime ka nxjerrë udhëzime me shkrim lidhur me sjelljen, që janë të njohura nga prindërit, mësuesit dhe studentët;
- × Po, shkolla ime ka përgatitur informacionin se ku duhet të drejtohesh për shqetësimet që dalin për mbrojtjen e fëmijëve;
- × Po, shkolla ime i përfshin fëmijët në procesin e vendimmarrjes;
- × Po, shkolla ime ofron për prindërit, mësuesit dhe nxënësit trajnime mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- × Po, shkolla ime ka një listë me adresa specialistësh të rrethit për këshillime dhe informacion
- × Po, shkolla ime ka marrë masa për ta bërë mjedisin shkollor të dashur për fëmijët.
- × Po, shkolla ime ka një grup vëzhgimi për mbrojtjen e fëmijëve për të forcuar përkrahjen reciproke mes fëmijëve.

# Pikat e kontrollit për kapitujt 5, 6 dhe 7

Përpiquni t'ju përgjigjeni pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet tuaja janë të sakta, kthehuni të kapitujt korrespondues.

1 Kush janë aktorët kryesore në rrjetin e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve?
2 Pse duhet të zbatohen standardet e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla?
3 Cilët janë katër hapat në zbatimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve?
4 Si mund të gjykoj unë nëse siguria në shkollën time është përmirësuar?
5 Si të sigurohem që të gjithë janë në dijeni të procedurave dhe politikës?

**Anekset e Kapitujve 5, 6 dhe 7:**

| | |
|---|---|
| **ANEKSI 3** | Vetëkontrolli në shkollë |
| **ANEKSI 4** | Lista e kontrollit për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë |
| **ANEKSI 5** | Politika dhe procedurat për mbrojtjen e fëmijëve |
| **ANEKSI 6** | Formularët e raportimit mujor për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla |
| **ANEKSI 7** | Udhëzues referimi |

# 8 Sistemi i trajtimit të çdo rasti për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla

Kapitulli i tetë përqendrohet në parimet kryesore dhe mekanizmat e nevojshëm për të zbatuar një sistem për trajtimin e çdo rasti në mbrojtje të fëmijëve në shkolla.

## 8.1 Hyrje

Hapi i parë që ndërmerret në mbrojtje të fëmijëve, është të sigurohemi se të gjithë aktorët e përfshirë në punën me fëmijët, të dinë se si të veprojnë në rast se në shkollë paraqitet një rast ku fëmija ka nevojë për mbrojtje.

**Kush përfiton nga masat për mbrojtjen e fëmijëve**
Megjithëse të gjithë fëmijët janë në rrezik, problemet janë më të theksuara për fëmijët në nevojë, si:

- Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore,
- Fëmijët që mbajnë shtëpinë,
- Fëmijët që nuk marrin kujdesin e duhur, ose nuk i kanë prindërit,
- Fëmijët me prindër ose kujdestar në nevojë (për shembull, të moshuar, me aftësi të kufizuara, të varfër ose të varur nga një problem, si alkooli ose droga),

- Fëmijët që rrinë në rrugë,
- Fëmijët që punojnë,
- Fëmijët e ndarë ose të zhvendosur,
- Fëmijët pa çertifikata lindjeje apo dokumentacionin e duhur,
- Fëmijët nga grupet minoritare.

**Aktorët dhe partnerët për mbrojtjen e fëmijëve**
Në mbrojtjen e fëmijëve përfshihen edhe kujdestarët, komunitetet dhe/ose ofruesit e shërbimeve. Partnerët më të rëndësishëm janë:

- **KUJDESTARËT DHE FAMILJET:** Meqenëse prindërit dhe familjet janë shpesh pjesë e problemit dhe zgjidhjes, ata duhen konsideruar si partnerët kryesorë. Me ta mund të punohet drejtpërsëdrejti në nivelin e familjes (vizita në shtëpi, sensibilizim familjesh, këshillime, etj.) ose nëpërmjet aktiviteteve në grup, si komiteti i prindërve dhe diskutimet në grup.

- **AKTORËT NË SHKOLLA DHE NË KOMUNITET:** Ndër aktorët kyç në shkollë, përfshihen mësuesit, përgjegjësit e lëndëve, drejtorët, qeveritë e nxënësve si dhe vetë nxënësit, punonjësit socialë ose personeli shëndetësor në shkolla; ata mund të jenë burime të forta dhe/ose të shërbejnë si lehtësues në trajtimin e problemeve dhe në gjetjen e mekanizmave mbështetëse për fëmijët.

- **ORGANIZATAT VENDORE JOFITIMPRURËSE DHE/OSE ORGANIZATAT KOMUNITARE:** Këto organizata, në përgjithësi, kanë eksperiencë në disa fusha specifike dhe mund të kenë njohuri për rrjetet ekzistuese, prandaj janë shpesh partnerët e duhur dhe më të përshtatshëm.

- **INSTITUCIONET SHTETËRORE:** Në punën për mbrojtjen e fëmijëve, aktivitetet duhen kryer në partneritet me strukturat ekzistuese shtetërore (për punën sociale, shëndetësinë, arsimimin, ligjin dhe rendin (policia) etj.), por një partner tjetër i rëndësishëm është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.

- **AGJENCITË E KOMBEVE TË BASHKUARA DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE JOQEVERITARE**: Këto organizma mund të luajnë një rol të rëndësishëm, përsa i përket ofrimit të kujdesit, shpërndarjes së informacionit dhe në nxitjen e autoriteteve shtetërore.

# 8.2 Identifikimi i fëmijëve në rrezik

Identifikimi i fëmijëve në rrezik është hapi i parë për mbrojtjen e tyre. Ekzistojnë burime dhe metoda të ndryshme se si të identifikohen fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje.

## A **Mbledhja e të dhënave/shtrirja e anketimit**

Për të ndihmuar punën e tij Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, mund të mbledhë të dhëna të shumta, duke krijuar kështu një ide të përgjithshme mbi shkollën.

Ndër treguesit shqetësues për mbrojtjen e fëmijës përfshihen:

× një fëmijë që nuk e ndjek shkollën rregullisht,
× një fëmijë që nuk shkon në shkollë,
× një fëmijë që shfaq probleme të vazhdueshme shëndetësore,
× një fëmijë që nuk merr pjesë në aktivitete,
× një fëmijë që ka dëmtime të pashpjegueshme dhe të dyshimta fizike,
× një fëmijë që është agresiv, shumë i ndjeshëm, pasiv, i ngjitur apo që shfaq sjellje seksuale jonormale për moshën e tij/saj apo kontekstin social.

Për të mbledhur të dhënat, mund t'u shpërndahen pyetësorë personelit mësimor, prindërve dhe nxënësve. Kjo shtrirje e anketimit, mundëson formimin e një ideje të përgjithshme të situatës në shkolla dhe ndihmon në vlerësimin e përhapjes së problemeve specifike që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (shiko përkufizimet më poshtë). Në të njëjtin kanal komunikimi (shih faqen 49 mbi pyetësorët tip) çdo aktori në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve të shkollës, i kujtohet detyra që ka si qytetar dhe kujdestar për të raportuar rastet problematikë të mbrojtjes së fëmijëve (rritje ndërgjegjësimi). Për më tepër, në të gjithë mjedisin e shkollës, duhet të njihet personi të cilit mund t'i drejtohesh (specialisti ose punonjësi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve).

**PËRHAPJA:** Numri i individëve në një popullsi të prekur nga fenomeni. Përhapja është një koncept statistikor, që i referohet numrit të rasteve që janë të pranishme në një popullsi të caktuar në një kohë të caktuar.

**INCIDENCA:** Frekuenca me të cilën diçka, një sëmundje apo çrregullim, shfaqet në një popullsi apo zonë të caktuar. Në epidemiologji, incidenca është numri i rasteve të reja të diagnostikuara gjatë një

periudhe të caktuar kohore. Incidenca është e ndryshme nga përhapja, e cila i referohet numrit të rasteve ekzistuese në një datë të caktuar.

B **Bashkëpunimi në komunitet:**

Përfshirja në shkallë të gjerë e komunitetit, është vendimtare për identifikimin e fëmijëve të prekshëm. Komunitetet duhet të sensibilizohen mbi rreziqet dhe problemet e tjera që ndeshin fëmijët. Çdo qytetar duhet të jetë i ndërgjegjshëm mbi faktin se ai/ajo është përgjegjës për të sinjalizuar çdo problem, që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve.

Është pjesë e mandatit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, të identifikojë njerëz të veçantë (persona kontakti) në komunitete dhe këta persona të fuqizohen dhe trajnohen për zbulimin e rasteve.

Te këta persona mund të përfshihen: punonjësit e shëndetësisë, personel nga organizatat jofitimprurëse, drejtues fetarë dhe komunitetesh, anëtarë të grupeve të vëzhgimit të komuniteteve, anëtarë të grupeve të grave ose të komitetit të prindërve.

SMF-ja është personi kryesor i kontaktit në sistemin shkollor. Ky person mund të shërbejë, gjithashtu, si një burim për të trajnuar aktorët e tjerë të komunitetit, të cilët bëjnë pjesë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve si mësuesit, drejtorët dhe prindërit, apo dhe personat e kontaktit jashtë mjedisit të shkollës.

C **Shpërndarja e informacionit**

Çdo SMF është përgjegjës për raportimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe problemeve me supervizorin e tyre të drejtpërdrejtë (Koordinatorin e psikologëve shkollorë), punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, agjencitë e OKB-së dhe organizmave të tjerë koordinues. Nxjerrja në pah e rreziqeve dhe nevojave, lehtëson avokatinë për shërbime më të mira.

# 8.3 Menaxhimi i rastit dhe sistemi i referimit

Ana operacionale e vendimtare e sistemit të menaxhimit të rasteve, e theksuar më poshtë, ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësive midis SMF-ve, anëtarëve të tjerë të personelit mësimor në shkollë, punonjësve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe partnerëve të tjerë lokalë, përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. Por ajo synon të krijojë edhe një kulturë për "vlerësimin e rrezikut" brenda funksionit të SMF-së dhe të nxisë të gjithë personelin arsimor që t'i konsiderojë si "pjesë e punës së vet" rastet e mbrojtjes së fëmijëve. Një tjetër aspekt kyç i sistemit të menaxhimit të rasteve, është kategorizimi i këtyre të fundit dhe përcaktimi i përgjegjësive në përputhje me nivelet e ndryshme të rrezikut dhe të problemeve.

## A Kategoritë e problemeve për mbrojtjen e fëmijëve, përfshi nënkategoritë:

**Lloji i problemit të mbrojtjes:**

**a ABUZIMI/DHUNA**

1 Fizik
2 Seksual
3 Psikologjik/Emocional
4 Neglizhim

**b SOCIAL**

1 Puna
2 Shkollimi
3 Profesioni
4 Trafikimi
5 Mosshoqërimi
6 Zhvendosja
7 Abuzimi me alkoolin/substanca
8 Ndarja/konflikti në familje
9 Dhuna në familje
10 Varfëria

11 Papunësia
12 Mungesa e strehimit
13 Gjakmarrja
14 Diskriminimi (kultura, gjinia)

c **SHËNDETËSORE**
1 Mjekësore
2 Mendore
3 Aftësitë e kufizuara

d **PSIKOLOGJIKE**
1 Probleme me sjelljen
2 Probleme emocionale
3 Trauma

e **TË TJERA**
1 Probleme me zhvillimin
2 Konflikt nxënës-mësues
3 Dhuna mes shokëve
4 Mbarëvajtja në shkollë

## B Vlerësimi i rrezikut në mbrojtjen e fëmijëve

Vlerësimi i rrezikut është një strategji thelbësore për ndërhyrjen në mbrojtjen e fëmijëve. Më shpesh, vlerësimi i rrezikut është mendimi i një individi bazuar në eksperiencën dhe gjykimin e tij/saj. Vendimet, të bazuar vetëm në interpretime subjektive, kanë rezultuar të gabuara dhe shpesh i kanë vënë fëmijët në një rrezik më të madh. Shkollat duhet të zhvillojnë një sistem, që pakëson vendimet e "varfra", të bazuar në gjykimin e individëve dhe të krijojnë një model që përkrah verifikimin e informacionit nga disa burime dhe përgjegjshmërinë e vendimit.

Sapo SMF-ja të ketë marrë një sinjalizim e të ketë hapur dosje për fëmijën, duhet kryer menjëherë vlerësimi i rrezikut. Rreziqet e mëposhtme kanë të bashkangjitur një përshkrim të shkurtër se çfarë do të thotë rrezik i lartë, i mesëm, i ulët dhe asnjë lloj rreziku, së bashku me veprimet e kërkuara, afatin kohor mbi raportimin si dhe qartësimin e përgjegjësive midis aktorëve të ndryshëm të mbrojtjes së fëmijëve.

# I lartë – 1

- **RREZIK I LARTË:** Një fëmijë ka gjasa të jetë i dëmtuar apo lënduar seriozisht, i nënshtruar ndaj abuzimit seksual të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm. Si rezultat, mund të mbetet me aftësi të kufizuara, të trafikohet apo edhe të vdesë, nëse lihet në rrethanat aktuale dhe nuk i jepet ndërhyrja mbrojtëse.

Nëse rreziku klasifikohet I LARTË duhet ndërmarrë një plan i **menjëher-shëm veprimi** dhe të zbatohet nga punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Brenda **24 orëve** nga identifikimi i një fëmije në “rrezik të lartë”, rasti duhet çuar te Koordinatori i psikologëve, i cili do të raportojë menjëherë rastin te punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Sa më shpejt të bëhet procesi i parashikuar, aq më mirë është.

Do të kryhen vlerësime ditore/javore nga punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, derisa të stabilizohet rasti.

**Kujdes!** Rastet e rrezikut të lartë, raportohen gjithmonë direkt te Koordinatori i psikologëve pranë Drejtorisë Rajonale Arsimore, i cili ia referon rastet NMF-së. Këto raste NUK janë në mandatin e SMF-së, por duhet t‘i referohen strukturës së NMF-së të bashkëshoqëruara me informacionin përkatës për fëmijën.

# I mesëm – 2

- **RREZIK I MESËM:** Një fëmijë ka gjasa të vuajë një lloj dëmtimi, nëse lihet në shtëpi pa një plan të saktë ndërhyrjeje. Ndërhyrja është e justifikuar. Megjithatë, nuk ka prova që fëmija të jetë në rrezik dëmtimi serioz apo rrezik vdekjeje.

Brenda **5 ditëve** nga identifikimi i një fëmije në ‘rrezik të mesëm’, duhet të kryhet vlerësimi i detajuar/analizë e situatës nga SMF-ja, si dhe t‘i bash-këngjitet një plan i rastit dhe të kryhet vlerësimi i vazhdueshëm i rrezikut. Rasti i duhet çuar Koordinatorit të psikologëve shkollorë në Drejtorinë Rajonale Arsimore dhe, nëse është e nevojshme, t‘i raportohet e refero-het punonjësit të NMF-së. Sa më shpejt të kryhet procesi, aq më mirë është.

## I ulët – 3

- **RREZIK I ULËT:** Shtëpia është një vend i sigurt për fëmijën. Megjithatë, ka shqetësime rreth mundësisë që fëmija të jetë në rrezik, nëse nuk i ofrohen shërbimet e duhura për të parandaluar nevojën për ndërhyrje mbrojtëse.

Brenda **14 ditëve** nga identifikimi i një fëmije në 'rrezik të ulët' SMF-ja duhet të kryejë një vlerësim të detajuar/analizë të situatës, të caktojë një ditë të saktë për të ndjekur planin e veprimit të miratuar nga Koordinatori i psikologëve shkollorë. Sa më shpejt të kryhet procesi, aq më mirë është.

## Pa rrezik – 4

- **ASNJË VEPRIM:** Shtëpia është një vend i sigurt për fëmijën dhe nuk ka shenja që tregojnë për ndonjë rrezik të mundshëm ndaj tij.

Rastet shfaqen rastësisht dhe nuk duhen dekurajuar; sapo të raportohet një rast, SMF-ja duhet të kryejë vlerësimin e rrezikut dhe mund të arrijë në përfundimin se nuk është i nevojshëm asnjë lloj vepimi. **Asnjë veprim është një vendim që merret pas vlerësimit të rrezikut.** Minimalisht kërkohet që të plotësohet një raport dhe të bëhet dy herë vlerësimi i rrezikut.

Brenda **14 ditësh** nga identifikimi i një rasti që nuk kërkon "asnjë veprim", SMF-ja duhet të kryejë një vlerësim të detajuar/analizë të situatës dhe i psikologëve shkollorë është personi që duhet të autorizojë mosndërrmarrjen e asnjë veprimi.

Nëse rastet i referohen Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, OJF-ve ose shërbimeve të tjera shtetërore, referimi duhet të jetë i detajuar dhe duhet të përdoren dokumentet e përshtatshme të raportimit. Duhet të plotësohet një raport për të gjitha rastet, për të nxjerrë përgjegjësitë dhe në rastet e raporteve të ardhshme ose rikategorizimit (për më shumë informacion, shih Manualin e Mbrojtjes së Fëmijëve mbi menaxhimin e rasteve të izoluara).

Nëpërmjet përdorimit të kategorive 'A – E' dhe numrave '1 – 4' për nivelet e rrezikut, klasifikohen rastet individuale. Një shembull do të ishte rasti i përdhunimit të një fëmije që do klasifikohej si **A1.**

Një fëmijë që përjeton dhunë në shtëpi, do të klasifikohej te zëri dhuna në familje, Bix, në varësi të rrethanave do të klasifikohej si Bix1 ose Bix2.

Nëse kemi grumbullimin e një sërë problemesh si neglizhimi (Aiv), mospjesëmarrja në shkollë (Bii) dhe mungesa e një strehe (Bxii) në të njëjtën kohë, atëherë **merr përparësi klasifikimi më i lartë**, që në planifikimin e rastit duhet të jetë problemi prioritar për t'u trajtuar. Nëse problemi prioritar zgjidhet në mënyrë të kënaqshme, atëherë rasti mund të riklasifikohet, po kështu dhe përgjegjësia për menaxhimin e rastit prioritar. Sigurisht që është e mundur të punohet në të njëjtën kohë për çështje të ndryshme, pasi shpesh ato mpleksen me njëra-tjetrën dhe akse të ndryshme të planit të veprimit janë dinamikë dhe ndërveprues.

**Personi që ka përgjegjësinë për menaxhimin e rasteve, përcaktohet si më poshtë:**

| SPECIALISTI PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE | NMF |
|---|---|
| A3–4, B3–4, C2–4, D2–4, E2–4 | A1–2, B1–2, C1, D1, E1 |

## C Referimi

Duhet të krijohet një sistem referimi para se të ndodhin incidentet. Sigurohuni që shkolla juaj të ketë një listë me referimet e partnerëve të mbrojtjes së fëmijëve (**shiko udhëzuesin referues në Aneksin 7).**

Rastet e referuara të Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, nuk koordinohen më nga SMF-ja e shkollës. Por, nëse plani i veprimit i bërë nga punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, parashikon riintegrimin apo ndërhyrje të tjera në shkollë, atëherë SMF-ja i shkollës është personi i kontaktit për punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në mjedisin e shkollës dhe duhet t'i ndjekë nga afër këto raste dhe të marrë pjesë në takimet e menaxhimit të rastit të koordinuara edhe nga punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

**Diagrama e raportimit**
Diagrama e mëposhtme është krijuar për të bërë në mënyrë vizuale përshkrimin e raportimit nëpërmjet sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve, si dhe të ndihmojë atë që ka përgjegjësinë “**parësore**” për menaxhimin e rastit.

Disa nga çështjet kryesorë, janë:

- Identifikimi i rastit mund të raportohet nga çdo aktor i rrjetit të mbrojtjes në shkollë (si, për shembull, nxënës, mësues, prindër, drejtor shkolle, anëtar i komitetit të prindërve, ose çdo person tjetër, profesionist ose joprofesionist, i cili vihet në kontakt direkt ose indirekt me fëmijën).
- Të gjithë formularët e raportimit të rasteve i dorëzohen SMF-së përgjegjës në shkollë.
- Caktohet një ekspert i jashtëm për mbrojtjen e fëmijëve, i cili kryen vlerësimin e sistemit të menaxhimit të rastit, për të siguruar cilësinë e mbrojtjes së fëmijëve në shkollë.
- Statistikat raportohen nga Koordinatori i psikologëve në Drejtorinë Arsimore Rajonale, çdo tre muaj për të monitoruar shkallën e përhapjes dhe incidencës së përgjithshme të problemeve të fëmijëve në rajon.

## 8.4 Përgjegjësitë në menaxhimin e rastit

### A Përgjegjësia e menaxhimit të rasteve parësore

Ekzistojnë dy nivele përgjegjësish për menaxhimin e rasteve, respektivisht: “kryesor” dhe “mbikëqyrës”. Ky sistem mbikëqyrjeje lejon nxjerrjen e përgjegjësive dhe monitorimin e vendimeve nëpërmjet sistemit.

Përgjegjësia kryesore në menaxhimin e rasteve, bie mbi SMF-në. SMF-ja është përgjegjëse për kontaktin dhe koordinimin e agjencive referuese, fëmijën, familjen, personelin mësimor dhe anëtarët e komunitetit si dhe për të kryer veprimet që duhen bërë, pasi është miratuar një plan për menaxhimin e rasteve.

Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve është përgjegjës për monitorimin e ecurisë së çështjes kryesore të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të njoftojë për zhvillimet në takimet e menaxhimit të rastit me aktorë të ndryshëm, të përfshirë në aksionin në mbrojtje të fëmijëve.

SMF-ja menaxhon rastet e thjeshta, si ato që kanë lidhje me arsimimin, problemet e zhvillimit, raportimet për probleme të thjeshta shëndetësore etj., dhe krijon kontakte të rregullta me familjen, personelin mësimor dhe anëtarët e tjerë të komunitetit duke:

- punuar nga niveli fillestar në bashkëpunim të ngushtë me fëmijët, familjet, personelin mësimor dhe anëtarët e tjerë të komunitetit;
- mbledhur informacionin bazë, vlerësimin dhe vizitat në familje;
- referuar rastet më të rënda të NMF-së me miratimin e Koordinatorit të psikologëve shkollorë në Drejtorinë Arsimore Rajonale;
- identifikuar burimet lokale dhe partnerët në shkollë e nivel komuniteti;
- menaxhuar rastet e thjeshta sipas një plani veprimi të përcaktuar qartë dhe monitoruar ecurinë e ndikimit të ndërhyrjeve (për informacion të detajuar, shiko Udhëzuesin Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve);
- raportuar incidentet në shkollë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve në formën e raportimit mujor për shkollat ➥ **ANEKSIN 6**;
- organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në shkollë.

## B Përgjegjësia e mbikëqyrjes së menaxhimit të rastit

Përgjegjësia e mbikëqyrjes së menaxhimit të rasteve, bie mbi Koordinatorin e psikologëve e psikologëve në Drejtorinë Arsimore Rajonale apo një supervizori tjetër të caktuar, i cili ndihmon SMF-në sa herë është e nevojshme, miraton dhe analizon vendimet e marra, kryen monitorimin në terren dhe takimet për menaxhimin e rastit si dhe miraton raportimet për Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve apo partnerët e tjerë.

Koordinatorët e psikologëve të shkollave (ose ndonjë supervizor tjetër), janë anëtarë të specializuar të personelit, që mbështesin në mënyrë sistematike SMF-në në trajtimin e çështjeve delikate, që kërkojnë monitorim rigoroz, dhe për rastet urgjente, që kërkojnë shprehi të veçanta, konfidencialitet dhe veprim të menjëhershëm, si për shembull referimi te NMF-ja. Në detyrat e tyre, përfshihen:

- menaxhimi i rasteve më delikate,
- monitorimi i të gjitha rasteve (përfshirë dhe ato të menaxhuara vetëm nga SMF-ja),
- identifikimi i burimeve dhe partnerëve në një nivel më të lartë (qytet, rreth, nivel kombëtar),
- raportimi i rasteve te NMF-ja,
- menaxhimi i mbledhjes së të dhënave ➥ **ANEKSIN 6**, për qëllim monitorimi dhe atë statistikor,
- përgjegjësia për trajnimet mbi mbrojtjen e fëmijëve qysh nga niveli bazë,
- mbikëqyrja e aktiviteteve sensibilizuese të kryera nga SMF-ja.

Mbrojtja e fëmijëve në sistemin e menaxhimit të shkollës, përfshin monitorimin e vendimeve, rrezikut dhe kategorive, fillimisht nëpërmjet funksionit të marrjes së përgjegjësisë së menaxhimit të rastit dhe zbatimit të programit të takimeve dyjavore për mbikëqyrjen e menaxhimit të rasteve, prej menaxherit të rastit dhe menaxherit mbikëqyrës së rastit.

## 8.5 Takimet për menaxhimin e rasteve

Takimet për menaxhimin e rastit duhet bërë për të gjitha rastet.

### A Takimet e supervizimit të menaxhimit të rastit

Takimet dyjavore të supervizimit të menaxhimit të rastit, duhen zhvilluar rregullisht. Eshtë e rekomandueshme që të ketë takime të veçanta për kategoritë, duke marrë parasysh kush ka përgjegjësinë dhe si duhet të ndërmerren veprimet e menjëhershme. Koordinatori i psikologëve shkollorë, kryeson takimin dhe dërgon kalendarin e këtyre takimeve SMF-së.

- **ZBATOHET PËR KATEGORITË:** A 3-4, B3-4, C2-4, D2-4, E2-4
- **SPECIALISTI PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE:**
  Menaxherët kryesorë të rastit.
- **KOORDINATORI I PSIKOLOGËVE NË DREJTORINË ARSIMORE RAJONALE:**
  Menaxheri supervizor i rastit.
- **PJESËMARRËSIT NË TAKIMET E MENAXHIMIT TË SUPERVIZIMIT TË RASTIT:**
  SMF-ja dhe supervizori.

SMF-ja dorëzon një listë me rastet për ta diskutuar me supervizorin, para se të mbahet takimi për mbikqyrjen e menaxhimit të rastit. SMF-ja duhet t'i dijë mirë rastet dhe të prezantojë të rejat më të fundit në takim. SMF-ja monitoron ecurinë e rastit dhe dokumenton të gjitha veprimet dhe vendimet e marra në njësinë përkatëse ku ndodhet dosja e fëmijës.
(**Instrumenti 1 në Udhëzuesin Praktik të Mbrojtjes së Fëmijëve)**.

**Udhëzime mbi takimin për mbikëqyrjen e menaxhimit të rastit:**

- të mbahen takime të rregullta të paktën çdo dy javë,
- të dokumentohen të gjitha takimet,
- të rishikohen në çdo takim të gjitha rastet me prioritet të lartë,
- të rishqyrtohen të gjitha rastet që janë për t'u mbyllur,
- të rishikohen të paktën çdo tri javë të gjitha rastet e rrezikut të mesëm dhe të ulët, ku s'kërkohet ndonjë veprim.

### B Takimet e koordinimit

Këto takime duhet të kryhen në grupe të vogla me personelin që ka lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe aktorët kryesorë për zbatimin plani të veprimit, nën përgjegjësinë e menaxherit kryesor të rastit. Këto takime organizohen kurdo që menaxheri i rastit prioritar e sheh të nevojshme të diskutohen hapat e mëtejshme dhe për të garantuar një reagim të integruar dhe koordinuar për mbrojtjen e fëmijëve, sipas planit të miratuar të veprimit.

**C** **Këshillimi me kolegë**

Në çdo ekip ka njerëz me përvoja të ndryshme, që mund të ndihmojnë njëri-tjetrin në menaxhimin e rasteve të vështira. Këshillimi me kolegë, bën të mundur analizimin e rasteve të vështira pa mbështetje (supervizim) të jashtëm. Një ndikim dytësor ka edhe ngaqë ekipi punon së bashku për çështjet psikosociale, përforcohet shpirti i skuadrës dhe njihen më mirë burimet dhe aftësitë profesionale e personale të njëri-tjetrit. Të shkëmbesh mendime me dikë tjetër kur përballesh me një rast me vështirësi dhe të mungon siguria, ndihma është gjithmonë e vlefshme! Në **ANEKSIN 8** mund të gjeni një shembull të këshillimit me kolegë.

## 8.6 Monitorimi i rastit për qëllime statistikore

**Pse duhet t'i dorëzojmë çdo muaj shkollës formularë raportimi për mbrojtjen e fëmijëve?** Formulari i monitorimit të menaxhimit të rastit, shërben si një mjet për të mbledhur informacion dhe statistika për problemet e mbrojtjes së fëmijëve në shkollë, si dhe në nivel rajonal dhe kombëtar. Ndërsa SMF-ja i dorëzon raportet mujore për shkollat për të cilat ai/ajo përgjigjet **(ANEKSI 6)**, supervizori mbledh të dhënat në sistemin elektronik ekzistues dhe ia dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për statistikat kombëtare.

## 8.7 Vlerësimi

Siç u përmend edhe më sipër, vlerësimi i cilësisë dhe përcaktimi i përgjegjësisë, duhet të jetë i jashtëm. Për këtë caktohet një ekspert, i cili do të kryejë vlerësime të rregullta për të garantuar që vendimet, proceset dhe funksionet, kryhen me korrektësi dhe të përqendruar në 'interesin më të mirë të fëmijës'.

# Përmbledhje

Me anë të fushatave të sensibilizimit dhe mjeteve të përshtatura të komunikimit për çdo popullatë, të gjithë aktorët e shkollës duhet të ndërgjegjësohen mbi përgjegjësinë e tyre për të sinjalizuar problemet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve. Një sistem për menaxhimin e rastit, ofron strukturën për përgjigje të përshtatshme dhe të vlefshme për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje.

Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve marrin rolin e menaxherëve të rasteve prioritare për të gjitha kategoritë që i përfshin mandati i tyre dhe që mbështeten nga supervizori i tyre i menaxhimit të rasteve. Zhvillimi dhe zbatimi i një procesi formal analize, për t'u garantuar për përgjegjshmërinë e personelit, menaxhimin dhe ndjekjen siç duhet të rasteve, është pjesë përbërëse për sigurimin e cilësisë në sistemin e menaxhimit të rastit. Ky proces i garantimit të cilësisë, është i nevojshëm për të pasur një strukturë të qartë për detyrimet dhe përgjegjësitë, dhe duhet të rifreskohet dhe të ndiqet nga afër. Për më tepër, përmes stabilizimit dhe ruajtjes së sistemit të informacionit dhe menaxhimit të rrezikut të bazuar në vendime të përgjegjshme, është më e lehtë dhe më e mundshme të arrihen objektivat.

- SMF-ja, që fillon studimin e një rasti, dhe mbikëqyrësi i saj (siç është Koordinatori i psikologëve në Drejtorinë Arsimore Rajonale), përcaktojnë së bashku kategorinë dhe nivelin e rrezikut. Kjo bëhet për të inkurajuar një kulturë vlerësimi të rrezikut nga SMF-ja, por edhe për të shmangur marrjen e vendimeve nga një njeri i vetëm.
- SMF-ja përgjigjet për raportimet riklasifikuese dhe ndjekjen e zhvillimeve të një rasti, për çka ai/ajo është i ngarkuar si menaxheri kryesor i rastit dhe për të mbajtur shënim rezultatet që dalin nga diskutimi i tij në mbledhjen e menaxhimit të rastit.
- Ka shumë rëndësi që gjithmonë përgjegjës për koordinimin e planit të veprimit për mbrojtjen e fëmijës, të jetë vetëm një person. Ky menaxher kryesor i rastit, koordinon zbatimin e planit të veprimit me partnerët dhe është i ngarkuar për monitorimin, vlerësimin dhe propozimin për mbylljen e çështjes.

Çdo Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve dorëzon një formular raportimi mujor për mbledhjen e të dhënave mbi problemet e mbrojtjes së fëmijëve për qëllime statistikore.

# Pika kontrolli

1 Ju lutemi, shpjegoni se ç'do të thotë kulturë e vlerësimit të rrezikut? Si lidhen vendimet e vlerësimit të rrezikut me sistemin raportues, i cili duhet ndërtuar përpara se të ndodhë incidenti?
2 Ju lutemi, shpjegoni përgjegjësitë e ndryshme të menaxherit kryesor dhe supervizorit të rastit?
3 Mbi kë bie përgjegjësia për identifikimin e fëmijëve në nevojë?
4 Përkufizo përhapjen dhe incidencën e problemeve të mbrojtjes së fëmijëve. Si lidhen ato me raportin e monitorimit të rastit për qëllime statistikore?
5 Cili është qëllimi i takimeve koordinuese të rastit dhe kush merr pjesë në to?

**Anekset e kapitullit 8:**

**ANEKSI 6** Forma e raportimit mujor të mbrojtjes së fëmijëve për shkollat
**ANEKSI 7** Udhëzues referimi
**ANEKSI 8** Modeli i këshillimit mes kolegësh

# 9 Detyrat dhe kompetencat e Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve (SMF)

Kapitulli i nëntë bën një përshkrim të përgjithshëm për kompetencat profesionale dhe personale, si dhe shprehitë që duhet të zotërojë një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve.

## 9.1 Kush janë Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve?

Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses në fushën **e arsimit**, **ato sociale** dhe **emocionale**. Ata bashkëpunojnë me mësuesit, prindërit dhe profesionistë të tjerë, për të krijuar një mjedis të sigurt, të shëndetshëm dhe nxitës gjatë procesit të të mësuarit, për të gjithë nxënësit, që të forcohen lidhjet midis shkollës dhe familjes. Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jenë shumë të trajnuar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë. Ata duhet të kenë përfunduar minimalisht një program të gradës Master në fushat psiko-sociale dhe duhet të kenë njohuri bazë për shëndetin mendor, zhvillimin e fëmijës, organizimin e shkollës, mënyrat dhe proceset e të mësuarit,

sjelljen, motivimin dhe mësimdhënien efikase. Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jenë të çertifikuar ose të licensuar me çertifikatë për mbrojtjen e fëmijëve.

## 9.2 Çfarë bëjnë Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve?

Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve punon për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme për çdo nxënës dhe situatë. Ata përdorin strategji të ndryshme për të plotësuar nevojat e nxënësve dhe për të përmirësuar sistemin e përkrahjes në shkolla dhe nëpër rrethe. SMF-të punojnë me nxënësit në mënyrë individuale dhe në grupe. Ata zhvillojnë programe për të trajnuar mësuesit dhe prindërit për strategjitë efikase të mësimdhënies dhe të mësuarit, teknikat për të menaxhuar sjelljen në familje dhe në klasë, punën me nxënësit me aftësi të kufizuara apo me talente të veçanta, merren me abuzimet me drogën dhe substanca të tjera si dhe parandalimin dhe menaxhimin e krizave.

**Veç këtyre, SMF-të ofrojnë shërbimet e mëposhtme:**

**KËSHILLIM**

- Bashkëpunojnë me mësuesit, prindërit dhe administratorët për të gjetur zgjidhje të vlefshme për problemet e procesit të të mësuarit dhe të sjelljes.
- Ndihmojnë të tjerët të kuptojnë zhvillimin e fëmijës dhe se si ai ndikon në procesin e të mësuarit dhe sjelljen.
- Përforcojnë marrëdhëniet e punës midis mësuesve, prindërve dhe ofruesve të shërbimit në komunitet.
- Shërbejnë si këshillues për prindërit dhe personelin pedagogjik.

**VLERËSIM**

- Vlerësojnë përshtatshmërinë e shërbimeve speciale.
- Vlerësojnë aftësitë shkollore dhe dhuntitë e të mësuarit.
- Përcaktojnë zhvillimin socio-emocional dhe statusin e gjendjes mendore.
- Vlerësojnë mjediset mësimore.
- Bëjnë vlerësimin e rrezikut për fëmijët në nevojë.

**NDËRHYRJE**

- Ofrojnë këshillime psiko-sociale për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve ndërpersonale ose në gjirin e familjes, që ndikojnë në ecurinë e mësimeve.
- Punojnë drejtpërdrejt me fëmijët dhe familjet e tyre për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të përshtatjes dhe të procesit të mësimit.
- Ofrojnë trajnim për shprehitë sociale dhe menaxhimin e zemërimit.
- Ndihmojnë familjet dhe shkollat të menaxhojnë krizat, si vdekja, sëmundjet ose traumat në komunitet.
- Mbështesin riintegrimin e fëmijëve në nevojë (të ekspozuar ndaj rreziqeve) në mjedisin shkollor.

**PARANDALIMI**

- Krijojnë programe për fëmijët që rrezikojnë të mbesin në shkollë.
- Nxitin tolerancën, mirëkuptimin dhe të çmuarit e diveristetit në komunitetin e shkollës.
- Zhvillojnë programe për ta bërë shkollën një mjedis më të sigurt dhe të mësuarit sa më të vlefshëm.
- Bashkëpunojnë me personelin mësimor dhe agjencitë komunitare për të ofruar shërbime për të përmirësuar shëndetin fizik dhe psikologjik.
- Formojnë partneritet me prindërit dhe mësuesit për të krijuar mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt në shkollë.

**STUDIM KËRKIMOR DHE PLANIFIKIM**

- Vlerësojnë vlefshmërinë e programeve shkollore dhe të menaxhimit të sjelljes.
- Identifikojnë dhe zbatojnë programe dhe strategji për të përmirësuar sigurinë në shkollë.
- Përdorin studime të bazuar në fakte për të zhvilluar dhe/ose rekomanduar ndërhyrje të vlefshme.
- Zbatojnë programe dhe strategji për sensibilizimin e problemeve të fëmijëve.

**RRITJA E FËMIJËS NUK ËSHTË E LEHTË:** Të gjithë fëmijët dhe adoleshentët përballen herë pas here me probleme. Ata:

- mund të kenë frikë,
- mund të kenë vështirësi të organizojnë kohën e tyre në mënyrë të dobishme,
- nuk kanë shprehitë e duhura të studimit,
- mund të ngelin pas në shkollë,
- mund të mos kenë disiplinë,
- mund të shqetësohen për çështjet familjare si divorci dhe vdekja,
- mund të ndjehen të stresuar dhe në ankth,
- mund të eksperimentojnë me drogën dhe alkoolin,
- mund të mendojnë vetëvrasjen,
- mund të shqetësohen për seksualitetin e tyre,
- mund të përballen me situata të vështira, kërkimi për punë ose braktisja e shkollës,
- mund të vënë në pikëpyetje dhuntitë dhe aftësitë e tyre.

Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve/psikologët e shkollave ndihmojnë fëmijët, prindërit, mësuesit dhe anëtarët e komunitetit të kuptojnë dhe zgjidhin këto probleme. Situata e mëposhtme tregon se si mund t'i zgjidhë problemet në mënyrë tipike SMF-ja.

## 9.3 Kompetencat dhe shprehitë profesionale të SMF-së/psikologut të shkollës

1. SMF-të i njohin pikat e forta dhe kufizimet e trajnimit dhe eksperiencës së tyre dhe bëjnë vetëm ato punë për të cilat janë kualifikuar. Ata kërkojnë ndihmën e specialistëve të tjerë në rolin e mbikëqyrjes, konsulencës dhe raportimit, si më të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit. Ata duhet të marrin trajnime dhe kualifikime shtesë në mënyrë të vazhdueshme, për t'i ofruar shërbimet më të mira të mundshme fëmijëve, familjeve, shkollave, komuniteteve, personave të trajnuar dhe të mbikëqyrurve.

2 Nivelet e kompetencës, arsimimit, trajnimit dhe eksperiencës, u janë paraqitur me kujdes klientëve në mënyrë profesionale.
3 SMF-ja përfshihet në aktivitete për zhvillimin e tij të mëtejshëm profesional. Ai është në dijeni të të dhënave të fundit për kërkimet, trajnimet dhe praktikat profesionale, prej të cilave përfitojnë fëmijët, familjet dhe shkollat.
4 SMF-ja shmang çdo aktivitet ku problemet e tyre personale ose konfliktet mund të ndërhyjnë në vlefshmërinë e tyre profesionale. Ai kërkon ndihmë nga njerëz kompetentë për të lehtësuar konfliktet në marrëdhëniet profesionale.
5 Psikologët e shkollave i njohin Parimet e Etikës Profesionale dhe i përshtasin me kujdes në situatat e punësimit dhe praktikave të tyre.
6 SMF-të janë në dijeni të mekanizmave për përballimin e stresit dhe dinë se kur t'ia referojnë rastin një kolegu ose kur të kërkojnë ndihmë.
7 SMF-të zotërojnë teknikat e komunikimit, të menaxhimit të konflikteve, të ndëhyrjes si dhe shprehitë e drejtimit dhe vetësigurisë për të arritur profesionalisht objektivat.

**Probleme në familje**
Mësuesja vuri re se Anila, një nxënëse e zonja, nuk merrte më pjesë në diskutimet në klasë dhe kishte probleme me përqendrimin. Psikologut të shkollës iu kërkua të vlerësonte pse kishte ndryshuar kaq shumë sjellja e Anilës. Pasi zbuloi se prindërit e Anilës po ndaheshin, psikologu i ofroi këshillim Anilës dhe u bëri sugjerime prindërve të saj për këtë kohë të vështirë. Sjellja dhe vetëvlerësimi i Anilës u përmirësuan dhe ajo filloi të ndjehej më e sigurt në marrëdhëniet e saj me prindërit.

**SMF/Psikologu shkollor janë persona të cilëve mund t'u besohet ofrimi i ndihmës në rastet e situatave delikate personale e familjare që ndikojnë në mbarëvajtjen në shkollë.**

**Problemet me leximin**
Prindërit e Dritanit ishin të shqetësuar për vështirësitë e tij me leximin. Ata kishin frikë se ai do të ngelej prapa dhe do të humbiste besimin në vetvete. Në shkollë mësuesit vunë re se Dritani kuptonte çfarë prezantohej me gojë, por ai kishte nevojë për ndihmën e shokëve të klasës për të bërë detyrat me shkrim. Pasi vëzhgoi Dritanin dhe mblodhi informacion për aftësitë e tij në shkrim e lexim, psikologu i shkollës bashkëpunoi me prindërit e tij dhe mësuesit për të zhvilluar një plan për përmirësimin e shkrimit dhe leximit të tij. Plani funksionoi dhe leximi e vetëbesimi i Dritanit, u përmirësuan.

**SMF-ja/psikologu i shkollës mund të ndihmojnë për të parandaluar problemet në të ardhmen kur ata ndërhyjnë qysh në fillim në problemet e procesit të të mësuarit.**

**Një nxënës që mund të braktisë shkollën**
Iliri ishte një nxënës në shkollë të mesme që i linte shumë shpesh orët e mësimit. Nuk kishte një sjellje të mirë dhe disa herë ishte pezulluar nga shkolla për grindje. Pasi krijoi marrëdhënie me Ilirin, psikologu i shkollës i mësoi atij disa teknika të thjeshta për t'u qetësuar dhe për të kontrolluar zemërimin e tij. Mamaja e Ilirit dhe mësuesja e tij, punuan së bashku mbi një plan të hartuar nga psikologu i shkollës, për të përcaktuar kufijtë dhe përmirësuar komunikimin e tij.

**SMF-ja/psikologu i shkollës e dinë se ndryshimet në mjedisin shkollor dhe në shtëpi, mund të përmirësojnë cilësinë e jetës për fëmijën dhe familjen e tij.**

# 10 Marrëdhëniet profesionale të të Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijës

Në kapitullin e dhjetë bëhet një përmbledhje e shkurtër, lidhur me marrëdhëniet e ndryshme profesionale ku përfshihet SMF-ja brenda detyrave dhe mandatit të tij.

## 10.1 Të përgjithshme

1. SMF-të janë të angazhuar të përdorin ekspertizën e tyre për të inkurajuar përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve, familjeve të tyre dhe komunitetit në shkollë. Ky objektiv i tyre ndiqet në mënyrë të tillë, që mbron dinjitetin dhe të drejtat e personave të përfshirë. Psikologët e shkollave pranojnë përgjegjësinë për përshtatshmërinë e praktikave të tyre profesionale.
2. SMF-të respektojnë të gjithë personat dhe tregohen të kujdesshëm me gjendjen mendore, emocionale, fizike, politike, ekonomike, sociale, kulturore, etnike dhe ndaj karakteristikave raciale, gjinore, drejtimet seksuale dhe besimeve fetare.
3. SMF-të në çdo situatë mbajnë marrëdhënie profesionale me fëmijët, prindërit dhe komunitetin e shkollës. Kështu që, prindërit dhe fëmijët

duhet të jenë të informuar qysh më parë, mbi fushat përkatëse të shërbimit të psikologëve të shkollave. Kur bëhet ky informim, mbahet parasysh gjuha dhe ndryshimet kulturore, aftësitë njohëse, niveli i zhvillimit dhe mosha, që të mund të kuptohet si nga fëmija, prindi dhe kujdestari.

4 SMF-ja përpiqet të zgjidhë situatat ku mund të jetë në mëdyshje ose në konflikt interesi, në mënyrë që të mbrojë të drejtat e të gjithë palëve të përfshira.

5 SMF-të janë përgjegjës për drejtimin dhe natyrën e besimeve të tyre personale ose objektivave. Kur këto angazhime mund të ndikojnë në marrëdhënien profesionale, SMF-ja informon që më parë të gjithë personat e përfshirë në çështjet përkatëse, duke përfshirë, kur është e mundshme, edhe supervizorin e drejtpërdrejtë të tij për rishikimin e përgjegjësive.

6 SMF-ja nuk përfshin klientët në marrëdhëniet profesionale apo t'i drejtojë e t'i përfshijë ata në marrëdhëniet me kolegët. Asnjë individ, përfshirë fëmijët, klientët, punonjës, kolegë, trajnerë, prindër, mbikëqyrës dhe pjesëmarrës kërkimi, nuk do të ekspozohet ndaj komenteve të paramenduara, gjesteve apo kontakteve fizike të një natyre seksuale. SMF-ja nuk ngacmon apo poshtëron të tjerët, bazuar në karakteristikat personale. SMF-ja nuk përfshihet në marrëdhënie seksuale me nxënësit e saj/tij, supervizorët, trajnerët apo klientët e dikurshëm apo klientët e sotshëm.

7 Marrëdhëniet e dyfishta me klientët shmangen. Teorikisht, marrëdhëniet personale dhe të biznesit me klientët mund të turbullojnë gjykimin e dikujt. SMF-të janë në dijeni të këtyre situatave dhe i shmangin sa herë që është e mundur.

8 SMF-ja përpiqet të zgjidhë praktikat dyshuese ose jo etike në nivel joformal. Nëse përpjekjet joformale nuk janë produktive, supervizori, ose nëse bëhet fjalë për supervizorin, personit tjetër në hierarki, i kërkohet ndihmë dhe ndiqen procedurat e caktuara për respektimin e etikës profesionale.

a Skedimi i një ankese me natyrë etike, është një çështje serioze. Kjo gjë synon të përmirësojë sjelljen e një kolegu, që është e dëmshme për profesionin dhe/ose publikun. Ndaj SMF-ja bën çdo përpjekje për të diskutuar parimet etike me profesionistët e tjerë, të cilët mund të kenë bërë shkelje.

- **b** SMF-ja e trajton ankimimin me shumë kujdes dhe i/e shqetësuar për mirëqenien e të gjitha palëve. Ata nuk fusin në dosje ose nuk nxisin futjen në dosje të ankimeve etike, që janë të pavlera apo të motivuara nga hakmarrja.
- **c** Disa situata mund të jenë veçanërisht të vështira për t'u analizuar nga pikëpamja etike. SMF-ja konsultohet me standardet etike prej fushave të lidhura me to dhe kërkon ndihmë prej SMF-ve që kanë më shumë njohuri dhe eksperiencë dhe shoqatave rajonale/kombëtare për të gjetur rrugëzgjidhjen si të veprojë.
- **d** SMF-ja dokumenton raste specifike të shkeljeve të dyshuara të etikës (si, data, ora dhe detaje të ngjashme), si dhe përpiqet t'i zgjidhë ato.

**9** SMF-ja respekton konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë punës profesionale. Informacioni zbulohet vetëm me miratimin dhe dijeninë e fëmijës, apo të prindërve të fëmijës ose kujdestarit ligjor, përveç situatave të atilla kur mosdhënia e informacionit, do të përbënte në mënyrë të dukshme rrezik për fëmijën dhe të tjerët. Informacioni i vjetëruar konfidencial, duhet të copëtohet ose shkatërrohet para se të hidhet në koshat e riciklimit ose në konteinerët e mbeturinave.

**10** SMF-ja diskuton informacionin konfidencial vetëm për qëllime profesionale dhe vetëm me personat që kanë të drejtën ta dinë.

**11** SMF-ja informon fëmijët dhe klientët e tjerë për kufijtë e konfidencialitetit në fillimin e krijimit të një marrëdhënie profesionale.

## 10.2 Nxënësit

**12** SMF-të e kuptojnë natyrën intime të këshillimeve, vlerësimeve dhe shërbimeve të menjëhershme. Ata angazhohen vetëm në praktika profesionale që ruajnë dinjitetin dhe integritetin e fëmijëve dhe adoleshentëve.

**13** SMF-ja shpjegon aspektet e rëndësishme të marrëdhënieve të tyre profesionale në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke iu përshtatur aftësisë së moshës së çdo fëmije dhe klienti. Në shpjegim përfshihet arsyeja pse duhen shërbimet, kush do ta marrë informacionin rreth shërbimeve të ofruara dhe rezultatet e pritshme.

14 Kur një fëmijë merr një shërbim, SMF-ja e ka të qartë detyrën e vet për të respektuar të drejtën e një fëmije për të filluar, vazhduar ose për të ndërprerë shërbimin vullnetarisht. Kur një palë tjetër bëhet pjesë e këtij shërbimi, SMF-ja do të bëjë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen vullnetare të fëmijës.

15 Rekomandimet për ndryshimet në program apo shërbime shtesë, duhet të diskutohen me personat përkatës, përfshirë dhe alternativat ekzistuese.

## 10.3 Prindërit, kujdestarët ligjorë dhe kujdestarët e caktuar

16 SMF-të duhet t'ia shpjegojnë të gjitha shërbimet prindërve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Ata do të përpiqen të marrin parasysh vlerat dhe kapacitetet e çdo prindi. Për shërbimet e ofruara nga stazhierët, studentët që praktikohen ose trajnerët e tjerë, atyre u duhet shpjeguar dhe rënë dakort më parë.

17 SMF-të e njohin rëndësinë e mbështetjes prindërore dhe kërkojnë ta sigurojnë këtë mbështetje, duke marrë kontakt drejtpërsëdrejti me prindin, para se të takohen më pas rregullisht me fëmijën. (Emergjencat dhe vetëraportimet nga fëmija kërkojnë informimin sa më parë të prindërve. Mosha dhe rrethanat kur fëmijët mund të kërkojnë shërbime pa lejen e prindërve, variojnë shumë).

18 SMF-ja nxit dhe përkrah pjesëmarrjen e prindërve në përcaktimin e shërbimeve që do t'i ofrohen fëmijëve të tyre. Në rastet e nevojshme, këtu përfshihen edhe ndërhyrjet që bëjnë lidhjen mes shkollës dhe familjes, duke ia përshtatur angazhimin e prindërve aftësive të familjes, dhe duke i ndihmuar prindërit të fitojnë shprehitë që u duhen për të ndihmuar fëmijët e tyre.

19 SMF-ja respekton dëshirat e prindërve që kundërshtojnë shërbimet e psikologut të shkollës dhe përpiqen të drejtojnë prindërit drejt burimeve alternative të komunitetit.

20 SMF-ja diskuton me prindërit rekomandimet dhe planet për të ndihmuar fëmijët e tyre. Diskutimi përfshin alternativat e shoqëruara me çdo strukturë të planit, që tregon respekt për vlerat kulturore/etnike të familjes. Prindërit do të informohen rreth burimeve të ndihmës së disponueshme në shkollë dhe komunitet.

21 SMF-ja diskuton të drejtat e prindërve dhe të fëmijëve në lidhje me krijimin, modifikimin, ruajtjen dhe dhënien e informacionit konfidencial, që rezulton nga ofrimi i shërbimit psikologjik në shkolla.

## 10.4 Komuniteti

22 Edhe SMF-të janë qytetarë, ndaj pranojnë të njëjtat përgjegjësi dhe detyra si çdo anëtar tjetër i shoqërisë. Ata janë të lirë të kujdesen për interesat individuale, derisa nuk u kompromentohen përgjegjësitë profesionale.

23 SMF-ja mund të veprojë si individët e tjerë për të sjellë ndryshime shoqërore në mënyrë të ligjshme. Veprimet individuale nuk duhet të paraqiten, të sugjerohen, apo të demonstrohen si pjesë e punës për mbrojtjen e fëmijëve ose shërbimin psikologjik në shkolla.

24 Si punonjës SMF-të, nuk angazhohen dhe nuk zbatojnë praktika që diskriminojnë fëmijën, klientët e tjerë, ose punonjësit (nëse ka), bazuar në racë, aftësi të kufizuar, moshë, gjini, drejtime seksuale, besime fetare, origjinën kombëtare, statusin ekonomik ose gjuhën mëmë.

25 SMF-të shmangin çdo lloj veprimi që mund të shkelë ose pakësojë të drejtat ligjore dhe civile të fëmijëve dhe klientëve të tjerë.

26 SMF-të respektojnë, shtetin, ligjet vendore dhe dekretet që rregullojnë praktikën e tyre dhe përpjekjet e avokatisë. Nëse normat janë në konflikt me udhëzimet etike, SMF-ja përpiqet të zgjidhë këto konflikte në rrugë pozitive, të respektuara dhe ligjore, përfshirë edhe përpjekjet e avokatisë që janë pjesë e politikave publike.

## 10.5 Profesionistë të tjerë

27 Për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të fëmijëve dhe klientëve të tjerë, SMF-ja hyn në marrëdhënie me disiplina të tjera profesionale, bazuar në respektin reciprok dhe nxit veprime shumëdisiplinore dhe sistematike në mbrojte të fëmijëve.

28 SMF-të e njohin kompetencën e profesionistëve të tjerë. Ata nxisin dhe mbështesin përdorimin e të gjitha burimeve dhe sektorëve për t'i shërbyer sa më mirë interesit të fëmijëve, duke koordinuar sa herë lind nevoja masa ndërhyrjeje integruese.

29 SMF-ja duhet të përpiqet të shpjegojë fushën dhe kompetencat e saj, përfshirë dhe rolet e detyrat, si dhe marrëdhëniet e punës me profesionistët e tjerë.

30 SMF-ja koordinon dhe bashkëvepron me profesionistë të tjerë, Nëse një fëmijë dhe klient tjetër, është duke marrë një shërbim të ngjashëm nga një profesionist tjetër, SMF-ja mbështet koordinimin e shërbimeve.

31 Fëmija dhe klienti tjetër i drejtohet një profesionisti dhe shërbimi tjetër kur shfaqet një nevojë, që është jashtë kompetencave profesionale ose fushës së SMF-së.

32 Kur përgjegjësia e ndërhyrjes për një fëmijë ose klientë tjetër, kalon te një profesionist tjetër, SMF-ja bën të mundur që të njoftohen të gjithë individët përgjegjës, përfshirë dhe fëmijët, për ndryshimin dhe arsyet e ndryshimit.

33 Kur SMF-ja dyshon për ekzistencën e një praktike të dëmshme apo joetike nga një anëtar i një profesioni tjetër, ky person kontaktohet në mënyrë joformale, për t'i shprehur shqetësimin. Nëse situata nuk mund të zgjidhet kështu, kontaktohen organizatat profesionale përkatëse për të asistuar në përcaktimin e procedurave të vendosura nga ky profesion për ekzaminimin e çështjeve në fjalë.

34 SMF-të që punësojnë, mbikëqyrin, ose trajnojnë profesionistë të tjerë, pranojnë detyrimin për të ofruar përgatitje të vazhdueshme profesionale. Gjithashtu, ata sigurojnë kushte të përshtatshme pune, vlerësim të ndershëm dhe në kohë, si dhe këshillim të dobishëm.

## 10.6 Praktikantët dhe personat që trajnohen

35 SMF-të që mbikëqyrin studentët që praktikohen, janë përgjegjës për të gjitha praktikat profesionale të të mbikëqyrurve. Ata sigurojnë fëmijët dhe klientët e tjerë, se një student që kryen praktikën, mbikëqyret mjaftueshëm, siç përcaktohet në udhëzimet praktike dhe standardet e trajnimit për SMF-të.

36 SMF-ja që drejton apo administron programe trajnuese, i ofron personave që trajnohen dhe atyre që do të trajnohen informacionin e duhur lidhur me sponsorizimet/miratimet/akreditimet, qëllimet/

objektivat e programit, proceset e trajnimit dhe kërkesat, si dhe rezultatet e përfitimet e pritshme.

**37** SMF-të që janë pedagogë në shkolla të larta apo universitete ose që mbikëqyrin trajtimet e rasteve në klinike apo në terren, i përdorin këto parime etike në të gjitha punët me personat që trajnohen lidhur me çështjen e mbrojtjes së fëmijëve. Veç kësaj, ata mbështesin praktikën etike të studentit praktikant, duke ofruar udhëzime të veçanta dhe gjithëpërfshirëse, komente dhe këshillime.

**38** SMF-të pedagogë në shkollat e larta dhe mbikëqyrësit e klinikës ose terrenit, mbështesin standardet e profesionit, duke ofruar trajnime të një cilësie të lartë, shërbime të përgjegjshme dhe shkencore, si dhe shërbime psikologjike në mbrojtje të fëmijëve në shkolla. Ata sigurojnë informacion të saktë dhe objektiv në aktivitetet e tyre mbi procesin e mësimdhënies dhe trajnimit; identifikojnë kufizimet në informacion dhe pranojnë të dhënat jokoherente, hipotezat alternative dhe shpjegimet.

**39** Pedagogët e fakultetit të psikologjisë në shkollë dhe mbikëqyrësit në klinika ose të terrenit, zhvillojnë dhe përdorin për të trajnuarit praktika vlerësimi, çka janë objektive, të sakta dhe të drejta.

# 11 Parimet dhe praktikat profesionale për Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve

Kapitulli i njëmbëdhjetë paraqet një përmbledhje mbi parimet dhe praktikat profesionale për SMF-në.

## 11.1 Avokatia

1 SMF-ja zakonisht u shërben klientëve të shumtë, përfshirë dhe prindërit, fëmijët dhe sistemet. Kur SMF-ja përballet me konflikte midis grupeve të klientëve, klienti parësor konsiderohet fëmija. Në rastet kur fëmija nuk është klienti kryesor, janë grupet e individëve apo vetë individët klienti kryesor i SMF-së.

2 SMF-të i konsiderojnë fëmijët dhe klientët e tjerë si përgjegjësia e tyre kryesore, duke vepruar si avokat për të drejtat dhe mirëqenien e tyre. Nëse ekzistojnë konflikte interesi midis klientëve, SMF-ja mbështet përfundimet që i shërbejnë interesit më të mirë të fëmijës. Kur

bëhet fjalë për zgjidhjen e një rrjedhe veprimi, SMF-ja merr parasysh të drejtat e çdo individi të përfshirë dhe detyrat e personelit të shkollës.

3 Shqetësimet e SMF-së për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës, i komunikohen administratës dhe personelit të shkollës si prioriteti kryesor për të përcaktuar shërbimet.
4 SMF-ja njeh procesin e politikave publike shqiptare për të ndihmuar në përpjekjet e tyre për të mbrojtur ligjërisht fëmijët, prindërit dhe sistemet.

## 11.2 Ofrimi i shërbimeve

1 SMF-të përpiqen të jenë pjesëtarë të plotë të rrjetit të sigurisë së shkollës dhe detyrave që i janë caktuar. Ata përcaktojnë role të qarta për veten në atë sistem.
2 SMF-ja që i ofron shërbime grupeve të ndryshme, mund të përballet me situata ku besimet konfliktohen. Pozicioni i SMF-së i paraqitet sa më parë të jetë e mundur të gjitha palëve, për të parandaluar keqkuptimet.
3 SMF-ja mbështet ndryshimet në shkollën e tij dhe sistemin e shërbimeve të komunitetit nga të cilat përfitojnë fëmijët.

## 11.3 Vlerësimi dhe ndërhyrja

1 SMF-ja ndjek standardet më të larta për vlerësimin mësimor dhe psikologjik, si dhe për ndërhyrjet direkte dhe indirekte.

   a Për kryerjen e vlerësimeve psikologjike, mësimore apo të sjelljes, si dhe për të ofruar terapi, shërbime këshillimi dhe konsultimi, rëndësi të veçantë i jepet integritetit dhe karakteristikave individuale.
   b SMF-ja respekton ndryshimet në moshë, gjini, orientimin seksual si dhe origjinën social-ekonomike, kulturore dhe etnike. Ata përzgjedhin dhe përdorin vlerësimet ose procedurat e trajtimit, teknikat dhe strategjitë e duhura. Duke u nisur nga vlerësimet, merren vendime dhe bëhen ndërhyrje, duke u mbështetur në radhë të parë në të dhënat.

2 SMF-ja është në dijeni për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e instrumentave dhe teknikave të tij/saj, duke zgjedhur ato që mbështeten në të dhënat më të fundit të standardizimit dhe janë të përdorshme e të përshtatshme në të mirë të fëmijës.
3 SMF-ja përdor metoda të shumta vlerësimi, si vëzhgimin, informacionin mbi të shkuarën dhe burime të ndryshme informacioni nga profesionistët e tjerë (mësuesit, drejtori i shkollës, mjeku i shkollës, inspektori i policisë), prindërit dhe fëmijët, për të arritur në rezultate gjithëpërfshirëse.
4 SMF-ja përdor teknika vlerësimi, këshillimi dhe procedura terapie, teknika këshillimi dhe metoda të tjera direkte dhe indirekte shërbimi, që janë të rëndësishme për profesionin dhe praktikën e bazuar në studime.
5 SMF-ja nuk lejon kurrsesi që teknikat për vlerësim psikologjik ose mësimor apo informacioni që ofrojnë këto teknika, të keqpërdoren nga persona të pakualifikuar.
6 SMF-ja kryen ndërhyrje që janë të përshtatshme për problemet që dalin dhe përputhen me të dhënat e mbledhura. Ai/ajo modifikon ose përfundon planin e veprimit, kur të dhënat tregojnë se plani nuk po arrin objektivin e dëshiruar.
7 SMF-ja përdor strategjitë aktuale të vlerësimit dhe ndërhyrjes, që ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit mendor të fëmijëve, të cilëve u shërbejnë.

## 11.4 Të dhënat e raportimit

1 SMF-ja sigurohet që informacioni rreth fëmijëve dhe klientëve të tjerë, u shkon vetëm personave të autorizuar.

   a SMF-ja shpjegon me kujdes informacionin, kështu që marrësi mund ta ndihmojë sa më shumë fëmijën.
   b SMF-ja ndihmon shkollat për të përcaktuar procedura që ruajnë me kujdes informacionin konfidencial.

2 SMF-ja i komunikon gjetjet dhe rekomandimet në një gjuhë që të jetë e kuptueshme për marrësin. Këto komunikime përshkruajnë pasojat që mund të shoqërojnë masat e propozuara.

3 SMF-ja përgatit raporte me shkrim në atë formë dhe stil, që marrësi i raportit të jetë në gjendje të ndihmojë fëmijën dhe/ose prindin. Raportet duhet të nënvizojnë rekomandimet dhe shpjegimet.

4 SMF-ja kontrollon për saktësi dokumentet e shkruara, duke i nënshkruar vetëm kur janë të sakta. Stazhierët dhe studentët e praktikës, identifikohen si të tillë vetëm kur puna e tyre miratohet dhe firmoset nga SMF-ja, që i mbikëqyr. Në situatat kur
në mbledhjen e informacionit dhe procesin e raportimit, merr pjesë më shumë se një profesionist, SMF-ja sigurohet që burimet e të dhënave të identifikohen qartë në raportin e shkruar.

5 SMF-ja pajtohet me të gjitha ligjet, rregullat dhe politikat që lidhen me mbledhjen e përshtatshme dhe vënien në dispozicion të të dhënave për të ruajtur konfidencialitetin e duhur të informacionit.

## 11.5 Përdorimi i materialeve dhe teknologjisë

1 SMF-ja merr miratim me shkrim qysh më parë, përndryshe i heq të gjitha të dhënat identifikuese të klientëve të vet në leksionet publike ose në botimet që bën.

2 Për të siguruar konfidencialitetin, të dhënat e nxënësve/klientëve nuk transmetohen në formë elektronike, pa siguruar garancinë e fshehtësisë. Në lidhje me këtë parim, një aparat faksi duhet të jetë në vend të sigurt dhe të përdoret nga punonjës që kanë idenë e dosjeve konfidenciale, dhe mesazhet me e-mail duhet të kodohen ose të zhvishen nga i gjithë informacioni që identifikon nxënësin/klientin.

3 SMF-ja nuk pranon pagesë të asnjë forme në shkëmbim të të dhënave nga sistemi i të dhënave të klientit, pa miratim.

## 11.6 Studimi, publikimi dhe prezantimi

1 Kur hartohet dhe zbatohet studimi në shkollë, SMF-ja zgjedh ato tema dhe përdor metodologjinë kërkimore, teknikat për zgjedhjen e subjekteve, metoda për mbledhjen e të dhënave dhe teknika analize e raportimi, që bazohen në praktikën studimore shkencore.

2 Përpara se të nisë kërkimi, psikologu i shkollave, në mungesë të komitetit të rishqyrtimit, duhet të ketë të paktën një koleg tjetër, mundësisht një SMF, që të analizoëj metodat e propozuara.
3 Kur kryen kërkime, SMF-ja ndjek të gjitha procedurat ligjore, përfshirë dhe procedurat në lidhje me miratimin, konfidencialitetin, fshehtësinë, mbrojtjen nga dëmtimet ose rreziqet, pjesëmarrjen vullnetare dhe paraqitjen e rezultateve pjesëmarrësve. SMF-ja shfaq respekt për të drejtat dhe mirëqenien e pjesëmarrësve në kërkimin shkencor.
4 Në publikimin e raporteve të studimit të tyre, SMF-të diskutojnë për paplotësinë e të dhënave dhe pranojnë ekzistencën e të dhënave jokoherente, si dhe të hipotezave të alternuara dhe japin shpjegime për rezultatet e tyre.

# 12 Udhëzime për Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve

Kapitulli 12 prezanton udhëzimet praktike të SMF-ve individualë, psikologut të shkollës dhe njësisë përgjegjëse në Drejtorinë Arsimore Rajonale.

## 12.1 Të përgjithshme

Pjesa e parë paraqet përgjegjësitë individuale të SMF-ve/psikologut të shkollës. Pjesa e dytë thekson përgjegjësitë që duhet të marrë njësia që përgjigjet për ofrimin e shërbimeve psikologjike në Drejtorinë Arsimore Rajonale (për shembull, koordinatori për psikologët e shkollës), i cili punëson SMF-të/psikologët e shkollave. "Njësia" përkufizohet si entiteti përgjegjës për të siguruar që shkollat, studentët dhe familjet, marrin shërbime të plota psikologjike dhe që në shkollë po zbatohen standardet për mbrojtjen e fëmijëve. Jo të gjithë SMF-të/psikologët ose njësitë e shërbimeve psikologjike në shkollë, do të jenë në gjendje të përmbushin standartet që përmban ky dokument. Pavarësisht kësaj, është parashikuar që këto udhëzime të shërbejnë si një model i "praktikës së mirë" për zhvillimin e programit dhe praktikës profesionale në nivel rrethi, qarku dhe kombëtar. SMF-të/psikologët e shkollës do të kuptojnë, se e gjithë kjo, është për interesin e tyre më të mirë, si dhe për interesin e shkollës, prindërve, dhe fëmijëve, të cilëve u shërbejnë, që t'i përkrahin dhe mbështesin këto **Udhëzime**.

## 12.2 Udhëzime praktike për Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve

**UDHËZIMI PRAKTIK 1:** SMF-ja përdor një proces vendimmarrjeje në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit: **a)** për të identifikuar problemet mësimore dhe të sjelljes, si dhe shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve, **b)** për të mbledhur dhe analizuar informacionin për të kuptuar problemet, **c)** për të marrë vendime për kryerjen e shërbimeve dhe **d)** për të vlerësuar rezultatet e shërbimeve.

Psikologët e shkollës duhet: **a)** të përdorin literaturën aktuale profesionale mbi aspektet e ndryshme të edukimit dhe zhvillimit të fëmijës, **b)** t'i zabtojnë në praktikë gjetjet e kërkimeve shkencore përmes procesit të zgjidhjes së problemeve dhe **c)** të përdorin dizenjimin e kërkimeve shkencore dhe shprehitë statistikore për të zhvilluar dhe lehtësuar shërbimet efikase.

**UDHËZIMI PRAKTIK 2:** SMF-ja duhet të ketë aftësinë të dëgjojë mirë, të marrë pjesë në diskutime, të përçojë informacionin dhe të punojë së bashku me të tjerët në grup, me individë ose në nivel sistemi. SMF-ja duhet të kuptojë se deri në çfarë mase ndikon politika në sistem, sistemet ndikojnë në program, programet dhe ndërhyrjet ndikojnë te përdoruesi dhe se si metodat lehtësojnë zhvillimin organizativ me anë të ndryshimit strategjik.

**UDHËZIMI PRAKTIK 3:** SMF-ja në (bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale) vendos objektiva njohëse dhe mësimore sfiduese, por të arritshme, për të gjithë nxënësit, ofron informacion për rrugët që nxënësit duhet të ndjekin për të arritur objektivat dhe monitoron ecurinë e nxënësve drejt këtyre objektivave.

**UDHËZIMI PRAKTIK 4:** SMF-ja merr vendime bazuar në perspektiva të shumta teorike dhe vë në praktikë informacionin aktual shkencor, për të përcaktuar objektiva sjelljeje efikase, afektive ose që u përshtaten të gjithë nxënësve, lehtëson zbatimin e programit/ndërhyrjeve psiko-sociale për të arritur këto objektiva dhe monitoron ecurinë e përmbushjes së tyre.

**UDHËZIMI PRAKTIK 5:** SMF-ja/psikologu i shkollës kanë ndjeshmërinë, njohurinë dhe aftësinë për të punuar me individë dhe grupe me karakteristika dhe nevoja të natyrave nga më të ndryshme si racore, kulturore, etnike, përvojash dhe gjuhësore.

**UDHËZIMI PRAKTIK 6:** Kur punojnë me grupe dhe individë, SMF-ja/psikologët e shkollave demonstrojnë njohuritë që kanë për shkollën si një sistem, me qëllim që të lehtësojnë zhvillimin e strukturave dhe politikave publike përkujdesëse, për të gjithë personat.

**UDHËZIMI PRAKTIK 7:** SMF-ja/psikologët e shkollave do të shfrytëzojnë siç duhet metodat e parandalimit, mbrojtjes së shëndetit dhe ndërhyrjes në raste krizash, të bazuara në njohurinë mbi zhvillimin e fëmijës, psikopatologjinë, shumëllojshmërinë, stresorët socialë, ndryshimet dhe sistemet.

**UDHËZIMI PRAKTIK 8:** SMF-ja/psikologët e shkollave janë në dijeni të ndikimit të familjeve që veprojnë në mirëqenien e fëmijës, në aftësinë e tij për të mësuar dhe për të arritur rezultate dhe janë të përfshira në hartimin e politikave publike, që nxitin partneritetin midis prindërve, mësuesve dhe komunitetit.

## 12.3 Udhëzime praktike për Inspektorët e Drejtorisë Arsimore Rajonale

**UDHËZIMI 1 PËR NJËSINË: Organizimi dhe ofrimi i shërbimeve**
Shërbimet psikologjike shkollore ofrohen në mënyrë të koordinuar, të organizuar dhe në një formë që siguron vijimësi të plotë e të pandërprerë. Shërbimet ofrohen sipas një procesi planifikimi strategjik, i bazuar në nevojat e klientëve dhe një model vlerësues të mbështetur nga të dhënat empirike.

**UDHËZIMI 2 PËR NJËSINË: Klima**
Është përgjegjësia e njësisë të krijojë një klimë në të cilën shërbimet psikologjike të shkollës, të mund të ofrohen përmes respektimit të ndërsjelltë të të gjitha palëve. Punonjësit e njësisë janë të lirë të promovojnë shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat e klientëve dhe nuk

kanë detyrimet artificiale, administrative dhe politike që mund të pengojnë ose ndryshojnë ofrimin e shërbimeve të përshtatshme.

**UDHËZIMI 3 PËR NJËSINË: Rekrutimi, përfitimet sociale, ekonomike dhe të vendit të punës**

Njësitë e shërbimit psikologjik në shkollë sigurojnë që: **a)** ekziston një plan i përshtatshëm rekrutimi dhe mbrojtje të punonjësve, për të siguruar që personeli i ngarkuar të plotësojë nevojat e sistemit; **b)** të gjitha burimet e fondeve, si publike dhe private, përdoren dhe rriten për të siguruar mbështetjen fiskale të nevojshme për ofrimin e shërbimeve sa më të sakta; **c)** të gjithë punonjësit kanë në dispozicion teknologjinë e duhur, shërbime zyre dhe mjedis fizik pune të përshtatshëm dhe se **d)** punonjësit kanë përfitime personeli të mjaftueshme për të mbështetur punën e njësisë, përfshirë dhe zhvillimin e vazhdueshëm arsimor profesional.

**UDHËZIMI 4 PËR NJËSINË: Komunikimi dhe teknologjia**

Njësive të shërbimeve psikologjike të shkollës u garantohet se ekzistojnë politika dhe praktika që realizojnë një komunikim pozitiv dhe proaktiv, si dhe sisteme teknologjike si në njësi, ashtu edhe në strukturën organizative me të cilën ndërvepron njësia.

**UDHËZIMI 5 PËR NJËSINË: Mbikëqyrja**

Njësia për shërbime psikologjike në shkollë, sigurohet se i gjithë personeli mbikëqyret për të garantuar ofrimin e shërbimeve të vlefshme dhe të përgjegjshme. Mbikëqyrja bëhet me anë të një procesi të vazhdueshëm, pozitiv, sistematik dhe bashkëpunues midis SMF-së/psikologut të shkollës dhe mbikëqyrësit të shkollës së psikologjisë. Ky proces fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të aftësimit profesional dhe praktikës shembullore profesionale, që çon në përmirësimin e shërbimeve nga të gjithë personat përgjegjës, përfshirë dhe SMF-të/psikologët e shkollave, mbikëqyrësit, nxënësit dhe i gjithë komuniteti i shkollës.

**UDHËZIMI 6 PËR NJËSINË: Zhvillimi profesional dhe sistemet e vlerësimit**

SMF-të/psikologët e shkollave dhe njësia për shërbimet psikologjik në shkollë, përpilojnë plane vjetore për aftësimin profesional. Njësia për shërbimin psikologjik në shkollë, sigurohet që zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit të saj, të jetë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, në përputhje me përparësinë e dhënies së shërbimeve të njësisë dhe se

ekzistojnë sisteme vlerësimi për të pasqyruar vazhdimësinë e aktiviteteve të zhvillimit profesional për personelin.

## Përmbledhje

Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve shërbejnë si persona kontakti për problemet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla. Ata marrin rolin e katalizatorit në zbatimin e standardeve dhe vlerave për mbrojtjen e fëmijëve si dhe fuqizojnë rrjetet e sigurisë së shkollës.

Ata bashkëpunojnë nga afër me personelin arsimor dhe drejtorinë e shkollës, prindërit dhe profesionistë të tjerë, për të dhënë shërbimin më të mirë të mundshëm për fëmijët.

Ata dokumentojnë të gjitha veprimet e kryera dhe raportojnë statistika mbi mbrojtjen e fëmijëve në shkollën ku ata punojnë.

Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve, janë trajnuar mirë si në psikologji ashtu edhe në mbrojtjen e fëmijëve, për t'i shërbyer sa më mirë fëmijëve në rast nevoje. Ata kanë njohuri të thella mbi shëndetin mendor, zhvillimin e fëmijës, organizimin e shkollës, proceset dhe mënyrat e të mësuarit, sjelljen, motivimin, mësimdhënien dhe kujdesin ndaj fëmijës.

Ata kryejnë detyrat e tyre në bazë të etikës profesionale dhe gjithmonë marrin në mbrojtje dhe veprojnë në interes të fëmijës.

## Pika kontrolli

Përpiquni t'u përgjigjeni këtyre pesë pyetjeve. Për të kontrolluar nëse i keni dhënë të sakta përgjigjet, referojuni kapitujve përkatës.

1. Cili është mandati i Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkollë?
2. Cilat aftësi dhe kompetenca duhet të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve?
3. Kush janë partnerët kryesore që bashkëpunojnë me Specialistin për Mbrojtjen e Fëmijëve brenda dhe jashtë shkollës?
4. Si mendohet të zgjidhë konfliktet e interesave midis palëve Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve?
5. Çfarë metafore do të përdorje për të shpjeguar rolin e Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve në rrjetin e komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve?

# Lista e anekseve


| | | |
|---|---|---|
| | **Seksioni A** | |
| **ANEKSI 1** | Përmbledhje e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve **(KDF)** | 136 |
| | **Seksioni B** | |
| **ANEKSI 2** | KDF-ja – Qëllimet e edukimit | 145 |
| **ANEKSI 3** | Vetëvlerësimi i shkollës | 157 |
| **ANEKSI 4** | Lista e kontrollit për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla | 163 |
| **ANEKSI 5** | Politika dhe procedurat e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve | 172 |
| **ANEKSI 6** | Forma e raportimit mujor mbi mbrojtjen e fëmijëve për shkollat | 190 |
| **ANEKSI 7** | Udhëzues referimi | 198 |
| **ANEKSI 8** | Modeli i këshillimit me kolegët | 202 |

# Seksioni C

## Anekset

# 1 Përmbledhje e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve (KDF)

**NENI 1** **PËRCAKTIMI I FËMIJËS:** Konventa e përcakton një “fëmijë” si një person nën moshën 18 vjeçare, me përjashtim të rasteve kur ligjet e një vendi të veçantë e përcaktojnë moshën ligjore madhore në një moshë më të re. Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve, organi monitorues i Konventës, i ka nxitur shtetet ta rishikojnë moshën madhore, nëse ajo është përcaktuar më poshtë se 18 vjeç dhe të rrisin nivelin e mbrojtjes për të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeçare.

**2** **MOSDISKRIMINIMI:** Konventa përfshin të gjithë fëmijët, pavarësisht nga raca, besimi fetar ose aftësitë, çfarëdo që ata mendojnë ose thonë, ose nga çfarëdo lloj familje që vijnë. Nuk ka rëndësi se ku jetojnë fëmijët, se çfarë gjuhe flasin, çfarë bëjnë prindërit e tyre, nëse ata janë djem apo vajza, cila është kultura e tyre, nëse kanë aftësi të kufizuara ose nëse ata janë të pasur apo të varfër. Asnjë fëmijë nuk duhet të trajtohet në mënyrë të padrejtë për asnjë arsye.

**3** **INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS:** Interesi më i mirë i fëmijëve duhet të jetë konsiderata parësore në marrjen e vendimeve që mund të ndikojnë mbi fëmijët. Të gjithë të rriturit duhet të bëjnë atë çfarë është më e mirë për fëmijët. Kur të rriturit marrin vendime, ata duhet të mendojnë se si do të ndikojnë këto vendime mbi fëmijët. Kjo ka të bëjë veçanërisht me buxhetin, politikën dhe vendimmarrësit.

4 **MBROJTJA E TË DREJTAVE:** Qeveritë kanë përgjegjësi që të marrin masa të vlefshme për të siguruar që të drejtat e fëmijëve të respektohen, mbrohen dhe të përmbushen. Kur vendet e ndryshme ratifikojnë konventën, ata bien dakord të rishikojnë ligjet e tyre që kanë të bëjnë me fëmijët. Këtu përfshihen shërbimet e tyre shoqërore, sistemet ligjore, shëndetësore dhe arsimuese, si dhe nivelet e financimit për këto shërbime. Si rezultat, qeveritë janë të detyruara të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar se standardet minimale të përcaktuara nga konventa, po përmbushen. Ata duhet të ndihmojnë familjet që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe të krijojnë një mjedis ku ata të rriten dhe të arrijnë potencialin e tyre. Në disa raste, kjo mund të përfshijë ndryshimin e ligjeve ekzistuese ose krijimin e ligjeve të reja. Këto ndryshime legjislative nuk imponohen, por ndodhin nëpërmjet të njëjtit proces, ku çdo ligj krijohet apo përmirësohet brenda një vendi. **NENI 41** i Konventës vë në dukje se, kur një vend ka tashmë standarde më të larta ligjore se ata të përcaktuara në Konventë, standardet më të larta gjithmonë mbizotërojnë.

5 **UDHËHEQJA PRINDËRORE:** Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e familjeve për të drejtuar dhe udhëhequr fëmijët e tyre, në mënyrë që, ndërsa ata rriten, të mësojnë se si t'i përdorin të drejtat e tyre siç duhet. Ndihma që fëmijët të kuptojnë të drejtat e tyre, nuk do të thotë që t'i shtyjmë ata të bëjnë zgjedhje që kanë pasoja të atilla, për të cilat ata janë shumë të rinj që të mund t'i trajtojnë. **NENI 5** i inkurajon prindërit të trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat "në një mënyrë të pajtueshme e kapacitetet në zhvillim të fëmijës". Konventa nuk merr përgjegjësi për fëmijët që jetojnë larg prindërve të tyre dhe u jep më shumë autoritet qeverive. Ajo vë mbi qeveritë përgjegjësitë për të mbrojtur dhe për t'u ardhur në ndihmë familjeve në përmbushjen e roleve të tyre thelbësore si edukues të fëmijëve.

6 **MBIJETESA DHE ZHVILLIMI:** Fëmijët kanë të drejtën të jetojnë. Qeveritë duhet të garantojnë që fëmijët mbijetojnë dhe zhvillohen në mënyrë të shëndetshme.

7 **REGJISTRIMI, EMRI, KOMBËSIA, KUJDESI: T**ë gjithë fëmijët kanë të drejtën të kenë një emër të regjistruar ligjërisht dhe të drejtën për t'u njohur zyrtarisht nga qeveria. Fëmijët kanë të drejtën për një nënshtetësi (t'i përkasin një shteti). Fëmijët kanë, gjithashtu, të drejtën të njohin prindërit e tyre dhe sa më shumë që të jetë e mundur, të kenë kujdesin e tyre.

8 **RUAJTJA E IDENTITETIT:** Fëmijët kanë të drejtën për një identitet – një regjistrim zyrtar se cilët janë ata. Qeveritë duhet të respektojnë të drejtat e fëmijëve për të pasur një emër, një kombësi dhe lidhje familjare.

9 **NDARJA NGA PRINDËRIT:** Fëmijët kanë të drejtën të jetojnë me prindërit e tyre, me përjashtim të rastit kur kjo nuk është në të mirën e tyre. Fëmijët, prindërit e të cilëve nuk jetojnë së bashku, kanë të drejtën të jenë në kontakt me të dy prindërit, me përjashtim të rastit kur kjo mund ta lëndojë fëmijën.

10 **RIBASHKIMI FAMILJAR:** Familjet, anëtarët e të cilëve jetojnë në shtete të ndryshme, duhet të lejohen të lëvizin ndërmjet këtyre shteteve në mënyrë që prindërit dhe fëmijët të mund të qëndrojnë në kontakt ose të bashkohen sërish si familje.

11 **RRËMBIMI:** Qeveritë duhet të ndërmarrin hapa që të ndalojnë marrjen [nxjerrjen] e fëmijëve jashtë vendit të tyre në mënyrë të jashtëligjshme. Ky Nen i referohet veçanërisht rrëmbimeve nga prindërit. Protokolli Fakultativ i Konventës për shitjen e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, ka një dispozitë që ka të bëjë me rrëmbimet për përfitime financiare.

12 **RESPEKTI PËR OPINIONET E FËMIJËVE:** Kur të rriturit marrin vendime që kanë ndikim mbi fëmijët, fëmijët kanë të drejtën të thonë atë që mendojnë se duhet të ndodhë dhe opinionet e tyre duhet të merren në konsideratë. Kjo nuk do të thotë se tani fëmijët mund t'u thonë prindërve se çfarë të bëjnë. Kjo Konventë i inkurajon të rriturit të dëgjojnë opinionet e fëmijëve dhe t'i përfshijnë ata në marrjen e vendimeve dhe jo t'u japin autoritet fëmijëve mbi të rriturit. **NENI 12** nuk ndërhyn në të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve për të shprehur opinionet e tyre mbi çështje që kanë ndikim mbi fëmijët e tyre. Gjithashtu, Konventa njeh se niveli i pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje duhet të jetë në përputhje me nivelin e maturisë së tyre. Aftësia e fëmijëve për të shprehur opinionet e tyre, zhvillohet me moshë dhe shumica e të rriturve, natyrisht, u japin më shumë peshë opinioneve të adoleshentëve, sesa opinioneve të fëmijëve parashkollorë, si në vendimet familjare, ashtu dhe në vendimet ligjore apo dministrative.

13 **LIRIA E FJALËS:** Fëmijët kanë të drejtën të marrin dhe ta ndajnë informacionin, për aq kohë sa informacioni nuk dëmton ata apo të tjerët. Duke praktikuar të drejtën e lirisë së fjalës, fëmijët kanë përgjegjësinë që të

respektojnë të drejtat, liritë dhe reputacionin e të tjerëve. Liria e fjalës përfshin të drejtën për të ndarë informacionin në mënyrën që ata zgjedhin, përfshirë të folurit, vizatimin ose shkrimin.

14 **LIRIA E MENDIMIT, VETËDIJES DHE BESIMIT FETAR:** Fëmijët kanë të drejtën të mendojnë dhe besojnë çfarë të duan dhe të praktikojnë besimin e tyre, për aq kohë sa ata nuk ndalojnë njerëzit e tjerë që të gëzojnë të drejtat e tyre. Prindërit duhet të japin ndihmë në drejtimin e fëmijëve të tyre në këto çështje. Konventa respekton të drejtat dhe detyrat e prindërve në ofrimin e udhëheqjes shpirtërore dhe morale të fëmijë të tyre. Grupet fetare në të gjithë botën kanë shprehur mbështetjen e tyre për Konventën, gjë që tregon se ajo nuk i pengon prindërit në asnjë mënyrë që t'i rrisin fëmijët me një traditë fetare. Në të njëjtën kohë, Konventa njeh se ndërsa fëmijët maturohen, ata janë në gjendje të krijojnë pikëpamjet e tyre. Disa prej tyre mund të ngrenë pyetje mbi praktikat fetare dhe traditat kulturore. Konventa mbështet të drejtat e fëmijëve për të ekzaminuar besimet e tyre, por, gjithashtu, shpall se e drejta e tyre për të shprehur besimet e tyre fetare, përfshin respektin për të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

15 **LIRIA E SHOQËRIMIT:** Fëmijët kanë të drejtën të takohen së bashku dhe të marrin pjesë në grupe dhe organizata, për aq kohë sa ata nuk ndalojnë (pengojnë) njerëzit e tjerë që të gëzojnë të drejtat e tyre. Duke praktikuar të drejtat e tyre, fëmijët kanë përgjegjësinë që të respektojnë të drejtat, liritë dhe reputacionin e të tjerëve.

16 **E DREJTA PËR INTIMITET:** Fëmijët kanë të drejtën e intimitetit. Ligji duhet t'i mbrojë ata nga sulmet ndaj mënyrës së tyre të jetesës, emrit të tyre të mirë, familjeve dhe shtëpive të tyre.

17 **AKSESI NË INFORMACION; MEDIA PUBLIKE:** Fëmijët kanë të drejtën të marrin informacionin që është i rëndësishëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Qeveritë duhet të inkurajojnë median publike – radion, televizionin, gazetat dhe burimet e internetit – të japë informacion që fëmijët mund ta kuptojnë dhe të mos inkurajojnë materiale që mund të dëmtojnë fëmijët. Media publike duhet të inkurajohet në veçanti, që të ofrojë informacion në gjuhët që mund ta kuptojnë fëmijët e minoriteve apo të grupeve indigjene. Fëmijët duhet të kenë, gjithashtu, akses në librat për fëmijë.

18 **PËRGJEGJËSITË PRINDËRORE; NDIHMA NGA SHTETI:** Të dy prindërit ndajnë përgjegjësinë për rritjen e fëmijëve të tyre dhe duhet të marrin në konsideratë se çfarë është më e mirë për çdo fëmijë. Qeveritë duhet të respektojnë përgjegjësinë e prindërve për t'u ofruar udhëheqjen e duhur fëmijëve të tyre – Konventa nuk merr përgjegjësi për fëmijët që jetojnë larg prindërve të tyre dhe u jep më shumë autoritet qeverive. Ajo vë mbi qeveritë përgjegjësitë për të ofruar shërbime mbështetëse për prindërit, sidomos, nëse të dy prindërit punojnë jashtë shtëpisë.

19 **MBROJTJA NGA TË GJITHË FORMAT A DHUNËS):** Fëmijët kanë të drejtën të mbrohen nga lëndimi dhe keqtrajtimi fizik apo mendor. Qeveritë duhet të garantojnë se për fëmijët tregohet kujdesi i duhur dhe duhet t'i mbrojnë ata nga dhuna, abuzimi dhe shpërfillja nga prindërit, ose kushdo tjetër që kujdeset për ta. Përsa i përket disiplinës, Konventa nuk specifikon se çfarë formash ndëshkimi duhet të përdorin prindërit. Sidoqoftë, çdo formë disiplinimi që përfshin dhunën, është e papranueshme. Ekzistojnë mënyra të efekshme për të disiplinuar fëmijët, për t'i ndihmuar fëmijët që të mësojnë se si familja dhe shoqëria pret që të sillen ata – mënyra jo të dhunshme, të përshtatshme për nivelin e zhvillimit të fëmijës dhe që marrin në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës. Në shumicën e shteteve, ligjet përcaktojnë se çfarë lloje ndëshkimesh quhen të tepruara apo abuzuese. Është detyra e secilës qeveri që t'i rishikojnë këto ligje nën dritën e Konventës.

20 **FËMIJËT E HEQUR NGA MJEDISI FAMILJAR:** Fëmijët për të cilët familjet e tyre nuk mund të kujdesen, kanë të drejtën për një kujdes të veçantë dhe për ta duhet të tregohet kujdes i përshtatshëm nga njerëz që respektojnë grupet etnike, besimet fetare, kulturën dhe gjuhën e fëmijëve.

21 **ADOPTIMI:** Fëmijët kanë të drejtën për kujdes dhe mbrojtje nëse ata adoptohet apo jetojnë me familje birësuese. Shqetësimi i parë duhet të jetë se, çfarë është më e mirë për ta. Të njëjtat rregulla duhet të zbatohen, nëse ata adoptohen brenda vendit ku ata kanë lindur, ose nëse ata çohen për të jetuar në një vend tjetër.

22 **FËMIJËT REFUGJATË:** Fëmijët kanë të drejtën për mbrojtje të veçantë dhe ndihmë nëse ata janë refugjatë (nëse ata janë detyruar të lënë shtëpitë e tyre dhe të jetojnë në një vend tjetër), si dhe për të gjitha të drejtat në këtë Konventë.

23 **FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA:** Fëmijët të cilët kanë ndonjë aftësi të kufizuar, kanë të drejtën për një kujdes të veçantë dhe mbështetje, si dhe të gjithë të drejtat në konventë, në mënyrë që ata të gëzojnë një jetë të plotë dhe të pavarur.

24 **SHËNDETI DHE SHËRBIMET SHËNDETËSORE:** Fëmijët kanë të drejtën për një kujdes shëndetësor cilësor – kujdesin më të mirë shëndetësor të mundshëm – ujë të pijshëm të sigurtë, ushqim të përshtatshëm, mjedis të pastër dhe të sigurtë dhe informacion për t'i mbajtur ata të shëndetshëm. Vendet e pasura duhet të ndihmojnë vendet e varfra për të arritur këtë.

25 **RISHIKIMI I TRAJTIMIT NËN KUJDES:** Fëmijët për të cilët kujdesen autoritetet vendore, në vend të prindërve të tyre, kanë të drejtën që t'i kenë këto forma jetese të kontrolluara rregullisht, për të parë nëse ato janë më të përshtatshmet për ta. Kujdesi dhe trajtimi i tyre, duhet të bazohet gjithmonë mbi interesin më të mirë të fëmijës. (Shihni Parimet e Udhëheqjes, **NENI 3**)

26 **SIGURIMI SHOQËROR:** Fëmijët – si nëpërmjet kujdestarëve të tyre ose drejtpërdrejt – kanë të drejtën për ndihmë nga qeveria, nëse ata janë të varfër apo në nevojë.

27 **STANDARDET E PËRSHTATSHME TË JETESËS:** Fëmijët kanë të drejtën për standarde jetese, që janë mjaftueshëm të përshtatshëm për të përmbushur nevojat e tyre mendore dhe fizike. Qeveritë duhet të ndihmojnë familjet dhe kujdestarët që nuk mund t'i përballojnë ato, sidomos në lidhje me ushqimin, veshjet dhe strehimin.

28 **E DREJTA PËR ARSIMIM:** Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për arsimim fillor, i cili do të jetë falas. Vendet e pasura duhet të ndihmojnë vendet e varfra për të arritur këtë të drejtë. Në mënyrë që fëmijët të përfitojnë nga arsimimi, shkollat duhet të drejtohen në një mënyrë të rregullt – pa përdorimin e dhunës. Çdo lloj disiplinimi në shkollë, duhet të marrë në konsideratë dinjitetin njerëzor të fëmijëve. Si rezultat, qeveritë duhet të garantojnë që administratorët e shkollave i rishikojnë politikat e disiplinimit dhe zhdukin çdo praktikë disiplinimi që përdor dhunën fizike, mendore, abuzimin ose neglizhimin. Konventa i vë një rëndësi të madhe arsimimit. Të rinjtë duhet të inkurajohen që të arrijnë nivelet më të larta të arsimit për të cilat ata janë të aftë.

29 **QËLLIMET E ARSIMIMIT:** Arsimimi i fëmijëve duhet të zhvillojë në maksimum personalitetin, talentin dhe aftësitë e fëmijëve. Arsimimi duhet të inkurajojë fëmijët të respektojë të tjerët, të respektojnë të drejtat njerëzore dhe kulturat e tyre dhe të të tjerëve. Arsimimi duhet t'i ndihmojë fëmijët të mësojnë të jetojnë në paqe, të mbrojnë mjedisin dhe të respektojnë të tjerët. Fëmijët kanë një përgjegjësi të veçantë të respektojnë të drejtat e prindërve të tyre dhe arsimimi duhet të ketë si qëllim të zhvillojë respektin për vlerat dhe kulturën e prindërve të tyre. Konventa nuk trajton çështje të tilla si: uniformat shkollore, kodin e veshjes, këndimin e himnit kombëtar ose lutjeve në shkollë. Është detyra e qeverisë dhe drejtuesve të shkollave në çdo vend, që të vendosin nëse në kontekstin e shoqërisë së tyre dhe ligjeve ekzistuese, çështje të tilla kufizojnë të drejtat e mbrojtura nga Konventa.

30 **FËMIJËT E GRUPEVE MINORITARE/INDIGJENE:** Fëmijët e grupeve minoritare ose indigjene, kanë të drejtën të mësojnë dhe të praktikojnë kulturën e tyre, gjuhën dhe besimin fetar. Çdo njeri ka të drejtën për të praktikuar kulturën, gjuhën dhe besimin e tij/saj fetar. Konventa i thekson këtu këto të drejta, në rastet kur praktikat nuk ndahen [përdoren] nga pjesa më e madhe e individëve në vend.

31 **KOHA E LIRË, LOJA DHE KULTURA:** Fëmijët kanë të drejtën për të pushuar, luajtur dhe të marrin pjesë në një gamë të gjerë aktivitetesh kulturore, artistike dhe aktivitete të tjera çlodhëse.

32 **PUNA E FËMIJËVE:** Qeveria duhet t'i mbrojë fëmijët nga puna që është e rrezikshme ose mund të dëmtojë shëndetin ose arsimimin e tyre. Ndërsa Konventa mbron fëmijët nga puna e dëmshme shfrytëzuese, nuk ekziston asnjë dispozitë në të që i ndalon prindërit të presin nga fëmijët e tyre që të japin ndihmesë në shtëpi, në mënyra që janë të sigurta dhe të përshtatshme për moshën e tyre. Nëse fëmijët japin ndihmesën e tyre në biznesin apo fermën e familjes, punët që ata bëjnë duhet të jenë të sigurta dhe të përshtatshme me nivelin e tyre të zhvillimit dhe në përputhje me ligjet ndërkombëtare të punës. Puna e fëmijëve nuk duhet të vërë në rrezik asnjë nga të drejtat e tyre të tjera, përfshirë të drejtën për arsimim, për pushim apo lojë.

33 **ABUZIMI I DROGËS:** Qeveritë duhet të përdorin të gjitha mjetet e mundshme për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i drogave të dëmshme dhe nga përdorimi i tyre në tregtinë e drogës.

34 **SHFRYTËZIMI SEKSUAL:** Qeveritë duhet t'i mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit. Kjo dispozitë e konventës është çuar më tej nga Protokolli Fakultativ mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve.

35 **RRËMBIMI, SHITJA DHE TRAFIKIMI:** Qeveria duhet të marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar që fëmijët nuk rrëmbehen, shiten apo trafikohen. Kjo dispozitë e Konventës është çuar më tej nga Protokolli Fakultativ mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve.

36 **FORMAT E TJERA TË SHFRYTËZIMIT:** Fëmijët duhet të mbrohen nga çdo aktivitet që i shfrytëzon ata që mund të dëmtojë mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

37 **NDALIMI DHE NDËSHKIMI:** Askush nuk lejohet të ndëshkojë fëmijët në një formë mizore dhe të dëmshme. Fëmijët që thyejnë ligjin, nuk duhet të trajtohen në mënyrë mizore. Ata nuk duhet të mbahen në burgje me të rriturit, duhet të jenë në gjendje të jenë në kontakt me familjet e tyre dhe nuk duhet të dënohen me vdekje ose burgim të përjetshëm, pa iu dhënë mundësia e lirimit.

38 **LUFTA DHE KONFLIKTET E ARMATOSURA:** Qeveritë duhet të bëjnë çfarë është e mundur për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët që janë prekur nga lufta. Fëmijët nën moshën 15 vjeçare, nuk duhet të detyrohen ose të rekrutohen për të marrë pjesë në luftë, ose për t'iu bashkangjitur trupave të armatosura. Protokolli Fakultativ i Konventës mbi përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura, e zhvillon më tej këtë të drejtë, duke e ngritur moshën për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në konfliktet e armatosura në 18 vjeç dhe vendosjen e një rregulli për ndalimin e rekrutimit të detyruar për fëmijët nën moshën 18 vjeç.

39 **REHABILITIMI I FËMIJËVE VIKTIMA:** Fëmijët të cilët janë neglizhuar, abuzuar ose shfrytëzuar duhet të marrin ndihmë të veçantë për të rimarrë veten fizikisht dhe psikologjikisht dhe për t'u ri-integruar në shoqëri. Duhet t'i

kushtohet kujdes i veçantë kthimit të shëndetit, respektit për veten dhe dinjitetit të fëmijës.

40 **DREJTËSIA PËR TË RINJTË:** Fëmijët, të cilët janë akuzuar që kanë thyer ligjin, kanë të drejtën për ndihmë ligjore dhe trajtim të drejtë në një sistem drejtësie që respekton të drejtat e tyre. Qeveritë duhet të përcaktojnë një moshë minimale, poshtë të cilës fëmijët nuk mund të mbahen përgjegjës penalisht dhe të ofrojnë garanci minimale për drejtësinë dhe zgjidhjen e shpejtë të procedurave juridike dhe alternative.

41 **RESPEKTI PËR STANDARDET E LARTA KOMBËTARE:** Nëse ligjet e një vendi ofrojnë mbrojtje më të mirë se artikujt e kësaj Konvente për të drejtat e fëmijëve, këto ligje duhet të zbatohen (marrin përparësi).

42 **NJOHJA E TË DREJTAVE:** Qeveritë duhet t'i njohin të rriturit dhe fëmijët me Konventën. Të rriturit duhet të ndihmojnë, gjithashtu, fëmijët që të mësojnë mbi të drejtat e tyre. (Shihni gjithashtu **NENIN 4**.)

43–54 **ZBATIMI MASAVE:** Këto nene diskutojnë se si qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare si UNICEF-i duhet të punojnë për të garantuar se fëmijët janë të mbrojtur në të drejtat e tyre.

# 2 KDF – Qëllimet e edukimit[1]

KOMENT I PËRGJITHSHËM NR.1

## Objektivat e Edukimit[2]

**NENI 29 (1) (2001):** Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

1 Shtetet palë pranojnë se edukimi i fëmijës do të drejtohet në:

- **a** Zhvillimin e personalitetit, të talenteve, aftësive fizike dhe mendore të fëmijës për të arritur potencialin e tyre të plotë;
- **b** Zhvillimin e respektit të të drejtave njerëzore, lirive themelore dhe parimeve të parashtruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
- **c** Zhvillimin e respektit për prindërit e fëmijës, identitetin e tij/saj kulturor, gjuhën dhe vlerat, vlerat kombëtare të shtetit ku fëmija jeton, të shtetit të origjinës së tij/saj dhe për qytetërime të ndryshme nga i tij/saj;
- **d** Përgatitjen e fëmijës për jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, me frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësinë me të gjithë njerëzit, grupe etnike, kombëtarë dhe fetare dhe personat me origjinë indigjene.
- **e** Zhvillimin e respektit për mjedisin natyral.

**1** Shkurtimi për Konventën: KDF

**2** Rrethi. **E Përgjithshme CRC/GC/2001/1** (Komente të Përgjithshme); 17 Prill 2001; Origjinali: Anglisht

# SHTESË Komenti i përgjithshëm 1 (2001): Objektivat e edukimit

## Kuptimi i nenit 29 (1)

1 **NENI 29**, paragrafi 1 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, është i një rëndësie të madhe. Objektivi i edukimit që ai thekson, për çka është rënë dakord nga të gjitha shtetet palë, promovon, mbështet, përkrah dhe mbron vlerat thelbësore të Konventës: dinjitetin njerëzor të lindur të çdo fëmije dhe të drejtat të patjetërsueshme të tij/saj. Këto objektiva të theksuara në pesë nënparagrafet e nenit **29 (1a)**, janë të lidhur drejtpërdrejt me perceptimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të fëmijës, duke pasur parasysh nevojat e veçanta për zhvillimin e fëmijës dhe kapacitetet e ndryshme në zhvillim. Objektivat janë: zhvillimi i plotë i potencialit të fëmijës **(29 (1a))**, përfshirë dhe zhvillimin e respektit për të drejtat njerëzore **(29 (1b))**, ndjenjë të lartë identiteti dhe njohje të atësisë **(29 (1c))**, shoqërizimin e tij/saj dhe ndërveprimin me të tjerët **(29 (1d))** dhe me mjedisin **(29 (1a))**.

2 **NENI 29 (1)** jo vetëm që i shton një dimension cilësor të drejtës për arsimim të **NENIT 28**, që pasqyron të drejtën dhe dinjitetin e lindur të fëmijës, por, gjithashtu, ngulmon se nevoja për arsimim duhet të fokusohet te fëmija, t'i përshtatet moshës së tij, t'i forcojë besimin në vetvete, si dhe nënvizon nevojën që proceset mësimore të bazohen mbi parimet që shpallen. Arsimi për çka çdo fëmijë gëzon të drejtë, është ai i krijuar me synimin që t'i pajisë fëmijët me aftësitë për jetën, të fuqizojë kapacitetet e fëmijës asisoj, që ky i fundit të gëzojë të gjitha të drejtat njerëzore dhe të përkrahë një kulturë të mbushur me vlera të së drejtës njerëzore. Qëllimi është të fuqizojë fëmijën duke zhvilluar aftësitë e tij/saj, të mësuarit dhe kapacitete të tjera, dinjitetin njerëzor, vetëvlerësimin dhe vetëbesimin. Në këtë kontekst, "arsimimi" shkon përtej shkollimit formal, ai përfshin gamën e gjerë të eksperiencave në jetë dhe proceset e të mësuarit, që e mundësojnë fëmijën të zhvillojë në mënyrë individuale dhe kolektive, personalitetin, talentet dhe aftësitë, si dhe të gëzojë një jetë të plotë dhe të lumtur në shoqëri.

3 E drejta e fëmijës për arsimim, nuk është thjesht çështje mundësie **(NENI 28)**, por edhe përmbajtjeje. Një arsimim me rrënjë të forta në vlerat e nenit **29 (1)**, është për çdo fëmijë një mjet i domosdoshëm që ai/ajo të kenë një jetë të balancuar, t'i përgjigjet sfidave për të drejtat njerëzore, që i shoqërojnë për një periudhë thelbësore të jetës së tyre, të udhëhequra nga globalizmi, teknologjitë e reja dhe fenomenet e ngjashme. Këto sfida përfshijnë tensionin midis, ndër të tjerash, konsideratave globale dhe lokale, individuale dhe kolektive, tradicionale dhe moderne, afatgjata dhe afatshkurtra, konkurrencës dhe mundësive të barabarta, zgjerimin e njohurive dhe aftësive për t'i asimiluar ato, dhe midis shpirtërores e materials. **(2)** Prapë se prapë, në programet kombëtare, ndërkombëtare dhe në politikat mbi arsimimin, që kanë vërtet rëndësi, elementet e përmendur në nenin **29 (1)**, duket sikur mungojnë të shumtën e kohës apo shfaqen vetëm si kofini pas të vjelave.

4 **NENI 29 (1)** konstaton se shtetet palë bien dakord se arsimimi duhet të udhëhiqet nga një numër i madh vlerash. Kjo marrëveshje kapërcen kufijtë e fesë, kombit dhe kulturës së ndërtuar në shumë anë të botës. Në shikim të parë, disa nga vlerat e shumta të përmendura në nenin **29 (1)**, duken si të jenë në konflikt me njëra-tjetrën në situata të caktuara. Prandaj, përpjekjet për të përkrahur mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis njerëzve, së cilës i referohet paragrafi **(1d)**, jo gjithmonë mund të jenë në përputhje me politikat e krijuara, në përputhje me paragrafin **(1c)**, për të zhvilluar respektin e fëmijës për identitetin e tij kulturor, gjuhën dhe vlerat, vlerat e kombit ku fëmija jeton, të kombit prej nga ai/ajo mund të ketë origjinën, dhe për qytetërime të ndryshme nga i tij. Në fakt, një pjesë e rëndësisë së kësaj dispozite, gjendet pikërisht në njohjen e nevojave për një metodë të balancuar të arsimimit, që të arrijë sukses në pajtimin e vlerave të ndryshme, me anë të dialogut dhe respektit për diversitetin. Për më tepër, fëmijët janë në gjendje të luajnë një rol unik për eliminimin e shumë ndasive, që i kanë ndarë historikisht grupet e njerëzve nga njëri-tjetri.

# Funksionet e nenit 29 (1)

5 **NENI 29 (1)** është më shumë se një inventar apo një listë objektivash të ndryshme, që duhet t'i përmbushë arsimimi. Brenda kontekstit të përgjithshëm të Konventës, ai shërben për të nënvizuar, ndër të tjera, dimensionet e mëposhtme.

6 Së pari, ai thekson natyrën e domosdoshme të ndërlidhur të dispozitave të Konventës. Ai nënvizon, përforcon, integron dhe plotëson një shumëllojshmëri dispozitash të tjera dhe nuk mund të kuptohet plotësisht i ndarë prej tyre. Veç parimeve të përgjithshme të Konventës - mosdiskriminimi **(NENI 2)**, interesi më i lartë i fëmijës **(NENI 3)**, e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit **(NENI 6)** dhe e drejta për të shprehur mendime, e që këto mendime të dëgjohen **(NENI 12)** - mund të përmenden edhe shumë dispozita të tjera, por pa u kufizuar në to, si, për shembull, të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve **(NENI 5 DHE 18)**, liria e të shprehurit **(NENI 13)**, liria e mendimit **(NENI 14)**, e drejta për informacion **(NENI 17)**, të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara **(NENI 23)**, e drejta për edukim shëndetësor **(NENI 24)**, e drejta për arsimim **(NENI 28)** dhe të drejtat kulturor dhe gjuhësore të fëmijëve që u përkasin grupeve minoritare **(NENI 30)**.

7 Të drejtat e fëmijëve nuk janë vlera të shkëputura apo të izoluara e pa përmbajtje, por ekzistojnë brenda një kuadri etik më të gjerë, për çka është folur pjesërisht në **NENIN 29 (1)** në parathënien e Konventës. Shumë prej kritikave që i janë bërë Konventës, gjejnë përgjigje në mënyrë specifike në këtë dispozitë. Kështu, për shembull, ky nen nënvizon rëndësinë e respektit për prindërit, të nevojës për t'i parë të drejtat në kuadrin e tyre të gjerë, etik, moral, shpirtëror, kulturore, apo social dhe të faktit se shumica e të drejtave të fëmijës, duke mos qenë të imponuara, janë ngulitur në vlerat e komunitetit vendas.

8 Së dyti, neni i jep rëndësi procesit, që promovon të drejtën e arsimimit. Prandaj, përpjekjet për të përkrahur gëzimin e të drejtave të tjera, nuk duhen nënvlerësuar duhen përforcuar me nga vlerat e procesit arsimor. Kjo nuk përfshin vetëm përmbajtjen e programit, por edhe proceset arsimore, metodat pedagogjike dhe mjedisin ku zhvillohet arsimimi, qoftë shtëpia, shkolla, apo ndonjë vend tjetër.

Fëmijët nuk i humbasin të drejtat e tyre njerëzore ngaqë kapërcejnë portën e shkollës. Prandaj arsimimi duhet të jepet në një mënyrë të atillë që të respektojë dinjitetin e lindur të fëmijës dhe i jep mundësinë fëmijës të shprehë këndvështrimin e tij lirisht, në përputhje me **NENIN 12 (1)** dhe të marrë pjesë në jetën shkollore. Gjithashtu, arsimimi duhet të jepet i tillë që respektojë kufijtë e përcaktuar të disiplinës, të pasqyruar në **NENIN 28 (2)** dhe mbështet mospërdorimin e dhunës në shkollë. Komiteti ka bërë të qartë në mënyrë të përsëritur në vëzhgimet e tij të fundit, se përdorimi i ndëshkimit fizik, nuk respekton dinjitetin e lindur të fëmijës dhe as kufijtë e përcaktuar të disiplinës së shkollës. Përputhja me vlerat e përmendura në **NENIN 29 (1)**, kërkon qartë që shkolla të jetë një mjedis miqësor për fëmijën në kuptimin e plotë të fjalës dhe se ato të jenë në përputhje me dinjitetin e fëmijës. Pjesëmarrja e fëmijëve në jetën shkollore, krijimi i komuniteteve të shkollës dhe këshillave të nxënësve, arsimimi dhe këshillimi i barabartë si dhe përkrahja e përfshirjes së nxënësve në procedurat disiplinore të shkollës, duhen inkurajuar si pjesë e procesit të të mësuarit dhe plotësimit të të drejtave.

**9** Së treti, ndërsa **NENI 28** fokusohet në detyrimet e shteteve palë në lidhje me krijimin e sistemeve arsimore dhe në sigurimin e të drejtës për t'u arsimuar, **NENI 29 (1)** nënvizon të drejtën individuale dhe subjektive për një arsimim cilësor. Në pajtim me theksin e Konventës mbi rëndësinë për të vepruar në interesin më të mirë të fëmijës, ky nen jep mesazhin e një arsimi të fokusuar te fëmija, pasi objektivi kryesor i arsimimit, është zhvillimi i personalitetit individual të fëmijës, talenteve dhe aftësive, duke pranuar faktin se çdo fëmijë ka karakteristika, interesa dhe aftësi, si dhe nevoja mësimore unike. **(3)** Për rrjedhim, programi duhet të ketë lidhje me kontekstin social, kulturor, mjedisor dhe ekonomik të fëmijës, të nevojave të tij/saj aktuale dhe të ardhshme dhe të ketë parasysh kapacitetet në zhvillimin e fëmijës; metodat mësimore duhet t'i përshtaten nevojave të veçanta të fëmijëve të ndryshëm. Gjithashtu, arsimimi duhet të synojë që çdo fëmijë të fitojë shprehitë thelbësore të jetës dhe që asnjë fëmijë të mos largohet nga shkolla pa u mësuar të përballet me sfidat që ai/ajo mund të hasë në jetë.

Aftësitë bazë nuk përfshijnë vetëm shkrim, këndim dhe shifra, por edhe njohuritë për jetën, si aftësia për marrë vendime të balancuara,

të mos zgjidhin konfliktet në mënyrë të dhunshme dhe të bëjnë një jetë të shëndetshme, të kenë marrëdhënie të mira shoqërore dhe të ndiejnë përgjegjësi, të kenë mendime kritike si dhe aftësi të tjera, që u japin fëmijëve mjetin e duhur për të ndjekur zgjedhjet e tyre në jetë.

**10** Diskriminimi, për çdo arsye qoftë, siç shënohet në **NENIN 2** të Konventës, i dukshëm apo i fshehur, fyen dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe është në gjendje të luhasë apo dhe të shkatërrojë kapacitetin e fëmijës për të përfituar nga mundësitë arsimore. Ndërkohë që mohimi i të drejtës së fëmijës për arsimim, është kryesisht një çështje që lidhet me **NENIN 28** të Konventës, një efekt i ngjashëm mund të shkaktohet nga mosrespektimi i parimeve që parashikohen në **NENIN 29 (1)**. Le të marrim një shembull ekstrem, diskriminimi gjinor mund të thellohet nga praktika të tilla si për shembull, një program mësimor që nuk është në pajtim me parimet e barazisë gjinore, nga rregulla që kufizojnë përfitimet që vajzat mund të marrin nga mundësitë arsimore që iu ofrohen, si dhe nga mjediset e pasigurta dhe armiqësore, që dekurajojnë pjesëmarrjen e vajzave në to. Gjithashtu, diskriminimi kundër fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore, depërton në shumë sisteme formale arsimore dhe në shumë mjedise joformale, përfshirë edhe shtëpinë. **(4)** Edhe fëmijët me HIV/AIDS janë shumë të diskriminuar në të dyja këto kontekste **(5)**. Të gjitha këto praktika diskriminuese, janë në kontradiktë të drejtpërdrejtë me kërkesat e **NENIT 29 (1)** (a), që arsimimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të personalitetit, talentit dhe aftësive fizike dhe mendore të fëmijës.

**11** Gjithashtu, komiteti dëshiron të nënvizojë lidhjet midis **NENIT 29 (1)** dhe luftës kundër racizmit, diskriminimit racor, ksenofobisë dhe intolerancës. Racizmi dhe fenomenet e lidhura me të, lulëzojnë atje ku ka padije, frikë të pabazë nga ndasi racore, etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore, si dhe forma të tjera ndasish, paragjykime, ose mësimdhënie apo përhapje të vlerave të shtrembëruara. Një antidodë e besueshme dhe e qëndrueshme kundër këtyre problemeve, është të arsimuarit, që përkrah mirëkuptimin dhe vlerësimin e vlerave të pasqyruara në **NENIN 29 (1)**, përfshirë dhe respektin për dallimet dhe që sfidon të gjitha format e diskriminimit dhe paragjykimit. Pra, të arsimuarit duhet parë si një nga përparësitë kryesore në të gjitha aktivitetet kundër të këqijave të racizmit dhe fenomeneve të ngja-

shme. Theksi duhet vënë, gjithashtu, mbi rëndësinë e të mësuarit rreth racizmit, se si është praktikuar ai historikisht dhe, veçanërisht, si shfaqet apo është shfaqur në komunitete të veçanta. Sjellja raciste nuk është diçka e kryer vetëm nga "të tjerët". Pikërisht për këtë arsye, është e rëndësishme të fokusohesh në komunitetin e vetë fëmijës kur u mëson të drejtat njerëzore dhe fëminore dhe parimin e mosdiskriminimit. Kjo lloj mësimdhënie, mund të kontribuojë efekshëm në parandalimin dhe eliminimin e racizmit, diskriminimit etnik, ksenofobisë dhe intolerancës që lidhet me to.

**12** Së katërti, **NENI 29 (1)** këmbëngul për një metodë të plotë arsimimi, që garanton se mundësitë arsimore ekzistuese pasqyrojnë një balancë të saktë mes promovimit të formave fizike, mendore, shpirtërore dhe emocionale të arsimimit, të dimensioneve intelektuale, sociale dhe praktike, si dhe fëmijërisë dhe formave jetësore. Objektivi kryesor i arsimimit, është të rrisë aftësitë dhe mundësitë e fëmijës për të marrë pjesë plotësisht dhe përgjegjshëm në një shoqëri të lirë. Duhet theksuar se lloji i mësimdhënies, që fokusohet fillimisht në mbledhjen e njohurive, nxitjes së konkurrencës dhe që i ngarkon fëmijët me një barrë pune të tepërt, mund të pengojë zhvillimin harmonik të fëmijës për arritjen e plotë të aftësive dhe talenteve të tij/saj. Arsimimi duhet të jetë miqësor, ta frymëzojë e ta motivojë fëmijën. Shkollat duhet të krijojnë një atmosferë humane dhe t'u krijojnë fëmijëve mundësitë që ata të zhvillohen sipas kapaciteteve të tyre.

**13** Së pesti, thekson nevojën që arsimimi të ngrihet dhe të ofrohet në një mënyrë të atillë, që të përkrahë dhe përforcojë gamën e vlerave specifike etike të parashtruara në Konventë, përfshirë dhe edukimin për paqe, tolerancë dhe respekt për mjedisin natyror, të plotë dhe të integruar. Kjo mund të kërkojë një metodë shumëdisiplinore. Nxitja dhe përforcimi i vlerave të **NENIT 29 (1)**, nuk janë të domosdoshme vetëm për shkak të problemeve diku tjetër, por duhet të fokusohen në problemet brenda komunitetit të fëmijës. Në këtë këndvështrim, edukimi duhet të bëhet në familje, por shkollat dhe komunitetet mund të luajnë një rol të rëndësishëm.

Për shembull, për zhvillimin e respektit për mjedisin natyror, edukimi duhet të lidhë çështjet e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm me çështjet social-ekonomike, social-kulturore dhe demografike.

Po ashtu, respekti për mjedisin, duhet t'i mësohet fëmijës në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet, duke përfshirë si problemet kombëtare dhe ato ndërkombëtare dhe duke e angazhuar fëmijën aktivisht në projektet lokale, rajonale dhe globale të mjedisit.

14 Së gjashti, reflekton, rolin jetësor të mundësive të duhura të edukimit, në përkrahje të të gjithë të drejtave të tjera njerëzore dhe kuptimit të pandashmërisë së tyre. Kapaciteti i një fëmije për të marrë pjesë plotësisht dhe me përgjegjësi në një shoqëri të lirë, mund të dëmtohet apo luhatet jo vetëm nga mohimi i së drejtës për arsimim, por edhe nga mossuksesi për të kuptuar vlerat e njohura nga ky nen.

## Edukimi i të drejtave të njeriut

15 **NENI 29 (1)** mund të shihet gjithashtu, si guri i themelit për programe të ndryshme për edukimin e të drejtave të njeriut, përmendur në Konferencën Botërore mbi të Drejtat e Njeriut, mbajtur në Vjenë më 1993 dhe mbështetur nga organizmat ndërkombëtare. Pavarësisht, të drejtave të fëmijëve nuk u është dhënë gjithmonë rëndësia që kërkojnë në kontekstin e aktiviteteve të tilla. Edukimi i të drejtave të njeriut, duhet të sigurojë informacionin që ka të bëjë me përmbajtjen e traktateve mbi të drejtat njerëzore. Fëmijët duhet të mësojnë rreth të drejtave të njeriut, duke parë të zbatohen në praktikë standardet e të drejtave të njeriut, qoftë në shtëpi, në shkollë apo në komunitet. Edukimi mbi të drejtat e njeriut duhet të jetë gjithëpërfshirës, një proces i gjatë dhe të fillojë me pasqyrimin e vlerave njerëzore në jetën e përditshme dhe në përvojat e fëmijës.

16 Vlerat e përmendura në **NENIN 29 (1)**, janë të përshtatshme si për fëmijët që jetojnë në zonat e paqes, ashtu edhe për ata që jetojnë në situata konflikti apo emergjence. Siç shkruhet edhe në Strukturën për Aksion të Dakar-it, në kontekstin e edukimit është e rëndësishme që sistemet arsimore të prekura nga konflikti, katastrofat natyrore dhe paqëndrueshmëria, të zhvillojnë programe mësimore të atilla që përkrahin mirëkuptimin e ndërsjellët, paqen, tolerancën dhe që ndihmojnë të parandalohen dhuna dhe konflikti. Edukimi rreth ligjeve ndërkombëtare humanitare, përbën, gjithashtu, një dimension përpjekjesh, shpesh të shpërfillur, për ta bërë sa më veprues **NENIN 29 (1)**.

## Zbatimi, monitorimi dhe të analizuarit

17 Objektivat dhe vlerat e pasqyruara në këtë nen, janë shprehur në terma të përgjithshëm dhe përfshirja e tyre varion shumë më gjerë. Mesa duket, kjo i shtyu shumë shtete palë të pandehin se është e panevojshme apo dhe e papërshtatshme të sigurohen që parimet e lidhura me të, të pasqyrohen në direktivat legjislative apo administrative. Ky supozim, është i papërligjur. Në mungesë të ndonjë nënshkrimi formal të veçantë në ligjin apo politikën kombëtare, vështirë se do të zbatohen parimet e duhura, për të formuar saktë politikat arsimore. Për këtë arsye, komiteti i bën thirrje shteteve palë të ndërmarrin hapat e duhur, për t'i përfshirë formalisht këto parime në politikat e tyre arsimore dhe në legjislacion në të gjitha nivelet.

18 Përkrahja efikase e **NENIT 29 (1)** kërkon ripunimin rrënjësor të programit mësimor për të përfshirë qëllimet e ndryshme të edukimit, rishikimin sistematik të librave shkollorë, si dhe të materialeve të tjera mësimore, teknologjive e politikave shkollore. Janë të papërshtatshme metodat, që nuk bëjnë gjë tjetër, veçse kopjojnë qëllimet dhe vlerat e nenit në sistemin ekzistues, pa nxitur ndryshime më të thella. Vlerat aktuale nuk mund të integrohen me efikasitet dhe për rrjedhojë të bëhen pjesë e një programi më të gjerë, nëse njerëzit që duhet t'i transmetojnë, përkrahin, mësojnë ato, nuk i ilustrojnë me sa më shumë shembuj të jetë e mundur, vlerat që ata vetë i shikojnë si të rëndësishme. Skemat e trajnimit para dhe gjatë shërbimit, që përkrahin parimet e pasqyruara në **NENIN 29 (1)**, janë të rëndësishme për mësuesit, administratorët arsimorë, si edhe personat e tjerë të përfshirë në edukimin e fëmijëve. Është e rëndësishme që metodat mësimore të përdorura në shkollë, të pasqyrojnë frymën dhe filozofinë arsimore të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe objektivat e arsimimit të poshtëshënuara në **NENIN 29 (1)**.

19 Veç kësaj, vetë mjedisi shkollor duhet të reflektojë lirinë dhe frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë së sekseve dhe miqësisë midis të gjithë njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare dhe personave me origjinë indigjene të përmendur në **NENIN 29 (1)** dhe **(d)**. Një shkollë që pranon "të fortët" dhe lejon të ndodhin praktika të tjera të dhunshme dhe përjashtuese, nuk është një shkollë që për-

mbush kërkesat e **NENIT 29 (1)**. Termi "edukimi mbi të drejtat e njeriut", përdoret shpesh i thjeshtëzuar në ngjyrimin e tij. Ajo që nevojitet, përveç edukimit formal të të drejtave të njeriut, është përkrahja e vlerave dhe politikave të favorshme për të drejtat e njeriut, jo vetëm në shkollë dhe universitet, por dhe në gjirin e një komunitet më të gjerë.

**20** Në terma të përgjithshme, nismat e ndryshme që iu kërkohen shteteve palë të ndërmarrin në zbatim të detyrimeve të tyre ndaj Konventës, nuk do të rrënjosen sa duhet në rast se propagandohet mjaftueshëm vetë teksti i Konventës, në përputhje me dispozitat e **NENIT 42**. Kjo gjithashtu, do të lehtësojë rolin e fëmijëve si përkrahës dhe mbrojtës të të drejtave të fëmijëve në jetën e përditshme. Që të mundësohet një propagandim më i gjerë, shtetet palë duhet të raportojnë mbi masat e marra për arritjen e këtij objektivi dhe Zyra e Komisionerit të lartë për të Drejtat e Njeriut, duhet të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës të dhënash, me versionet e gjuhës në të cilat është botuar Konventa.

**21** Media, në kuptimin e gjerë, luan një rol të rëndësishëm, si në përkrahjen e vlerave dhe objektivave të pasqyruar në **NENIN 29 (1)**, ashtu dhe duke garantuar se aktivitetet e tyre nuk minojnë përpjekjet e të tjerëve për t'i çuar më tej këto objektiva. Qeveritë janë të detyruara nga Konventa, në vijim të **NENIT 17 (a)**, të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të "nxitur masmedian të shpërndajë informacionin dhe materialet për përfitimet kulturore dhe sociale të fëmijës".

**22** Komiteti i bën thirrje shteteve palë t'i kushtojnë më shumë vëmendje arsimimit, si një proces dinamik dhe në gjetjen e rrugëve për të matur ndryshimet në kohë në lidhje me **NENIN 29 (1)**. Çdo fëmijë ka të drejtën të marrë një arsimim të një cilësie të mirë, çka kërkon në shkëmbim përqendrim në cilësinë e mjedisit mësimor, proceset dhe materialet e mësimdhënies, të mësuarit dhe nivelin e të mësuarit. Komiteti thekson rëndësinë e sondazheve, që mund të jenë një mundësi për të vlerësuar ecurinë, bazuar në marrjen parasysh të këndvështrimit të gjithë aktorëve pjesëmarrës në proces, përfshirë dhe fëmijët në shkollë apo jashtë saj, mësuesit dhe udhëheqësit e rinisë, prindërit, administratorët arsimorë dhe supervizorët. Në lidhje me këtë, komiteti

thekson rolin e monitorimit të nivelit kombëtar, që përpiqet të sigurojë se fëmijët, prindërit dhe mësuesit, kontribuojnë në marrjen e vendimeve që lidhen me arsimimin.

**23** Komiteti u bën thirrje shteteve palë të zhvillojnë një plan gjithëpërfshirës kombëtar, për të përkrahur dhe monitoruar përmbushjen e objektivave të shënuara në **NENIN 29 (1)**. Nëse ky plan hartohet në një kontekst më të gjerë se plani i veprimit kombëtar për fëmijët, një plan kombëtar veprimi për të drejtat e njeriut ose një strategji kombëtare për edukimin e të drejtave të njeriut, qeveria duhet të sigurohet se aty trajtohen të gjitha çështjet e përmendura në **NENIN 29 (1)** dhe nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijës. Komiteti nxit Kombet e Bashkuara dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë të përfshirë në politikat arsimore dhe edukimin për të drejtat e njeriut, të kërkojnë koordinim më të mirë që të rrisin kështu efektshmërinë e zbatimit të **NENIT 29 (1)**.

**24** Hartimi dhe zbatimi i programeve për të përkrahur vlerat e pasqyruara në këtë nen, duhet të bëhen pjesë e përgjigjjes standarde të qeverisë në të gjitha situatat ku kanë ndodhur shkelje të të drejtave të njeriut. Kështu, për shembull, atje ku ndodhin incidente serioze racizmi, diskriminimi racial, ksenofobie dhe intoleranca të ngjashme, që përfshijnë ata nën **NENIN 18**, mund të nënkuptohet se qeveria nuk ka bërë atë që duhet për përkrahjen e vlerave të pasqyruara në përgjithësi në Konventë, dhe në veçanti, në **NENIN 29 (1)**. Prandaj, në mbështetje të **NENIT 29**, duhen marrë masa shtesë, ku përfshihet studimi mbi përshtatjen e teknikave të mundshme arsimore, që mund të ndikojnë pozitivisht në përmbushjen e të drejtave të përmendura në Konventë.

**25** Shtetet palë duhet të marrin parasysh përcaktimin e një procedure rishikimi, që i përgjigjet ankesave se politikat apo praktikat ekzistuese, nuk janë në pajtim me **NENIN 29 (1)**. Të tilla procedura nuk kanë domosdoshmërisht nevojë për krijimin e organizmave të reja ligjore, administrative apo arsimore. Ato mund t'iu kalohen institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut ose organizmave ekzistuese administrative. Komiteti i kërkon çdo shteti palë, që kur të raportojë mbi këtë nen, të identifikojë mundësitë e vërteta që ekzistojnë në nivel lokal ose kombëtar, që të bëjnë kështu një rishikim të metodave

ekzistuese, që pretendohet se nuk janë në pajtim me Konventën. Informacioni duhet të tregojë se si mund të ndërmerren rishikime të tilla dhe sa procedura të tilla janë ndërmarrë gjatë kohës së raportimit.

**26** Që të mund të fokusohet sa më mirë procesi i shqyrtimit të raporteve të shteteve palë që kanë të bëjnë me **NENIN 29 (1)** dhe në përputhje me kërkesat e **NENIT 44**, se raportet duhet të evidentojnë faktorët dhe vështirësitë, Komiteti i kërkon çdo shteti palë të tregojë me detaje në raportet e tij periodike, se çfarë konsideron ai si prioritetin më të rëndësishëm në juridiksionin e tij, që kërkon më shumë përpjekje për të përkrahur vlerat e pasqyruara në këtë dispozitë. Gjithashtu, i kërkon të nënvizojnë programin e aktiviteteve që propozon të kryhen gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, për të zgjidhur problemet e identifikuara.

**27** Komiteti u bën thirrje agjencive, organizmave dhe organeve të tjera kompetente të Kombeve të Bashkuara, roli i së cilave është nënvizuar në **NENIN 45** të Konventës, për të kontribuar në mënyrë më aktive dhe sistematike në punën e Komitetit në lidhje me **NENIN 29 (1)**.

**28** Zbatimi i planeve të veprimit gjithëpërfshirëse, kombëtare në përputhje me **NENIN 29 (1)**, do të kërkojë burime njerëzore dhe financiare që duhet të jenë të disponueshme deri në maksimumin e mundshëm në përputhje me **NENIN 4**. Prandaj, komiteti konsideron se kufizimet në burime, nuk mund të jenë një justifikim për dështimin e shtetit palë për të ndërmarrë ndonjë apo shumë masa që u kërkohen. Në këtë kontekst dhe në dritën e detyrimeve të shteteve palë për të promovuar dhe inkurajuar bashkëpunim ndërkombëtar, si në terma të përgjithshëm **(NENI 4 DHE 45 I KONVENTËS)** dhe në çështje lidhur me edukimin **(NENI. 28 (3))**, Komiteti nxit shtetet palë të ofrojnë bashkëpunim konstruktiv, për të siguruar që programet e tyre të hartohen në bazë të parimeve të **NENIT 29 (1)**.

# 3 Vetëvlerësimi i shkollës

Ky instrument vetëvlerësimi është një mjet ideal për të matur se sa larg (apo pranë!) përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e fëmijës, është shkolla juaj, dhe ku ka nevojë për përmirësim.

Ky material është përshtatur nga manuali "Të ruajmë fëmijët" [1], për t'u përdorur si instrument vlerësimi i punës së shkollës për mbrojtjen e fëmijëve.

**Përdorimi i pikave të kontrollit**

Pyetjet kontrolluese të mëposhtme, janë hartuar për të parashtruar kërkesat minimale (kriteret) që të gjitha shkollat e angazhuara në mbrojtje të fëmijëve, duhet të përpiqen t'i përmbushin. Megjithatë, në varësi të kontekstit, mjedisit dhe kushteve ku ju punoni, disa prej pikave mund t'ju duken më të përshtatshme se të tjerat. Instrumenti i vetëvlerësimit do të shërbejë si një udhëzues i dobishëm dhe, nëse dëshironi, ju mund të fshini ose shtoni kritere për të garantuar lidhjen me situatën tuaj të veçantë. (Struktura e vetëvlerësimit pranon kritere shtesë).

Përpara se të filloni, merrni një kopje të pyetësorit, vini datën dhe më pas ndiqni hapat e poshtëshënuara. Mund të mbani një kopje të këtij pyetësori të plotësuar, që më vonë të mund të analizoni ecurinë tuaj (të paktën një herë në dy vjet).

Instrumenti i vetëvlerësimit kërkon që ju të mendoni për gjashtë fusha të ndryshme në shkollën tuaj:

1. fëmijët dhe shkolla,
2. politikat dhe procedurat,
3. parandalimi i dëmtimit te fëmijët,
4. zbatimi dhe trajnimi,
5. informimi dhe komunikimi,
6. monitorimi dhe analizimi.

1 www.keepingchildrensafe.org.uk

# Përgjigjuni duke shënuar në kutinë A, B apo C

Ka gjashtë formulime/standarde brenda secilës fushë. Lexoni çdo formulim dhe vendosni nëse është:

- **a EKZISTON,**
- **b EKZISTON PJESËRISHT,**
- **c NUK EKZISTON.**

| **FËMIJËT DHE SHKOLLA** | **A** | **B** | **C** |
|---|---|---|---|
| **1** Shkolla i ka shumë të qarta përgjegjësitë e veta për të mbrojtur fëmijët dhe ia bën këtë të ditur të gjithë atyre që kanë kontakt me të. | | | |
| **2** Mënyra se si personeli mësimor dhe përfaqësuesit e tjerë sillen me fëmijët, tregon se janë të angazhuar t'i mbrojnë fëmijët nga abuzimi. | | | |
| **3** Ka mjaft njohuri për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KKBDF) apo për instrumentet e tjerë për të drejtat e fëmijës dhe kjo shikohet si baza për mbrojtjen e fëmijës në shkollë. | | | |
| **4** Drejtori i shkollës, SMF-të si dhe mësuesit kujdestarë, sigurojnë që zëri i fëmijëve dëgjohet, se merret mendimi i tyre dhe se respektohen të drejtat e tyre. | | | |
| **5** Shkolla bën të qartë se të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për t'u mbrojtur. | | | |
| **6** Shkolla edukon te fëmijët sjellje që nuk janë të dhunshme dhe nuk ulin apo poshtërojnë fëmijët. | | | |

# Aneksi 3

| POLITIKA DHE PROCEDURA QË NDIHMOJNË PËR TË MBROJTUR FËMIJËT | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **1** Shkolla ka një politikë të shkruar për mbrojtjen e fëmijëve ose ka rregulla të qarta për të siguruar që fëmijët të mbahen larg dëmtimeve. | | | |
| **2** Politikat apo rregullat miratohen dhe nënshkruhen nga organet drejtuese përkatëse. | | | |
| **3** Politikat dhe rregullat duhet të ndiqen nga të gjithë. | | | |
| **4** Ekzistojnë procedura të qarta që japin udhëzime për veprimet që duhen ndërmarrë hap pas hapi, nëse lindin shqetësime për sigurinë ose mirëqenien e fëmijës. | | | |
| **5** Ka një specialist të caktuar për mbrojtjen e fëmijës me rol dhe përgjegjësi të qartë. | | | |
| **6** Procedurat për mbrojtjen e fëmijës marrin gjithashtu në konsideratë rrethanat lokale. | | | |

| PARANDALIMI I DËMTIMIT TË FËMIJËVE | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **1** Ka politika, procedura apo mënyra të miratuara për rekrutimin e personelit të shkollës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për të punuar me fëmijët, duke përfshirë ku të jetë e mundur, verifikimet në polici dhe gjykatë. | | | |
| **2** Ekzistojnë udhëzime të shkruara për sjelljen ose mënyra që i tregojnë personelit mësimor dhe përfaqësuesve të tjerë se cila sjellje është e pranueshme dhe cila e papranueshme, sidomos kur kanë të bëjnë me fëmijët. | | | |
| **3** Pasojat e shkeljes së udhëzimeve mbi sjelljen, janë të qarta dhe të lidhura me procedurat disiplinore të shkollës. | | | |
| **4** Ekzistojnë udhëzime mbi përdorimin siç duhet të teknologjisë, si interneti, faqet e internetit, aparatet dixhitale etj, për t'u siguruar që fëmijët nuk janë në rrezik. | | | |

| PARANDALIMI I DËMTIMIT TË FËMIJËVE | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **5** Aty ku ka përgjegjësi direkte për të drejtuar/organizuar aktivitete, përfshirë dhe kujdesin në mjedise rezidenciale, fëmijët mbikëqyren dhe janë të mbrojtur gjatë gjithë kohës. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **6** Ka mënyra të publikuara mirë ku personeli mësimor/përfaqësuesit mund të shfaqin shqetësimet e tyre, qoftë dhe në mënyrë të fshehtë po ta lypë nevoja, për sjelljen e papranueshme të pjesëtarëve të tjerë të stafit ose përfaqësuesve të shkollës. | ◌ | ◌ | ◌ |

| ZBATIMI DHE TRAJNIMI | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **1** Ka udhëzime të qarta për personelin mësimor, partnerët dhe organizatat e tjera (përfshirë dhe policinë në shkolla) se si të mbrohen fëmijët. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **2** Mbrojtja e fëmijëve duhet zbatuar në mënyra që respektojnë kulturën, por pa kryer veprime që cënojnë fëmijët. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **3** Ekziston një plan i shkruar që tregon hapat që duhen ndërmarrë për të mbrojtur fëmijët. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **4** Të gjithë anëtarët e personelit dhe vullnetarët trajnohen për mbrojtjen e fëmijëve kur ata vijnë në shkollë, ku përfshihen prezantimi i politikave dhe procedurave për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë dhe firmosja e formularit të deklaratës. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **5** Të gjithë anëtarëve të personelit dhe përfaqësuesve të tjerë u jepet mundësia të mësojnë se si të njohin dhe si t'iu përgjigjen problemeve të abuzimit dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës. | ◌ | ◌ | ◌ |
| **6** Është punuar me të gjithë partnerët për të miratuar detyra praktike të bazuara në këto standarde. | ◌ | ◌ | ◌ |

# Aneksi 3

| INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **1** Fëmijët janë ndërgjegjësuar për të drejtën që kanë për t'u mbrojtur nga abuzimi. | | | |
| **2** Kushdo në shkollë e di se cili anëtar i personelit ka përgjegjësi të posaçme për të mbrojtur fëmijët dhe se si ta kontaktojë atë. | | | |
| **3** Disponohen të dhëna për të kontaktuar institucionet vendore për mbrojtjen e fëmijëve, strehët për fëmijët, autoritetet kombëtare dhe urgjencat e shërbimit mjekësor. | | | |
| **4** Fëmijëve u jepet informacion se ku të drejtohen për ndihmë dhe këshillim në lidhje me abuzimin, ngacmimet dhe zënkat. | | | |
| **5** Krijohen kontaktet e nevojshme në dhe/ose nivel lokal me organizmat e tjera përkatëse për mbrojtjen/mirëqenien e fëmijëve. | | | |
| **6** Anëtarët e personelit me përgjegjësi të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve, kanë të drejtën për këshillime të specializuara, mbështetje dhe informacion. | | | |

| MONITORIMI DHE ANALIZIMI | A | B | C |
|---|---|---|---|
| **1** Ekzistojnë rregulla për të monitoruar, nëse masat e mara në shkollë për mbrojtjen e fëmijëve janë në përputhje me standartet. | | | |
| **2** Janë ndërmarrë hapa për të pyetur rregullisht fëmijët, mësuesit dhe prindërit/kujdestarët për mendimet e tyre mbi politikat dhe praktikat që synojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe vlefshmërinë e tyre. | | | |
| **3** Shkolla shfrytëzon përvojën e punës në mbrojtje të fëmijëve për të ndikuar në zhvillimin e politikave dhe të praktikave. | | | |
| **4** Të gjithë incidentet, deklaratat për abuzim dhe ankesat, dokumentohen dhe monitorohen sipas sistemit të menaxhimit të çështjeve për mbrojtjen e fëmijëve. | | | |
| **5** Politikat dhe praktikat rishikohen në intervale të rregullta, idealisht të paktën çdo tre vjet, si dhe bëhen vlerësime të brendshme dhe të jashtme. | | | |
| **6** U merret mendimi fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve si aktorë në rishikimin e politikave dhe praktikave mbrojtëse. | | | |

**Skema e vetëvlerësimit**
Kur të keni mbaruar me mjetin e vetëvlerësimit, i transferoni përgjigjet tuaja në skemën e mëposhtme, duke përdorur ngjyra të ndryshme ose tre llojet e hijeve. Skema e vetëvlerësimit ju ofron mundësinë të bëni një diagramë të shkollës suaj, që tregon se si po ecën shkolla juaj në mbrojtjen e fëmijëve dhe ku duhen ndërmarrë veprime të mëtejshme. Përdorni ngjyra të ndryshme ose hije të ndryshme për **A**, **B**, dhe **C**.

Vini re, ju lutem, se kjo skemë, pasqyron standardet e mbrojtjes së fëmijëve, që nënvizohen në **KAPITULLIN 7**. Ato janë grupuar në gjashtë kategori për ta bërë më të thjeshtë. Synimi i këtij ushtrimi është të nxjerrë në pah çdo boshllëk në secilin prej gjashtë seksioneve. Sapo kriteret bazë të sipërpërmendura të jenë lexuar dhe shënuar, si: ekziston, ekziston pjesërisht ose nuk ekziston, transferoni rezultatet në skemë, duke përdorur hijezimin e mëposhtëm. Skema ilustron vizualisht shkallën e arritur nga shkolla për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe aksionet e mëtejshme që duhen ndërmarrë. Vini re, nuk ka asnjë avancim hierarkik të menduar nga 1–6, qëllimi i këtij ushtrimi është të zbulojë ndonjë mangësi të mundshme.

# 4 Listë kontrolli për zbatimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla

## 4.1 Informacion i përgjithshëm

**QYTETI:** ..........................................................................

**EMRI I SHKOLLËS:** ..................................................................

**EMRI I SMF/FPP QË PËRGJIGJET PËR SHKOLLËN:** .......................

**EMRI I SUPERVIZORIT SMF:** ................................................

**EMRI I DREJTORIT TË SHKOLLËS:** ..........................................

# 4.2 Struktura e mbrojtjes së fëmijëve për shkollat

## FAZA 1: Organizimi i një strukture

| PËR T'U BËRË | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| 1 Vetëvlerësimi është kryer | × Kopje e vetëvlerësimit të shkollës | ◌ | |
| 2 Ekziston grupi i task forcë për mbrojtjen e fëmijëve | × Lista me emrat e personave të përfshirë<br>× Raportet e takimit | ◌ | |
| 3 Plani i veprimit i shkollës është i përpunuar | × Kopje e planit të veprimit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve | ◌ | |
| 4 Shkolla ka politikë të standardizuar për mbrojtjen e fëmijëve. | × Kopje e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në shqip (vetëm nëse i janë bërë modifikime politikës standarde të MMF) | ◌ | |
| 5 Miratimi dhe rishikimi i politikave dhe procedurave për mbrojtjen e fëmijëve | × Kopje të procedurave dhe politikave të firmosura nga bordi i menaxhimit të shkollës<br>× Shënim i datës së planifikuar për të rishikuar procedurat për mbrojtjen e fëmijëve dhe kush është përgjegjës. | ◌ | |
| 6 Informacion mbi procedurat për mbrojtjen e fëmijëve. | × Një dokument që ofron informacion mbi procedurat e mbrojtjes së fëmijëve është krijuar, përfshirë dhe emrin e Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve (FPP/SMF) dhe një diagramë për raportimin e rastit | ◌ | |
| 7 Ekzistojnë dhe aplikohen procedurat e rekrutimit | × Një kopje e metodave të miratuara për procedurat e rekrutimit sipas MMF | ◌ | |
| 8 Shkolla ka udhëzime me shkrim për sjelljen | × Një kopje e tre udhëzimeve:<br>× personeli arsimor për nxënësit<br>× nxënës me nxënës<br>× udhëzim për kontaktin fizik | ◌ | |

| PËR T'U BËRË | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **9** Është hartuar deklarata për PMF | × Kopje e deklaratave PMF (vetëm nëse i janë bërë modifikime deklaratës standarde të MMF) | ⁘ | |
| **10** Zbatohet konfidencialiteti i dosjeve për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla | × Verifikohet ekzistenca e një vendi të sigurt për vendosjen e dosjeve,<br>× Sqarohet konfidencialiteti dhe disponibiliteti i informacionit të depozituar në dosje mes aktorëve kyç. | ⁘ | |
| **11** Është ngritur një grup i rregullt i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm | × Kopje e dokumentave që japin informacion se kur dhe nga kush do të bëhet sistemi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm | ⁘ | |

**FAZA 2: Zbatimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve**

| PËR T'U BËRË | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **1** Personeli arsimor është trajnuar se si të dallojë shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve | × Lista me datat dhe temat e seminareve për rritjen e ndërgjegjësimit | ⁘ | |
| **2** Prindërit janë trajnuar se si të dallojnë problemet e fëmijëve | × Lista me datat dhe temat e seminareve për rritjen e ndërgjegjësimit. | ⁘ | |
| **3** Nxënësit janë trajnuar se si të dallojnë problemet e mbrojtjes së fëmijëve | × Lista me datat dhe temat e seminareve për rritjen e ndërgjegjësimit | ⁘ | |
| **4** Procedurat e mbrojtjes së fëmijëve i janë komunikuar – nxënësve | × Kopje e materialeve të shkruara të komunikimit dhe kanaleve të përdorura për komunikim<br>× Kopje e informacionit për fëmijët mbi burimet e përkrahjes | ⁘ | |

| PËR T'U BËRË | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **5** Procedurat e mbrojtjes së fëmijëve i janë komunikuar – personelit arsimor | × Kopje e materialeve të shkruara të komunikimit dhe kanaleve të përdorura për komunikim<br>× Kopje të informacionit për personelin arsimor mbi burimet e mbështetjes, si lista e kontakteve për këshillime dhe informim me specialistët | ◌ | |
| **6** Procedurat e mbrojtjes së fëmijëve i janë komunikuar – prindërve | × Kopje e materialeve të shkruara të komunikimit dhe kanaleve të përdorura për komunikim<br>× Kopje të informacionit për prindërit mbi burimet e mbështetjes | ◌ | |
| **7** Deklarata për mbrojtjen e fëmijëve është firmosur nga të gjithë anëtarët e personelit arsimor | × Kopje e deklaratës PMF e firmosur nga të gjithë anëtarët e shkollës | ◌ | |
| **8** Mundësi për të parë nga ana vizuale politikën dhe procedurat për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla | × Politika dhe procedurat e MF janë vendosur në vend të dukshëm në ndërtesën e shkollës | ◌ | |
| **9** Kodi i sjelljes është vendosur në çdo klasë dhe në ndërtesën e shkollës | × Të gjithë klasat kanë kode sjelljeje dhe masa që merren në mënyrë të vazhdueshme<br>× Në vend të dukshëm të ndërtesës së shkollës është vendosur kodi i sjelljes | ◌ | |
| **10** Ekziston sistemi i raportimit të rasteve për mbrojtjen e fëmijëve | × Evidenca të shkruara se si trajtohen problemet për MF në shkollë dhe një program për analizimin (takimet MF)<br>× Shembuj të formularëve për regjistrimin e detajeve të incidenteve MF (mjetet MF për menaxhimin e rasteve të veçanta)<br>× Përmbledhje e disa incidenteve dhe disa ankesave (raportet mujore për menaxhimin e rastit)<br>× Bërja e hartës së komunitetit e NMF për partnerët për mbrojtjen e fëmijëve | ◌ | |

| PËR T'U BËRË | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **11** Janë marrë masa për të përmirësuar mjedisin miqësor në shkolla | × Lista e ngjarjeve dhe masave të marra | | |
| **12** Sesionet javore me kolegët për diskutimin e rasteve kryhen rregullisht | × Lista e rasteve të diskutuara (shiko listën e detajuar më poshtë) | | |
| **13** Takimet dyjavore të mbikëqyrjes për mbrojtjen e fëmijëve, kryhen rregullisht | × Lista e takimeve për MF (shiko listën e detajuar më poshtë) | | |
| **14** 25. Ekzistojnë grupet e vëzhgimit për mbrojtjen e fëmijëve | × Emri i anëtarëve të grupit,<br>× Aktivitetet dhe takimet e kryera nga grupi | | |

**FAZA 3: Vlerësimi**

| VLERËSIMI I NDIKIMIT | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **1** 70% e nxënësve janë në dijeni të politikës për mbrojtjen e fëmijëve, procedurat, kodet e sjelljes dhe pasojat | Sondazh | | |
| **2** 100% e personelit arsimor janë në dijeni të politikës për mbrojtjen e fëmijëve, procedurat, kodet e sjelljes dhe pasojat | Sondazh | | |
| **3** 50% e prindërve janë në dijeni të politikës për mbrojtjen e fëmijëve, procedurat, kodet e sjelljes dhe pasojat | Sondazh | | |
| **4** Është përmirësuar cilësia e përgjigjes në mbrojtje të fëmijëve | Auditim i brendshëm | | |
| **5** Është përmirësuar cilësia e aktiviteteve në mbrojtje të fëmijëve. | Pyetësor | | |
| **6** Është përmirësuar mbarëvajtja e fëmijëve | Auditim i jashtëm | | |

| VLERËSIMI I NDIKIMIT | TREGUES | | DATA |
|---|---|---|---|
| **7** Është përmirësuar kapaciteti i mësuesve për menaxhimin e klasës | Vlerësim | ⁘ | |
| **8** Janë përmirësuar aftësitë pozitive prindërore | Pyetësor | ⁘ | |

# 4.3 Sistemi i menaxhimit të rastit për shkollat

**Paraqitje e menaxhimit të rasteve të veçanta**

| DATA | RASTE TË REJA (II) | NË PROCES (IV) | TË RAPORTUARA (V) | TË MBYLLURA (VIII) | DOSJE PLOTËSISHT TË HAPURA (IX) |
|---|---|---|---|---|---|
| MAI 2007 | | | | | |
| 2007 | | | | | |
| ... | | | | | |
| MAI 2008 | | | | | |
| ... | | | | | |

### Lista e sesioneve javore të këshillimit me kolegë të ndjekura nga SMF i ngarkuar për shkollën

| DATA | RASTI I DISKUTUAR (NUMRI I DOSJES) | PREZANTUAR NGA |
|---|---|---|
| .......... | ............................................ | ................................... |
| .......... | ............................................ | ................................... |
| .......... | ............................................ | ................................... |

### Takime midis SMF dhe supervizorit për mbikëqyrjen e menaxhimit të rastit

| DATA | LISTA E RASTEVE NË DOSJE TË DISKUTUARA (SIPAS PRIORITETIT 1, 2, 3, 4) | NUMRI TOTAL I RASTEVE |
|---|---|---|
| .......... | ............................................ | ................................... |
| .......... | ............................................ | ................................... |

### Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme

| DATA E FUNDIT E VLERËSIMIT TË JASHTËM | EMRI, POZICIONI, ORGANIZATA |
|---|---|
| ........................................ | ................................................ |

# 4.4 Aktivitetet shkollore për mbrojtjen e fëmijëve

## A Seminare për rritjen e ndërgjegjësimit mbi problemet e mbrojtjes së fëmijëve me prindërit

| DATA | TEMA | NUMRI I PRINDËRVE TË PRANISHËM |
|---|---|---|
| .......... | .......................................... | .................................. |
| .......... | .......................................... | .................................. |

## B Seminare për rritjen e ndërgjegjësimit mbi problemet e mbrojtjes së fëmijëve me mësuesit

| DATA | TEMA | NUMRI I MËSUESVE TË PRANISHËM* |
|---|---|---|
| .......... | .......................................... | .................................. |
| .......... | .......................................... | .................................. |

## C Seminare për rritjen e ndërgjegjësimit mbi problemet e mbrojtjes së fëmijëve me nxënësit

| DATA | TEMA | NUMRI I NXËNËSVE TË PRANISHËM* |
|---|---|---|
| .......... | .......................................... | .................................. |
| .......... | .......................................... | .................................. |

## D Aktivitetet e grupit të vëzhgimit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve

| DATA | POPULLSIA NËN STUDIM | LLOJI I AKTIVITETIT | TEMA | NUMRI I PJESË-MARRËSVE |
|---|---|---|---|---|
| .......... | .................. | .................. | .................. | .................. |
| .......... | .................. | .................. | .................. | .................. |

## E Masat e ndërmarra për të përmirësuar mjedisin miqësor për fëmijët në shkollë

# 5 Politika dhe procedurat e shkollës për Mbrojtjen e Fëmijëve

Aneksi 5

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

# Procedurat e mbrojtjes së fëmijës & materiale ndihmë për shkollat

## Përmbajtja

**Procedurat**
5.1 Përgjegjësitë e menaxhimit
5.2 Rekrutimi dhe përzgjedhja
5.3 Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit
5.4 Ngritja dhe raportimi i shqetësimeve
5.5 Zbatimi i politikës për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë
5.6 Planifikimi i zbatimit dhe mjetet e monitorimit
5.7 Formati për ecurinë e raportimit

**Materiale ndihmë**
5.8 **PËRMBLEDHJE 1:** Mbi angazhimin e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve
5.9 **PËRMBLEDHJE 2:** Mbi politikën e shkollës për mbrojtjen fëmijëve
5.10 **PËRMBLEDHJE 3:** Mbi Kategoritë Universale të Abuzimit me Fëmijën
5.11 Kodi i sjelljes
5.12 Struktura e ngritjes & raportimit të shqetësimeve

# 5.1 Rolet dhe përgjegjësitë

**BORDI I SHKOLLËS:** me mandatin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, bordi i menaxhimit të shkollës, ka përgjegjësi për zbatimin e Politikës dhe Procedurave për Mbrojtjen e Fëmijëve.

**DREJTORËT E SHKOLLËS:** Janë përgjegjës për përcaktimin e politikave dhe praktikave të mira.

**SPECIALISTËT E MBROJTJES SË FËMIJËVE NË SHKOLLA:** Janë përgjegjës për zbatimin e përditshëm të procedurave të mbrojtjes së fëmijëve në përputhje me politikën.

**ANËTARËT E PERSONELIT ARSIMOR TË SHKOLLËS:** Kanë për detyrë të mbështesin politikat dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve.

Shkolla cakton përgjegjësi të qarta për gjithë personelin e shkollës për t'u siguruar se zbatimi i **Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve** kryhet në të gjitha mjediset e shkollës. Drejtori i shkollës me mbështetjen e Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve, ka përgjegjësi të drejtpërsëdrejtë për të garantuar se të gjithë individët, që janë në kontakt me fëmijët, cilido qoftë roli apo statusi i tyre, të kenë trajnimin e duhur mbi këtë politikë dhe procedurat e saj shoqëruese. Të dhënat e trajnimit do të grumbullohen për qëllime monitorimi dhe do të përdoren për të përcaktuar pjesërisht efikasitetin e zbatimit të politikës gjatë vlerësimit.

Aty ku ngrihen shqetësime për abuzim fëmije, drejtori ka përgjegjësi të garantojë që raportimi i brendshëm i detyrueshëm synon mbrojtjen e fëmijës. Bazuar në politikën dhe procedurat e shkollës, drejtori duhet të vendosë për ecurinë e mëtejshme të veprimeve për ta trajtuar sa më mirë rastin. Në të gjitha rastet duhet patur parasysh se është interesi më i mirë i fëmijës, ai që konsiderohet mbi gjithçka tjetër..

**Të punësuarit (dhe të tjerët)**

Me anë të këtij dokumenti, të gjithë të punësuarit dhe persona të tjerë, duhet të informohen rregullisht mbi përgjegjësitë dhe detyrat e tyre për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve. Për më tepër, punonjësit dhe të tjerë, duhet njëkohësisht të ndërgjegjësohen për rolin e tyre të paracaktuar në mbrojtjen e fëmijëve dhe për përgjegjësinë e denoncimit të

detyrueshëm në raste dëshmie, deklarimesh, thëniesh ose dyshimesh në lidhje me abuzimin të ushtruar ndaj një fëmijë. Kodin e sjelljes në shkolla përcakton kërkesat për sjelljen e të gjithë të punësuarve dhe të tjerëve, si dhe përcakton cilat sjellje me fëmijët konsiderohen të pranueshme, e cilat jo. Nëse konsiderohet se një punonjës ose të tjerë, kanë sjellje që paraqesin rrezik të lartë për jetën e tij personale dhe/ose private, duke thyer kështu Kodin e Sjelljes, kodi do të zbatohet me rigorozitet, sipas procedurave disiplinore, me qëllim që të ruhen normat morale dhe etike të kërkuara nga shkolla.

**Sa herë ngrihen shqetësime për abuzim fëmije, shkolla do të kryejë detyrën e saj ligjore, për t'i raportuar këto probleme autoriteteve kompetente dhe t'i jap fund kontratës së punësimit.**

## 5.2 Rekrutimi dhe përzgjedhja

Përvoja ka treguar se me vetëdije ose jo, individë të prirur, me ose pa dashje, për të abuzuar me fëmijët, qoftë ky abuzim seksual, fizik apo psikologjik, synojnë të bëjnë pjesë në organizata që punojnë me fëmijët, siç janë shkollat.

Procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes nuk mund të japin garanci të sigurta; megjithatë nëse zbatohen procedura të rrepta, që ngulmojnë në rëndësinë e mbrojtjes së fëmijës, ato duke patur efekt parandalues, mund ta ulin rrezikun, duke kontribuar në zbulimin e atyre që paraqesin një rrezik të mundshëm për fëmijët.

**Informacioni për të gjithë ata që aplikojnë për një pozicion në shkollë përfshin:**

- **PËRMBLEDHJE 1:** Angazhimi për mbrojtjen e fëmijëve,
- **PËRMBLEDHJE 2:** Mesazhet kyçe të politikës së shkollës për mbrojtjen e fëmijëve,
- Kodi i sjelljes,
- Deklaratë mbi mbrojtjen e fëmijës në formularin e aplikimit për vendin e punës ,
- Deklaratë mbi mbrojtjen e fëmijës dhe përshkrimi i përgjegjësive specifike në listën e përgjegjësive në lidhje me vendin e punës.

**Gjatë intervistës:**
- Pasaporta ose një dokument tjetër identifikimi,
- Pyetje rreth periudhave që personi nuk ka qenë i punësuar,
- Pyetje mbi dënime dhe dosjen gjyqësore,
- Pyetje mbi problemet e mbrojtjes së fëmijës sipas postit për të cilin kandidohet,
- Nëse është e mundur, verifikim i dosjes gjyqësore,
- Kontroll i dy referencave,
- Prezantim i dokumenteve origjinale të kualifikimeve të shënuara në formularin e aplikimit,
- Verifikim i përvojës profesionale.

## 5.3 Zhvillimi i sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve

**Kultura e menaxhimit**
Është thelbësore që drejtuesit e shkollave të zhvillojnë një kulturë ndërgjegjësimi dhe që nxit hapjen ndaj kulturave të tjera, me anë të së cilës, punonjësit dhe të tjerë, të mund të ngrenë shqetësimet e tyre në lidhje me abuzime ndaj fëmijëve, si dhe të besojnë në një reagim pozitiv prej drejtuesve dhe Specialistëve të Mbrojtës së Fëmijëve në lidhje me shqetësimin dhe mbështetjen e mundshme që mund të jepet. Një kulturë e tillë është jetësore për krijimin e një mjedisi të volitshëm për mbrojtjen e fëmijës. Kjo kulturë manifestohet duke:
- dëgjuar dhe iu përgjigjur pyetjeve të ngritura nga punonjësit dhe të tjerë, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët,
- krijuar mundësi të rregullta për diskutime të lira,
- vëzhguar dhe reaguar ndaj shenjave të ankthit dhe stresit,
- ngritur probleme që kanë të bëjnë me tema të ndjeshme,
- mbështetur individë që gjenden në rrethana të vështira,
- dhënë e marrë komente kritike,
- komunikuar qartë dhe hapur,
- marrë vendime dhe masa në raste problemesh.

Është detyrë e drejtuesve të shkollës të vlerësojnë kulturën organizative lokale në vend dhe të veprojnë në mënyrë që të ketë një mjedis të volit-

shëm për realizimin e duhur të politikës për mbrojtjen e fëmijës. Ngritja dhe denoncimi i problemeve, edhe pse janë hapa veçanërisht të vështirë për t'u ndërmarrë, janë një mënyrë procedimi e rëndësishme për trajtimin e çështjeve të dhunës ndaj fëmijëve, prandaj dhe punonjësit dhe të tjerë duhet të ndjejnë praninë e një mjedisi pozitiv dhe mbështetës.

Gjatë diskutimeve për vënien në jetë, është mirë të këmbëngulet në kriteret e vendosura më sipër, çka përshkruajnë një kulturë organizative të hapur dhe të ndërgjegjshme, si dhe ndryshimet e kërkuara për krijimin e një kulturë që i korrespondon kësaj politike. Kultura organizative duhet njëkohësisht të reflektojë vetëdije për problemet e abuzimit të fëmijëve, duke sfiduar praktikat negative dhe duke përshtatur një ndërhyrje të menaxhimit të rreziqeve. Është mirë të tërhiqet vëmendja mbi procedurën e Kodit të sjelljes dhe nevojat për të mbështetur punonjësit dhe të tjerë, me qëllim që ata të plotësojnë kriteret e politikës.

**Mbështetja dhe progresi i punonjësve dhe të tjerëve**

**Sistemet**
Rekrutimi, instalimi, mbikëqyrja, mbledhjet dhe raportet, janë pjesë e sistemeve me çka drejtuesit me ndihmën e specialistit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të transmetojnë dhe të integrojnë tërësisht çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Këto përgjegjësi të drejtuesve, mund të përmblidhen si më poshtë:

- Trajnimi i punonjësve të rinj si dhe punonjësve ekzistues, është mirë të përmbajë një minimum elementesh ndërgjegjësimi dhe informimi rreth politikës për mbrojtjen e fëmijës dhe procedurat lokale specifike.
- Në lidhje me punonjësit që janë në kontakt të drejtpërdrejtë e të rregullt me mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, mbledhjet do të jenë forumet ku do të diskutohet mbi çështjet praktike të mbrojtjes së tyre.
- Shfrytëzimi i çdo rasti për të diskutuar për problemet, do të ndihmojë të krijohet një kulture e hapur dhe e ndërgjegjshme, si dhe ngritjen e shqetësimeve para se ato të rëndohen.

**Mbështetja**
Kur lindin shqetësime dhe probleme delikate lidhur me mbrojtjen e fëmijës, shkolla ka për detyrë t'i mbështesë drejtuesit, punonjësit dhe të tjerë, për shembull nëpërmjet trajnimit, mbështetjes dhe këshillimeve profesionale.

- Punonjësit dhe të tjerë nxiten që të ngrenë dhe të raportojnë shqetësimet e abuzimit me fëmijët dhe të luftojnë praktikat e këqija.
- Dëgjohen me kujdes shqetësimet dhe veprohet në mënyrë pozitive.
- Diskutohet mbi masat e marra (në përshtatje me politikën), bashkë me drejtorinë e shkollës.
- Raportet dhe informacioni mbahen konfidenciale dhe i transmetohen vetëm atyre që gëzojnë të drejtën për t'i njohur.

Si pjesë e procesit të zbatimit, sistemet ekzistuese, që mbështesin dhe formojnë punonjësit dhe të tjerë, duhen vlerësuar duke parë se sa i përmbahen ato kërkesave të politikës për mbrojtjen e fëmijës.

## 5.4 Ngritja dhe denoncimi i problemeve

Çdo njeri që punon ose hyn në kontakt me fëmijë, që mbështet ose merr pjesë në një manifestim të organizuar nga shkolla, ka përgjegjësinë e ngritjes dhe të denoncimit të shqetësimeve që prekin sigurinë ose mbarëvajtjen e fëmijëve. Punonjësit dhe të tjerë, duhet të sinjalizojnë menjëherë për problemet pranë Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkollë.

Është detyrë e drejtorëve të shkollave të ngrenë një mekanizëm të qartë e të detajuar për denoncimin e problemeve (si Kuadri për Ngritjen e Shqetësimeve), ku shqetësimet të mund të ngrihen në mënyrë të shpejtë dhe vepruese, të paraqiten dhe të shprehen në gjuhë të kuptueshme për çdo kategori njerëzish.

Shkolla duhet të marrë masa që të mbrohen siç duhet interesat e çdo njeriu që denoncon probleme të tilla dhe të gjitha raportimet **e bëra në mirëbesim**, do të konsiderohen si prova të shqetësimit individual në interes të fëmijëve dhe shkollës. Ky qëndrim do të mbahet deri në fund, pavarësisht nga rezultati i hetimeve të mëvonshme.

## 5.5 Zbatimi i politikës së mbrojtjes së fëmijëve

**Zbatimi efektiv i politikës përmban tre elemente kryesore, që janë:**

- ndërgjegjësimi mbi politikën,
- përpunimi dhe vënia në jetë e procedurave lokale,
- përpunimi dhe vënia në jetë e sistemeve të drejtimit.

Politika e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve dhe materiali mbështetës, duhet t'u komunikohen të gjitha grupeve të brendshme (personelit arsimor, nxënësve etj.) e të jashtme (prindërve, partnerëve të komunitetit etj.). Transmetimi i Politikës duhet të bëhet kryesisht nëpërmjet seancave formale të informimit, por, gjithashtu, edhe nëpërmjet diskutimeve, prezantimeve dhe përpunimit të procedurave lokale dhe materialit mbështetës. Është mirë të këmbëngulet që të gjithë punonjësit dhe të tjerë, të jenë të informuar për përmbajtjen e Politikës dhe të detyrimeve, që shtrohen para tyre në lidhje me mbrojtjen e fëmijës. Duhet të nxiten dhe të përkrahen diskutimet në nivel lokal për identifikimin e vështirësive, që duhen kaluar gjatë përpunimit të procedurave lokale.

**Seancat formale të informimit**
Të gjithë punonjësit duhet të informohen nga specialisti i shkollës për mbrojtjen e fëmijëve me mbështetjen e drejtorit të shkollës. Mbledhja duhet të parashikojë një seancë diskutimesh, ku të ngrihen problemet dhe shqetësimet. Problemet e ngritura duhen shqyrtuar brenda seancës së diskutimeve. Në rast se ngrihen probleme të rëndësishme që s'mund të trajtohen menjëherë, është mirë që të mbahen shënim dhe t'i referohen drejtorit të shkollës.

## 5.6 Planifikimi i zbatimit dhe mjetet e monitorimit

Për të vënë në jetë politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe standardeve, në shkollë hartohet një plan veprimi për mbrojtjen e fëmijëve aty, si dhe mjetet e monitorimit, që ndihmojnë procesin e zbatimit të politikës së

mbrojtës së fëmijëve. Ato janë bazat për ecurinë e monitorimit dhe raportimi drejt realizimit të plotë.

Dokumenti i planifikimit të veprimit përmbledh kërkesat kryesore dhe përgjegjësitë e drejtorisë për vënien në jetë dhe funksionimin e politikës.

Sistemi i monitorimit të rastit në shkollë për mbrojtjen e fëmijës, shërben si një instrument menaxhimi dhe për krijimin e statistikave kombëtare mbi mbrojtjen e fëmijëve.

## 5.7 Formati i raportimit të progresit

**Zbatimi i politikës për mbrojtjen e fëmijës, i nënshtrohet një procedure kontrolli, të rëndësishme për të:**

- garantuar zbatimin e saj në shkollë,
- shmangur vështirësitë praktike gjatë zbatimit të politikës,
- identifikuar nevojat për mbështetjen e zbatimit dhe funksionimin,
- ndihmuar në vlerësimin dhe rishqyrtimin e politikës,
- mbledhur informacione mbi zbatimin e politikës në praktikë.

Raportet mbi progresin e politikës, kërkohen të bëhen 6 muaj pas shpalljes të saj. Raporti i parë duhet të përshkruajë se si janë kryer aktivitetet e planifikuara. Ai përbën një shans për të ngritur problemet apo nevojat imediate në mbështetje të zbatimit të politikës.

Raporti 6-mujor duhet të përshkruajë procesin e përgjithshëm të zbatimit, mësimet që janë nxjerrë prej tij dhe çështjet, që duhet të jenë objekti i një analize dhe mbështetjeje për të ardhmen.

Pika e kontrollit për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla mund të ndihmojë në strukturimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të zbatimit të politikës dhe procedurave për mbrojtjen e fëmijëve.

Raporti i përmendur më lart, duhet të dorëzohet në bordin drejtues të shkollës dhe te Drejtoria Arsimore Rajonale.

## 5.8 PËRMBLEDHJE 1: Mbi angazhimin e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve

Shkolla beson se të drejtat e fëmijës dhe mirëqenia e tij, janë mbi gjithçka tjetër. Duke patur parasysh se ndjenjat dhe nevojat e fëmijës, janë të lidhura me racën, fenë, kulturën dhe gjuhën e tij, shkolla ka si përparësi të përmirësojë të drejtat e fëmijës dhe të ruajë mirëqënien e tij.

Shkolla e ka përpunuar këtë politikë, si shprehje të synimit të saj për të mbrojtur mirëqenien e fëmijës, që i është besuar për t'u përkujdesur.

Shkolla (VENDOSNI EMRIN ..........................) ka si politikë të saj të mbrojë të drejtat e fëmijës, ku përfshihen parandalimi i abuzimit në të gjitha format, fizike, emocionale apo seksuale. Shkolla pranon se në të gjithë shoqëritë dhe kulturat, historikisht është ushtruar dhunë mbi fëmijët, po ashtu dhe në organizata e institucione, për këtë arsye shkolla do të përpiqet të luftojë injorancën, fshehtësinë dhe lëndimin, që shoqërojnë abuzimin ndaj fëmijës, kudo që ai ndodh dhe sa herë që shkolla do të ndeshet me të. Shkolla po përpiqet të krijojë një mjedis për mbrojtjen e fëmijës, duke ndërgjegjësuar njerëzit përmes shërbimit të saj të avokatisë, duke u dhënë fëmijëve mundësinë që zëri i tyre të dëgjohet, duke trajnuar personelin arsimor dhe prindërit në parandalimin e abuzimit të fëmijës, në njohjen e shenjave dalluese të abuzimit, për raportimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit.

**Angazhimi i shkollës (VENDOSNI EMRIN ..........................) për mbrojtjen e fëmijës mund të përmblidhet si më poshtë:**

- × **PARANDALIM:** Duke ndërgjegjësuar njerëzit për dhunën që ushtrohet (sidomos) ndaj fëmijëve dhe rreziqet që u kanosen fëmijëve me anë të vënies në jetë të kësaj politike.
- × **MBROJTJA:** Ulja e rreziqeve që u kanosen fëmijëve nëpërmjet një vlerësimi të rrezikut në të gjitha nivelet ku ndodh kontakti me fëmijët dhe ndërgjegjësimi mbi abuzimin ndaj fëmijëve. – Zbatimi i "praktikave më të mira" të rekrutimit dhe të përzgjedhjes. – Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve, të punësuarve dhe të tjerëve në rast dyshimesh, deklaratash, informatash apo dëshmish të abuzimit me fëmijët.

- **REHABILITIM DHE INTEGRIM:** Ngritja e shqetësimeve dhe raportimi i dyshimeve, thënieve, informatave dhe dëshmive për abuzime me fëmijët në shkollë dhe jashtë saj pranë autoriteteve kompetente. – Njohja e masave që duhen marrë dhe personave që duhen kontaktuar në rast problemesh në lidhje me mbrojtjen e fëmijës. – Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve, të punësuarve dhe të tjerëve, që kanë njohur akte dhune mbi fëmijët, me mjete psikologjike, mjekësore dhe ligjore, nëse është e nevojshme.

## 5.9 PËRMBLEDHJE 2: Mbi politikën e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve

**Shkolla (VENDOS EMRIN . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . ) ka si politikë të mbrojë të drejtat e fëmijës, gjë që nënkupton parandalimin e dhunës në të gjitha format e saj, qoftë kjo fizike, psikologjike apo seksuale. Shkolla pranon se akte dhune ushtrohen mbi fëmijët në të gjitha shoqëritë, të gjitha kulturat dhe në shumë organizata, e për rrjedhim, të punësuarit dhe të tjerë mund të përballen në çdo çast me probleme të dhunës.**

## Objektivat

**Politika e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve ka si synim:**

- të rrisë ndërgjegjësimin kudo në mjediset shkollore rreth dhunës ndaj fëmijëve;
- të japë orientime për të punësuarit dhe të tjerë dhe të përcaktojë detyrat për parandalimin, ngritjen, raportimin dhe reagimin ndaj problemeve të dhunës mbi fëmijët;
- të minimizojë rrezikun e dhunës ndaj fëmijëve qysh gjatë rekrutimit e përzgjedhjes së punonjësve dhe të tjerëve;
- të minimizojë rrezikun e dhunës ndaj fëmijëve, duke përdorur një praktikë drejtimi të vetëdijshme dhe të hapur brenda shkollës dhe në punën me fëmijët.

# Mesazhe - kyç

**Politika e shkollës (VENDOS EMRIN .......................... ) për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve deklaron si më poshtë:**

- Shkolla **(VENDOS EMRIN .......................... )** është e vendosur të përkrahë në programet dhe aktivitetet e saj të drejtat e fëmijëve dhe, si rrjedhojë, është e vendosur të luftojë abuzimin ndaj fëmijëve si një problem madhor;
- të gjithë të punësuarit dhe të tjerë në shkollën **(VENDOS EMRIN .......................... )**, janë të qartë mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre në parandalimin e abuzimit me fëmijë;
- të gjithë të punësuarit dhe të tjerë në shkollë e kanë të qartë mënyrën se si duhen pranuar, trajtuar dhe raportuar, në rast konstatimi, shqetësimet për dhunë ndaj fëmijëve.

# Zhvillime

**Çfarë ndikimesh ka politika mbi të punësuarit dhe të tjerët?**

- Procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes, do të rinovohen dhe përmirësohen vazhdimisht.
- Seancat formale të informimit dhe ndërgjegjësimit, do t'u drejtohen të gjithë të punësuarve dhe të tjerëve.
- Drejtorët, të mbështetur nga Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, do të jenë përgjegjës për zbatimin e politikës.
- Raportimi i të gjitha shqetësimeve të dhunës ndaj fëmijëve, është i detyrueshëm për të gjithë të punësuarit dhe të tjerë.
- Procedurat lokale që synojnë ngritjen dhe raportimin e shqetësimeve të dhunës ndaj fëmijëve përpunohen vazhdimisht dhe vihen në zbatim.

## 5.10 **PËRMBLEDHJE 3:** Kategoritë universale të abuzimit me fëmijën

**Katër kategoritë universale të dhunës ndaj fëmijëve, janë përkufizuar si më poshtë dhe shërbejnë si referencë:**

- × **DHUNË SEKSUALE**: Shfrytëzimi seksual, real apo në tentativë, që përfshin të gjitha format e aktiviteteve seksuale si përdhunimi, incesti dhe pornografia.
- × **DËMTIMI FIZIK:** Dëmtimi fizik, real apo i mundshëm, mbi një fëmije ose mosndalimi i një lëndimi ose vuajtjeje fizike.
